



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional
“E drejtë private”
i
Institucionit të Arsimit të Lartë “Albanian University”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Migena Leskoviku
2. Prof.Dr. Evis Alimehmeti

Qershor/2021

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Master Profesional në “E drejtë private” të ofruar nga
Universiteti Privat “Albanian University”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Privat “Albanian University”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Juridike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master profesional në “E drejtë private”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 597, datë 28.05.2009;
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Urdhër i MASH Nr. 308, dt. 08/06/2010.
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Diplomë e ciklit të dytë
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Urdhër Nr. 585, datë 27.11.2012
8	Cikli i studimit:	Cikli II
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik
10	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	- Për vitin akademik 2019-2020 janë angazhuar 4 PAE dhe 6 PAK. - Për vitin akademik 2020-2021 janë angazhuar 3 PAE dhe 6 PAK.
18	Numri i studentëve:	9 (Për vitin akademik 2019-2020) 6 (Për vitin akademik 2020-2021)
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM TE PROGRAMIT

Përshkrim përmbledhës

Qëllimi i procesit të vlerësimit të jashtëm është të japë një mendim të pavarur për shkallën në të cilën institucioni në fjalë është i përgatitur dhe i angazhuar të përmbushë me efektivitet dhe përgjegjshmëri kërkesat dhe standardet akademike të diplomave që do të lëshojë. Për të arritur në këtë gjykim, GVJ u mbështet në shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, në dokumentacionin bazë mbi të cilin ngrihet veprimtaria e Universitetit, dosjen e programit të studimit me dokumentacionin shoqërues, takimet e vizitat e organizuara në institucion. Vlerësimi i programit të studimit u fokusua në analizën e programit, në shqyrtimin e sillabuseve: vendosjen e objektivave të të mësuarit, kompetencat që synohen të fitohen, rrugët nëpërmjet të cilave fitohen (metodat e mësimdhënies), literaturën bazë dhe atë shtesë, mënyrat e vlerësimit të dijeve, përcaktimin e krediteve, kompetencën e stafit akademik, aktivitetin kërkimor - shkencor dhe atë ekstrakurrikular, kujdesin ndaj studentit, këshillimin e karrierës dhe tutoriatin, praktikën profesionale, bashkëpunimin ndërkombëtar, etj.

Albanian University e ushtron aktivitetin e tij bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe të akteve të tjera nënligjore mbi arsimin e lartë, Statutin e Universitetit, Rregulloren bazë të tij dhe të akteve të tjera rregullatore të institucionit.

Albanian University është institucion i arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë i njohur si “Universitet” me VKM Nr.197, datë 10.04.2004. Albanian University është person juridik privat. Emri i institucionit është ndryshuar nga UFO University në Albanian University me VKM Nr. 603, datë 24.03.2011.

Albanian University, aktualisht pas riorganizimit të miratuar me Urdhër Nr. 52, datë 5.02.2016 të MAS, përbëhet nga tre njësi kryesore: Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore. Ai ofron programe studimi për të tre ciklet e studimit si dhe realizon kërkim shkencor bazë dhe të aplikuar me anë të njësisive përbërëse kryesore, bazë dhe ndihmëse. Programi Master Profesional në “E drejtë private” është riakredituar me Vendimin Nr.24, datë 14.04.2019 për një vit. Ky program ka për qëllim që nëpërmjet përgatitjes teoriko – praktike t’u krijojë mundësi studentëve të ushtrorjnë profesionin e juristit dhe të bëjë një lidhje sa më të mirë me nevojat e tregut të punës.

Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Pasi Albanian University ka aplikuar për nisjen e procedurës së riakreditimit të programit Master Profesional në "E drejtë private", ASCAL bazuar në "Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë nëkuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017", ka përzgjedhur dhe kontaktuar dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga AU, për të kryer vizitën në institucion dhe për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof. Dr. Evis Alimehmeti dhe Prof. Dr. Migena Leskoviku, profesore në Universitetin e Tiranës.

Gjatë vizitës në Institucion, GJVJ-ja u shoqërua nga Koordinatori Teknik i ASCAL për këtë program studimi z. Muhamed Prezja.

Për shkak të situatës së pandemisë në vend, vizita u përqëndrua në një ditë dhe ajo u realizua në datën 25 janar 2021. Ekspertëve të jashtëm iu vendos në dispozicion gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësim, fizikisht dhe përmes platformës e-ASCAL. Gjatë vizitave ekspertëve iu vendos në dispozicion një sallë mbledhjesh për të kryer të gjitha takimet sipas agjendës së planifikuar. Meqë gjatë vizitës, u evidentua nevoja për dokumentacion shtesë, ky dokumentacion i kërkuar nga ekspertët u vu në dispozicion në datën 27 janar 2021.

Në fund të këtij raporti, janë dhënë edhe rekomandimet për institucionin si dhe është paraqitur analiza SWOT për programin e studimit që është objekt akreditimi.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, pasi u njoh me komentet e IAL mbi Draft-Raportin, shprehet si vijon:

Së pari, GJVJ falenderon AU për pritjen, mbështetjen që i dha GJVJ-së gjatë vizitës në institucion, si dhe disponibilitetin për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar nga GJVJ, në lidhje me riakreditimin e programit të studimit MP në "E drejtë private".

Përsa i takon komenteve të bëra nga AU, në lidhje me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit Master Profesional në "E Drejtë Private", GJVJ sqaron sa më poshtë:

- GJVJ ka evidentuar se për vitin akademik 2019-2020 nuk plotësohet detyrimi për mbulimin e ngarkesës në masën min. 70% të saj, nga personeli akademik me kohë të plotë, gjë që pranohet dhe nga AU. Ashtu, siç kemi theksuar në raportin e vlerësimit të jashtëm, për vitin akademik 2019-2020, ky mbulim është 51.3 % e ngarkesës në planin mësimor të këtij programi studimi mbulohet nga PAE dhe 48.6% nga PAK. Për më tepër, sërish tabelat (edhe të ridërguara) kanë diku ndonjë pasaktësi. p.sh. diku në një tabelë një pedagoge (Elona Hoxha) jepet PAE, diku PAK për të njëjtin vit akademik – 2019/2020. Por gjithsesi, edhe duke e konsideruar këtë një gabim teknik, për vitin akademik 2019-2020, siç del në raport, nuk arrihet min. 70 % e mbulimit të ngarkesës me personel akademik me kohë të plotë dhe që pranohet edhe nga AU.

Viti akademik 2019-2020 është pjesë e periudhës së vlerësimit nga GJVJ për efekt riakreditimi, kështu që gjetjet tona në lidhje me % e mbulimit të ngarkesës nga PAE/PAK janë pjesë e këtij raporti. Për më tepër që mospërmbushja e këtij detyrimi për mbulimin e ngarkesës për këtë program studimi me min. 70% nga PAE, është evidentuar edhe në

akreditimin e mëparshëm dhe është një nga rekomandimet kryesore të lëna për këtë program studimi edhe nga BA, dhe që ne si GVJ e konstatuam edhe për vitin akademik 2019-2020, për efekt të këtij riakreditimi.

Në lidhje me arsyet e dhëna nga AU për mospërbushjen e këtij detyrimi për vitin akademik 2019-2020, siç ishin tërmeti dhe pandemia, ku sipas sqarimeve të dhëna nga institucioni, ... "një pjesë e stafit akademik efektiv shprehu pamundësi për të mbajtur një ngarkesë të lartë", GVJ nënvizon se planifikimi i ngarkesës për mbulimin e lëndëve të një program studimi bëhet përpara fillimit të vitit akademik dhe është detyrim ligjor i departamentit për garantimin e mbulimit të ngarkesës për programin e studimit MP (ndërsa pandemia ka ndodhur pas fillimit të vitit akademik dhe kalimi i mësimin në platformë online u bë për semestrin II të vitit akademik 2019-2020). Për më, kjo pamundësi nuk është evidentuar as në RVB, as gjatë vizitës në institucion. Në RVB madje theksohet se shkalla e përmbushjes së standarteve të cilësisë së programit bëhet plotësisht nga AU, dhe nuk është evidentuar si pikë e dobët as tek analiza SËOT e bërë në raport dhe as në ndonjë pjesë tjetër të RVB që lidhet me ngarkesën.

Gjithashtu, për semestrin e II të vitit akademik 2019-2020 që lidhet me pandeminë dhe kalimin e procesit mësimor online, në RVB evidentohet se janë realizuar detyrimet e programit nga stafi akademik për të mbyllur vitin akademik 2019-2020 me sukses dhe nuk përmendet askund e kundërta.

Kështu që, në përfundim, GVJ nuk bën ndryshim në draft-raportin e saj në lidhje me sa më sipër, referuar mospërbushjes së detyrimit nga departamenti për mbulimin e ngarkesës së programit MP "E drejtë private" në min 70% nga PAE, për vitin akademik 2019-2020.

- Në lidhje me personelin akademik të departamentit që angazhohet në këtë program studimi, MP në "E drejtë private",
 - për vitin akademik 2019-2020, 4 janë PAE, dhe 6 PAK;
 - për vitin akademik 2020-2021, 3 janë PAE dhe 6 PAK.



Pra për vitin akademik 2020-2021, në këtë program studimi janë angazhuar gjithsej 9 pedagogë, ku 3 janë PAE dhe 6 PAK (ndonëse edhe këtu diku tabelat në RVB kanë pasaktësi, p.sh. në tabelën 7- Aneks RVB në lidhje me raportin PAE/PAK për vitin akademik 2020-2021 të angazhuar në këtë program studimi).

Ky numër për vitin akademik 2020-2021, ku 3 janë PAE dhe 6 PAK është evidentuar nga GVJ në raportin e vlerësimit të jashtëm, mbi bazën e dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe shqyrtuar prej saj, dhe po ashtu edhe nga raporti i institucionit (RVB) për këtë vit akademik. Pra për vitin akademik 2020-2021 është angazhuar 1 PAE më pak, sesa një vit më parë.

Kështu që, në përfundim, të dhënat e vendosura në raportin e GVJ-së në Standartin II.2, në lidhje me numrin e personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë dhe të pjesshme, janë korrekte dhe nuk ndryshojnë.

- Për vitin akademik 2020-2021, në lidhje me ngarkesën e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi, sërish nga tabelat në Aneks RVB, rezulton një mospërputhje mes tabelave (tabelës 12 me tabelën 10 dhe 13). Për këtë vit akademik, mbulimi i ngarkesës nga stafi akademik me kohë të plotë në raport me atë me kohë të pjesshme ka pësuar ndryshim nga një vit më parë, dhe ka rritje në këtë raport (%), (Tabela 12 aneks RVB), por përsëri nuk arrin minimumin 70% të mbulimit nga PAE.

- Në përfundim, duke vlerësuar angazhimin e AU-së për të reflektuar dhe marrë masa për plotësimin e rekomandimeve të lëna, GVJ thekson se mbulimi në min. 70% i ngarkesës së programit nga personeli akademik me kohë të plotë, duhet të jetë prioritet dhe një kriter që duhet të garantohet me rigorozitet nga departamenti në çdo vit akademik në vijimësi, për një program studimi.
- Në lidhje me rekrutimin e stafit akademik, sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve rregullatore të institucionit, ka kritere të përcaktuara (si kritere të përgjithshme ashtu edhe specifike). Nisur nga fakti që edhe në rekomandimet e BA nga akreditimi i mëparshëm është lënë që institucioni duhet të plotësojë detyrimin për mbulimin e ngarkesës mësimore të këtij programi në masën të paktën 70% me PAE, mangësi kjo e konstatuar nga GVJ edhe për efekt të këtij riakreditimi, siç është përmendur edhe më sipër, GVJ rekomandon që në nevojat që evidentohen nga departamenti dhe për pasojë kriteret e shpallura për vende vakante (kriteret specifike veçanërisht), duhet të mbahet parasysh domosdoshmëria për plotësimin e personelit akademik me kohë të plotë me kompetenca dhe formim akademik, që t'i përgjigjet detyrimit ligjor për mbulimin e ngarkesës mësimore të programit të studimit në masën të paktën 70%.
- Duke qenë të ndërgjegjshëm për vështirësitë e krijuar nga situata e pandemisë në IAL-të, GVJ vlerëson përgjigjen e dhënë nga AU për t'u angazhuar në përmbushjen e detyrimeve të lëna pa plotësuar nga akreditimi i mëparshëm, por edhe për marrjen e masave për plotësimin e rekomandimeve të lëna për efekt të këtij riakreditimi.



SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr.24, datë 12.04.2019, janë:

1. Institucioni, të rekrutojë staf të ri akademik efektiv, me grada dhe tituj, me qëllim mbulimin e ngarkesës mësimore nga staf akademik efektiv në masën të paktën 70 %;
2. Institucioni, në procesin e rekrutimit të stafit të ri akademik, të mbajë parasysh, angazhimin në mësimdhënie të stafit akademik me kualifikimin e nevojshëm sipas kërkesave ligjore në fuqi;
3. Institucioni, të rrisë rolin e tij në ofrimin e mundësive të mëtejshme dhe mbështetjen financiare për kërkim shkencor, kualifikime, apo mobilitet për stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi, brenda apo jashtë vendit, përmes aplikimit në projekte të ndryshme ose forcimit të bashkëpunimit me Institucione rajonale apo të vendeve të Bashkimit Europian;
4. Institucioni, të shtojë, zbatojë më mirë praktikisht apo dhe të rishikojë marrëveshjet e bashkëpunimit, veçanërisht ato me Institucione ndërkombëtare, për t'iu përgjigjur sa më mirë kërkesave të programit të studimit, rritjes së shkëmbimit e mobilitetit si dhe aktiviteteve të përbashkëta që mund të organizohen për studentët e këtij programi studimi.
5. Institucioni, të mundësojë aksesimin e bibliotekës së Fakultetit për studentët e këtij programi Master Profesional, gjatë procesit të realizimit të procesit mësimor, edhe pas orës 16:00 të shërbimit në bibliotekë;
6. Institucioni, të shohë mundësinë e angazhimit të një eksperti të jashtëm për një vlerësim sa më objektiv dhe kritik të cilësisë së programit të studimit.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni (AU)

1. Institucioni, të rekrutojë staf të ri akademik efektiv, me grada dhe tituj, me qëllim mbulimin e ngarkesës mësimore nga staf akademik efektiv në masën të paktën 70 %;
 - Nga sa rezultojnë, GVJ konstaton se ky rekomandim ende nuk është përmbushur, pasi nuk respektohet raporti në mbulimin e ngarkesës mësimore për këtë program studimi me të paktën 70% PAE dhe 30 % PAK.
Rezultoni se mbulimi me ngarkesë i planit mësimor nuk plotëson detyrimin 70% PAE/30 % pak. Konkretisht për vitin akademik 2019-2020, ky mbulim është 51.3 % e ngarkesës në planin mësimor të këtij programi studimi mbulohet nga PAE dhe 48.6% nga PAK.
2. Institucioni, në procesin e rekrutimit të stafit të ri akademik, të mbajë parasysh, angazhimin në mësimdhënie të stafit akademik me kualifikimin e nevojshëm sipas kërkesave ligjore në fuqi;
 - GVJ konstaton se në këtë program studimi nga ana e institucionit është rekrutuar si PAE një pedagoge me gradën shkencore 'Doktor', e cila më parë ka qenë personel akademik me kohë të pjesshme, e që mbulon lëndë në këtë program studimi, duke e cuar nr. e PAE në 4 dhe PAK në 6 për vitin akademik 2019-2020. Por ndërkohë, vërehet se nr. PAE është ulur, dhe për vitin akademik 2020-2021 janë angazhuar në

këtë program studimi 3 PAE dhe 6 PAK. Stafit akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi si titullar i lëndës mban gradën shkencore “Doktor” ose ‘tituj akademik ‘Profesor’, ndërkohë që si asistentë/pedagog i dytë në lëndë aktivizohen edhe pedagogë që ende janë në process doktrature apo pa doktoraturë (Msc.apo Magister).

3. Institucioni, të rrisë rolin e tij në ofrimin e mundësive të mëtejshme dhe mbështetjen financiare për kërkim shkencor, kualifikime, apo mobilitet për stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi, brenda apo jashtë vendit, përmes aplikimit në projekte të ndryshme ose forcimit të bashkëpunimit me Institucione rajonale apo të vendeve të Bashkimit Europian;
 - Në lidhje me kërkimin shkencor, pjesëmarrjes në projekte dhe mundësisë për mbështetje (përfshirë edhe atë financiare) nga institucioni, nuk vërehet ndonjë ndryshim. Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike, ndër të tjera, ka si detyrë të bashkërendojë punën me departamentin për aplikimin dhe pjesëmarrjen në projekte kërkimore brenda dhe jashtë vendit, si dhe duhet të kontribuojë në përfshirjen e stafit akademik të departamentit në projekte institucionale apo ndër-universitare, sipas përcaktimeve në aktet rregullatore të institucionit (*Rregullore e Përgjithshme e AU-së*). Nga takimi në AU me përfaqësuesen e Zyrës përgjegjëse për këtë qëllim, nuk u bë e qartë si lidhej dhe ku kishte konsistuar mbështetja e kësaj zyre për departamentin. GVJ mendon se kjo zyrë duhet të ketë një platformë më të qartë të punës së saj, në funksion të koordinimit më të mirë të kërkimit dhe projekteve shkencore me departamentin dhe mbështetjen që duhet t’i japë atij.
 - Duhet theksuar se AU ka shtuar përpjekjet për rritjen e bashkëpunimit me institucione të tjera, veçanërisht ato me institucione ndërkombëtare, ku përmendim një marrëveshje tre vjeçare me universitetin e Salernos, që të mundësohet pjesëmarrja e stafit në shkëmbim/mobilitet në kuadër të programit Erasmus+. Nga të dhënat për stafin akademik të departamentit, përgjegjësi i departamentit është ai që ka qenë i angazhuar në këtë program mobiliteti për mbajtjen e një leksioni (mësimdhënie) në Universitetin e Salernos, në mars 2020.
4. Institucioni, të shtojë, zbatojë më mirë praktikisht apo dhe të rishikojë marrëveshjet e bashkëpunimit, veçanërisht ato me Institucione ndërkombëtare, për t’iu përgjigjur sa më mirë kërkesave të programit të studimit, rritjes së shkëmbimit e mobilitetit si dhe aktiviteteve të përbashkëta që mund të organizohen për studentët e këtij programi studimi.
 - Marrëveshjet e bashkëpunimit janë ato që kanë qenë edhe më parë, me institucione të administratës, subjekte private, zyra noterie apo avokatie, OJF. Ndërkaq vërehet se AU ka bërë përpjekje për të rritur bashkëpunimin me institucione të tjera në arsimin e lartë brenda dhe jashtë vendit me qëllim krijimin e hapësirave dhe mundësive të ndryshme për studentët si edhe stafin akademik. Kështu përmendim se AU ka lidhur edhe një marrëveshje të re bashkëpunimi me Universitetin e Salernos në Itali, që i shtohet marrëveshjeve të mëparshme që ka pasur, me qëllim që Departamenti të rrisë mundësinë për shkëmbime dhe mobilitet të stafit akademik dhe studentëve të tij. Nga dokumentacioni në dosje dhe vizita në AU, konstatohet se në semestrin e dytë të vitit akademik 2019-2020, 4 studentë të këtij departamenti

(jo të programit të studimit) kanë zhvilluar semestrin e dytë në Universitetin e Salernos, si pjesë e programit të mobilitetit studentor Erasmus +.

5. Institucioni, të mundësojë aksesimin e bibliotekës së Fakultetit për studentët e këtij programi Master Profesional, gjatë procesit të realizimit të procesit mësimor, edhe pas orës 16:00 të shërbimit në bibliotekë;
 - Nga konstatimi i GVJ, rezulton se orari i bibliotekës nuk ka ndryshuar. Ky orar shërbimi vlen për të gjithë studentët, përfshirë edhe ata të programit të studimit MP në “E drejtë private”. Biblioteka punon gjatë orarit 08:00-16:00 nga e hëna në të premte, dhe 08:00-12:00 ditën e shtunë. Ky orar është dhe i afishuar në hyrje të bibliotekës. Pra pas orës 16.00, biblioteka nuk ofron shërbim. Si arsye për këtë, përmenden nr. i vogël i studentëve në këtë program studimi, por edhe për shkak të situatës së pandemisë dhe zhvillimit të mësimin dhe aktivitetëve të tjera online, nga semestri II i vitit akademik 2019-2020 e në vijim, mundësisë për akses në bibliotekën online.
6. Institucioni, të shohë mundësinë e angazhimit të një eksperti të jashtëm për një vlerësim sa më objektiv dhe kritik të cilësisë së programit të studimit.
 - GVJ konstaton se institucioni nuk ka angazhuar ndonjë ekspert të jashtëm për këtë qëllim. Pra rekomandimi i paplotësuar.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

9

“E drejtë private”

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT


Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Programi i studimit Master Profesional “E drejtë private” është një nga programet e ciklit të dytë që ofrohen nga Departamenti i Shkencave Juridike, Fakulteti i Shkencave Shoqërore, AU. Programi i studimit MP në “E drejtë private” u ofron studentëve arsimit dhe trajnim të mëtejshëm profesional, në fushën e të drejtës private.</p> <p>Ky program ka për qëllim kryesor të kontribuojë në rritjen e cilësisë profesionale të studentëve, të thellimit të njohurive të tyre në fushën juridike dhe që duan të vijojnë më tej karrierën e tyre profesionale në fushën e shkencave juridike, të specializuar në të drejtën private. (<i>Evidenca 1.5-Rregullore MP në E drejtë private</i>).</p> <p>Qëllimi i këtij programi studimi është të formojë specialistë në fushën e të drejtës private, nëpërmjet kombinimit të aspektit të njohurive të thelluara teorike me aspektin praktik, përmes bashkëpunimit me organe të sistemit të drejtësisë apo edhe me subjekte të tjera publike apo private, vendase apo të huaja, pranë të cilave do të zhvillohen stazhi dhe praktika profesionale (<i>Evidenca 1.5 -Rregullore MP në E drejtë private</i>).</p> <p>Gjithashtu, ky program studimi është ndërtuar dhe azhurnuar për t’iu përshtatur ndryshimeve dhe zhvillimeve në fushën e arsimit të lartë, por edhe në fushën e drejtësisë, reformave institucionale që kanë ndodhur në vend, reformës në drejtësi, ecurisë së proceseve të integritetit evropian të vendit, etj. Qëllimi ka qenë përshtatja me ndryshimet e legjislacionit të arsimit të lartë dhe qenia në koherencë me nevojat e tregut të punës për juristë të specializuar (<i>Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20; Evidenca 1.1.a - Analizë për tregun e punës, MP në E drejtë private 2020-2021</i>).</p> <p>Ky program studimi është hartuar duke marrë parasysh nevojat e tregut të punës dhe zhvillimin ekonomik të vendit, në përputhje me objektivat kombëtarë dhe ndërkombëtarë dhe nuk bie ndesh me interesat dhe vlerat kulturore kombëtare (<i>Evidenca 1.5-Rregullore MP në E drejtë private, neni 4/2</i>).</p>
Kriteri 2 Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Programi i studimit MP në “E drejtë private” synon të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetëritimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e të rinjve të denjë për një shoqëri bashkëkohore, duke u bërë kështu përçues dhe mbrojtës të vlerave akademike dhe interesave kombëtare (<i>Evidenca 1.1- Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional 2017-2022 të AU-së; Evidenca 1.3- Plani Strategjik i Departamentit të Shkencave Juridike, viti akademik 2020-2021</i>).</p>
Kriteri 3 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e	<p>Programi i studimit Master Profesional në “E drejtë private” ofrohet në përputhje me Planin Strategjik të Zhvillimit Institucional 2017-2022. Ai synon të mbajë parasysh nevojat e studentëve, t’i përgjigjet zhvillimeve</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

10



institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	të kohës për një arsim të lartë cilësor, të përgatisë specialistë në fushat përkatëse dhe kërkues të rinj, për të kontribuar në zhvillimin e vendit por edhe më gjerë, nëpërmjet konsolidimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm të kapaciteteve institucionale (<i>Evidenca 1.1 -Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional 2017-2022 të AU-së</i>).			
Kriteri 4 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Në përmbushje të Planin Strategjik të Zhvillimit Institucional 2017-2022 të AU-së (<i>Evidenca 1.1 -Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional 2017-2022 të AU-së</i>), Departamenti i Shkencave Juridike ka hartuar edhe planin e tij strategjik për vitin akademik 2020-2021, përmes së cilit synon të identifikohet si një alternativë e besueshme, profesionale dhe konkurruese në fushën e arsimit të lartë në vend (<i>Evidenca 1.3-Plani Strategjik i Departamentit të Shkencave Juridike, viti akademik 2020-2021</i>). Përmes programit të studimit MP në “E drejtë private” synohet të ofrohen standarde dhe cilësi për studentët e këtij programi, për të përgatitur juristë të specializuar, në përshtatje me zhvillimet ekonomike e sociale të vendit dhe nevojat e tregut të punës (<i>Evidenca 1.3- Plani Strategjik i Departamentit të Shkencave Juridike, viti akademik 2020-2021</i>). Qëllimi është të sigurohet një rritje cilësore për t’iu përgjigjur ekonomisë së tregut, nevojave për juristë të specializuar dhe rritjes së nivelit mësimor e kërkimor të krahasueshëm me standardet e universiteteve perëndimore, si një qendër me rëndësi e arsimit në vend.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Në Planin Strategjik të Zhvillimit Institucional 2017-2022, AU angazhohet në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm dhe të konsolidimit të programeve mësimore në përputhje me objektivat e formimit dhe impaktin shoqëror për këto programe studimi që ofrohen (<i>Evidenca 1.1- Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional 2017-2022 të AU-së</i>). Programi i studimit MP “E drejtë private” që ofrohet nga Departamenti i Shkencave Juridike është hartuar në përputhje me këtë strategji 5 vjeçare për zhvillimin e IAL-së dhe akteve të tjera rregullatore të miratuara nga institucioni. Për këtë qëllim, Departamenti i Shkencave Juridike ka hartuar Planin Strategjik të Departamentit për vitin akademik 2020-2021 (<i>Evidencë 1.3 - Plani Strategjik i Departamentit të Shkencave Juridike, viti akademik 2020-2021</i>), si dhe ka përcaktuar në të objektivat afatshkurtra në përgjigje të objektivave strategjike institucionale. Një nga objektivat kryesorë është përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe përvetësimit të dijeve nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm të burimeve njerëzore dhe kulturës së cilësisë së mësimdhënies përmes rritjes së standardeve të cilësisë (<i>Evidencë 1.3- Plani Strategjik i Departamentit të Shkencave Juridike, viti akademik 2020-2021</i>).

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

11

<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Statuti i AU-së përcakton në nenin 7/3: “AU përgatit specialistëtë rinj përmes tre ciklesh të arsimimit universitar nëpërmjet programeve të tij të studimit dhe specializimeve në fushën e stomatologjisë dhe në fusha të tjera në përputhje me programet e studimit që ai ofron dhe në funksion të kërkesave të tregut të punës” (Evidenca 1.4, Statuti i AU-së, neni 7/3).</p> <p>Programet e studimit hartohen nga fakultetet dhe miratohen nga Senati Akademik i AU-së, në përputhje me legjislacionin shqiptar për arsimin e lartë dhe në përputhje me nivelin përkatës (niveli 7) të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (Evidenca 1.4- Statuti i AU-së, neni 53).</p> <p>Programi i studimit MP në “E drejtë private” ka strukturën dhe përmbajtjen e tij konform legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, dhe që në mënyrë më të hollësishme përcaktohet në Rregulloren përkatëse të programit të studimit MP në “E drejtë private” (Evidenca 1.4- Statuti i AU-së, neni 53, pika 6 dhe 7 dhe Evidenca 1.2 - Rregullore e Përgjithshme e AU-së, Kreu IV).</p> <p>Nisur nga fakti që programi i studimit të nivelit të dytë MP në “E drejtë private” është 60 ECTS dhe ofrohet në dy semestra (Evidenca 1.5, Rregullore MP- E drejtë private, neni 6), <u>GVJ sugjeron që të rishikohet edhe neni 37/2 i Rregullores së Përgjithshme të AU-së, për të bërë përshtatje me programe studimi të ciklit të dytë MP që tashmë realizohen me 60 kredite ECTS në dy semestra.</u></p>
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Programit i studimit MP në “E drejtë private” ofrohet në përputhje me misionin, qëllimet dhe strategjinë për zhvillim të AU-së (Evidenca 1.5, Rregullore MP- E drejtë private, neni 4). Ai organizohet nga Fakulteti i Shkencave Shoqërore nën përgjegjësinë e Departamentit të Shkencave Juridike të këtij fakulteti, në bashkëpunim me njësitë e tjera të tij. Ky program studimi bazohet në një përvojë disvjeçare dhe në praktika të mira të vendeve europiane (Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private, neni 3 dhe 4).</p> <p>Studentët që ndjekin dhe përfundojnë këtë program studimi të ciklit të dytë, do të kenë mundësi të punësohen apo të vijojnë karrierën e tyre profesionale në një sërë sektorësh apo organesh që lidhen me aplikimin e dijeve dhe formimit që studentët e këtij programi kanë përftuar, në fushën e së drejtës private (Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20; Evidenca 1.1.a - Analizë për tregun e punes, MP në E drejtë private 2020-2021; (Evidenca 1.3- Plani Strategjik i Departamentit të Shkencave Juridike, viti akademik 2020-2021).</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.</p>	<p>Ky program studimi është hartuar duke marrë parasysh nevojat e tregut të punës dhe zhvillimin ekonomik të vendit, në përputhje me objektivat kombëtarë dhe ndërkombëtarë dhe nuk bie ndesh me interesat dhe vlerat kulturore kombëtare (Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private, neni 4/2).</p> <p>Gjithashtu, ky program studimi është ndërtuar dhe azhurnuar për t’iu përshtatur ndryshimeve dhe zhvillimeve në fushën e arsimit të lartë, por edhe përshtatje në fushën e drejtësisë, për të qenë në koherencë me nevojat e tregut të punës për juristë të specializuar (Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20; Evidenca 1.1.a - Analizë për tregun e punes MP në E drejtë private 2020-2021; (Evidenca 1.3- Plani</p>

	Strategjik i Departamentit të Shkencave Juridike, viti akademik 2020-2021).			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programet e studimit “Master profesional” synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit “Master profesional” kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi i studimit MP në “E drejtë private” ka përcaktuar objektivat e tij, duke synuar të përgatisë profesionistë të fushës të së drejtës private, të aftë për t’iu përgjigjur rritjes së aftësive profesionale dhe nevojave të tregut të punës për juristë të specializuar në fushën e së drejtës private. Ai ka të përcaktuar qartë objektivat e përgjithshëm dhe objektivat specifikë të tij. Ky program studimi synon të japë dije dhe aftësi profesionale të nevojshme për studentët e këtij programi, të rrisë kompetencën profesionale të tyre, si dhe zotërimin e aftësive të nevojshme në zbatimin praktik të njohurive dhe dijeve të përfuara (<i>Evidenca 1.5- Rregullore MP në E drejtë private</i>).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, dhe dokumentacionit në dosje, GVJ identifikoi se departamenti në analizën vjetore të tij, ka nxjerrë edhe disa nga këto nevoja. (<i>Evidenca 1.1.a - Analizë për tregun e punës, MP në E drejtë private 2020-2021; Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20 dhe Minutat e vizitës së GVJ në AU</i>). Megjithatë, GVJ gjatë vizitës dhe takimeve të zhvilluara nuk mori informacion konkret në lidhje me ecurinë në vijim të këtij programi, pritshmëritë e institucionit dhe projeksionin për të ardhmen e tij. Në kuadër të programeve të integruara 5 vjeçare në drejtësi në përfundim të të cilave studentët pajisen më diplomën Master i Shkencave, sipas interlokutorëve është e pritshme që interesi për programet master në përgjithësi të bjerë, veçanërisht në MP. (<i>Takimet në AU, Minutat e vizitës së GVJ në AU</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Departamenti ka kryer një studim të fundit për tregun e punës për këtë program studimi (<i>Evidenca 1.1.a - Analizë për tregun e punës, MP në E drejtë private 2020-2021</i>).</p> <p>GVJ pasi u njoh me këtë studim, vëren se më shumë ai është një analizë e përgjithshme e disa të dhënave të marra nga burime të ndryshme për ata që diplomohen në fushën juridike dhe të arsimit të lartë në tërësi, sesa analizë e të dhënave konkrete nga punësimi real i studentëve të këtij programi. Po ashtu, nuk evidentohen në këtë studim të dhëna konkrete të komunikimit të departamentit me punëdhënësit të ndryshëm ku janë punësuar studentët e diplomuar në këtë program studimi apo nevojat e tyre. Gjithashtu, duhet theksuar se ky studim i referohet tregut lokal.</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit</p>	<p>Referuar këtij program studimi, rezulton se janë përcaktuar objektivat e përgjithshme dhe specifike të tij. Po ashtu, struktura dhe përmbajtja e tij janë hartuar duke respektuar kërkesat e legjislacionit</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

13

<p>garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>në fuqi për arsimin e lartë, si dhe rezultatet e pritshme të të nxënësve. Qëllimi kryesor është rritja e cilësisë profesionale të studentëve të ciklit të parë të studimeve Bachelor apo studimeve të nivelit të dytë të integruar dhe që duan të vijojnë më tej karrierën profesionale për t'u specializuar në fushën e të drejtës private (<i>Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private, neni 4/3</i>).</p> <p>Po ashtu, objektivat e këtij programi synojnë të kombinojnë dijet dhe njohuritë teorike me aspektin praktik, për përgatitjen apo kualifikimin e mëtejshëm të studentëve me qëllim punësimi, duke ndjekur edhe politika favorizuese për punësimin e të diplomuarve të këtij programi (<i>Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private, neni 4/4</i>).</p> <p>Gjithashtu, ky program studimi vë theksin tek kompetencat specifike në fushën e të drejtës civile, kontraktore, në të drejtën e shoqërive tregtare, të drejtën familjare, të punës, procedurës civile, mbështetur në qasje krahasimore mes legjislacionit vendas me atë të huaj. Programi synon të kombinojë njohuritë teorike me praktikën, dhe realizohet në bashkëpunim me gjykata të niveleve të ndryshme, apo edhe me studio ligjore. Mundësitë për punësim variojnë dhe lidhen me profile të tilla si: jurist/konsulent ligjor në banka, firma dhe biznese private, shoqëri sigurimesh, jurist pranë autoriteteve të pavarura, noteri, avokaturë, përmbarues gjyqësor, nëpunës në administratën publike, ndërmjetës (<i>Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private</i>).</p> <p>Sidoqoftë, GVJ mendon se objektivat e programit duhet të mbajnë në vëmendje uljen e ndjeshme të numrit të studentëve të këtij programi MP, sidomos në kuadër dhe të organizimit të programeve të integruara 5-vjeçare në fushën e drejtësisë.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Siç përcaktohet edhe në aktet dhe dokumentacionin institucional, programi i studimit MP në “E drejtë private” është konkures në lidhje me elementët që përmban dhe strukturën e tij, për të pasur një kurikulë sa më bashkëkohore (<i>Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private dhe Evidenca 1.1.a - Analizë për tregun e punës, MP në E drejtë private 2020-2021</i>). Ky program përbëhet nga module/lëndë të veçanta dhe vlerësohet në kredite ECTS duke lehtësuar kështu njohjen e krediteve për efekt transferimi të studimeve (<i>Evidenca 1.5, Rregullore MP në E drejtë private dhe Evidenca 2.1. – Plani mësimor i programit MP në “E drejtë private”</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disa vjeçare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Sipas rregullores së programit, programi i studimit MP në “E drejtë private” është bazuar në modele dhe eksperiencat më të mira të universiteteve evropiane si dhe në praktikën disa vjeçare të tij (<i>Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private dhe Evidenca 2.1. – Plani mësimor i programit MP “E drejtë private”</i>). Por në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe nga kontaktet në institucion, nuk përcaktohet se në cilat modele të universiteteve evropiane janë bazuar për të ndërtuar këtë program studimi.</p> <p>Ky program studimi, ashtu si edhe programet e tjera që ofron Departamenti i Shkencave Juridike mbështeten në kërkesat e legjislacionit shqiptar në fushën e arsimit të lartë, të orientuar drejt Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë (<i>Evidenca 1.3 - Plani</i></p>

	<i>Strategjik i Departamentit të Shkencave Juridike, viti akademik 2020-2021).</i>			
Kriteri 6. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.	Nisur nga objektivat e këtij programi studimi, aftësimi profesional dhe angazhimi i studentëve në praktika profesionale, zë një vend me rëndësi në veprimtaritë dhe strukturën e këtij programi. Praktika profesionale përbën 10% të krediteve të këtij program studimi (6 ECTS) dhe zhvillohet në bashkëpunim me institucione dhe organizata partnere me të cilat Departamenti ka marrëveshje bashkëpunimi për këtë qëllim, p.sh. gjykata, prokurori, studio ligjore/zyrë avokatie, Ministria e Drejtësisë, Gjykata Kushtetuese, Shërbimi i Provës, Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësimit, OJF të ndryshme (<i>Evidenca 1.3 - Plani Strategjik i Departamentit të Shkencave Juridike, viti akademik 2020-2021 dhe Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20</i>).			
Kriteri 7. Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.	Programi i studimit MP në “E drejtë private” zhvillohet në gjuhën shqipe dhe nuk ka elementë të mësimdhënies që mund të zhvillohen në gjuhë të huaj. (<i>Konstatim i GVJ-së. Shih gjithashtu edhe RVB, kriteri 7, Standarti I.3</i>).			
Kriteri 8. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësimit të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.	Programi i studimit të ciklit të dytë Master Profesional në ‘E drejtë private’ aktualisht është organizuar me 60 kredite ECTS, është një program i licensuar dhe akredituar. Ky program studimi është aktiv (<i>Evidenca 3.8 - 8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20</i>). Për shkak të rënies së numrit të studentëve që e ndjekin atë, siç del nga të dhënat institucionale dhe vizita në institucion, mund të shihet në të ardhmen mundësia e mbajtjes ose jo të këtij programi, apo riorganizimi i tij. (<i>Minutat e vizitës së GVJ-së në AU</i>).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.4	
Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Programi i studimit Master Profesional në “E Drejtë Private” është një nga programet që ofron Departamenti i Shkencave Juridike, program i hapur për herë të parë në vitin akademik 2012-2013. Viti akademik 2019-2020 shënon vitin e 15 të jetës së këtij Departamenti. Akreditimi i fundit i këtij programi është bërë me Vendim të Bordit të Akreditimit, nr. 24, datë 12.04.2019, me afat 1 vit akademik dhe vlefshmëri deri në 30.09.2020 (<i>Evidenca 3.8 - Raporti Vjetor DSHJ 19-20</i>). Stafi i angazhuar në këtë departament dhe që aktivizohet edhe në programin e studimit MP “E drejtë private” është një staf me

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

15

	<p>eksperiencë në fushën e mësimdhënies. Në vitin akademik 2019-2020, në këtë departament janë aktivizuar 29 pedagogë, ku 9 janë personel akademik me kohë të plotë (PAE) dhe pjesa tjetër (20) personel akademik me kohë të pjesëshme (PAK). Nga PAE, 5 prej tyre janë me gradën shkencore “Doktor” ose PhD dhe pjesa tjetër janë në proces doktorature (<i>Evidenca 3.8 - Raporti Vjetor DSHJ 19-20</i>). Nga PAK, 11 prej tyre janë me tituj dhe grada, ndërsa të tjerët në proces doktorature apo Msc.ose Magjistratë.</p> <p>Në programin e studimit MP në “E drejtë private” pas kërkesës për sqarim/saktësim nga GVJ dhe informacionit të përditësuar nga AU, angazhimi i personelit akademik është si më poshtë:</p> <p>a) Për vitin akademik 2019-2020 janë angazhuar 4 PAE dhe 6 PAK. Nga PAE, të gjithë janë me gradën shkencore “Doktor”. Në grupin e PAK ka 1 Prof. Dr; 1 në proces doktorature, 3 Msc dhe 1 Magjistrat.</p> <p>b) Për vitin akademik 2020-2021 janë angazhuar 3 PAE dhe 6 PAK. Nga PAE, të gjithë janë me gradën shkencore “Doktor”. Në grupin e PAK ka 2 Dr; 3 Msc dhe 1 Magjistrat.</p> <p>(<i>Evidenca 3.8 - Raporti Vjetor DSHJ 19-20; Minutat e vizitës së GVJ-së në AU; Evidenca shtesë – Tabelat me ngarkesa dhe sqarimet; Aneks RVB – Tabelat Përmbledhëse MP në E drejtë Private</i>).</p> <p>Kështu, departamenti për të përmbushur objektivat e këtij programi studimi, ka angazhuar burime njerëzore të kualifikuara në përputhje me profilin dhe kërkesat e programit të studimit, por që siç rezultojnë nga dokumentacioni i dorëzuar dhe nga vizita në institucion, më së shumti është personel akademik me kohë të pjesëshme ai që angazhohet në programin e studimit MP në “E drejtë private” (<i>Evidenca 3.8 - Raporti Vjetor DSHJ 19-20 dhe Minutat e vizitës së GVJ-së në AU dhe Evidenca shtesë – Tabelat me ngarkesa dhe sqarimet; Aneks RVB – Tabelat Përmbledhëse MP në E drejtë Private</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit MP në “E drejtë private” është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Shkencave Juridike, si një nga tre programet e ciklit të dytë, që ky departament ofron.</p> <p>Ky program është në përputhje me legjislacionin e arsimit të lartë në fuqi (LAL dhe aktet nënligjore në zbatim të tij), me aktet e tjera rregullatore të Albanian University, si dhe në përputhje me Kuadrin Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, standartet dhe parimet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë.</p> <p>Gjithashtu, ky program është hartuar në përputhje me nivelin e kualifikimit të përcaktuar - niveli 7 i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.</p> <p>(<i>Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private; Evidenca 1.3- Plani Strategjik i Departamentit të Shkencave Juridike, viti akademik 2020-2021</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas</p>	<p>Programi i studimit MP në “E drejtë private” është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Shkencave Juridike, si një nga tre programet e ciklit të dytë të fushës juridike, që ky departament ofron. Ky program nuk është ndërdisiplinar.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

16

klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Ky program është në përputhje me legjislacionin e arsimit të lartë në fuqi (LAL dhe aktet nënligjore në zbatim të tij), me aktet e tjera rregullatore të Albanian University, si dhe në përputhje me Kuadrin Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, standartet dhe parimet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë. Gjithashtu, ky program është hartuar në përputhje me nivelin e kualifikimit të përcaktuar - niveli 7 i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (<i>Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private; Evidenca 1.3- Plani Strategjik i Departamentit të Shkencave Juridike, viti akademik 2020-2021</i>).			
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	n/a			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Numri i studentëve që ndjekin aktualisht këtë program është i vogël: 9 studentë - Për vitin akademik 2019-2020; dhe 6 studentë - Për vitin akademik 2020-2021). Për një mbarëvajtje sa më normale të tij, institucioni ka marrë masa dhe vë në dispozicion personelin dhe infrastrukturën e nevojshme në funksion të këtij program studimi, kështu institucioni ka angazhuar të gjithë strukturën dhe logjistikën që disponon. Edhe gjatë vizitës së GVJ në institucion, në takime me drejtuesin e departamentit dhe pedagogë e pjesën tjetër të stafit administrativ të kontaktuar, rezultoi se bashkëpunimi mes departamentit që mbulon këtë program dhe strukturave të tjera universitare, sipas përgjegjësiive dhe funksioneve, ishte një praktikë normale pune. Përgjegjësitë e njësisë bazë, kryesore dhe strukturave të tjera përgjegjëse për çështje/funksione të caktuara si dhe bashkëpunimi mes tyre, janë të përcaktuara në Statutin dhe Rregulloren e përgjithshme të AU-së, si dhe Rregulloret e tjera të nxjerra nga AU (i.e. <i>Evidenca 1.4 – Statuti i AU-së; Evidenca 1.2- Rregullore e Përgjithshme e AU-së; Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private; Evidenca 2.3 –Rregullore e transferimeve dhe regjistrimeve; Evidenca 5.1. – Rregullore e Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentëve; Evidenca 5.2 – Rregullore e Zyrës së Karrierës dhe Alumnit; Evidenca 6.6 – Rregullore për mbarëvajtjen e kurrikulave; Evidenca 6.8 – Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-së</i>).
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të	AU për realizimin e objektivave të programit të studimit ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

17

<p>studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>jashtë vendit, aktorë nga sfera publike dhe ajo e biznesit vendas, si dhe shoqëria civile (p.sh. me gjykata, prokurori, zyrë përmbarimi, zyrë avokatie apo studio ligjore, zyrë noterie, Ministria e Drejtësisë, Shërbimi i Provës (MD), Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësimit, OJF, etj.) me qëllim krijimin e hapësirave dhe mundësive të ndryshme për studentët si edhe stafin akademik, gjë që u evidentua edhe nga takimet gjatë vizitës së GVJ në institucion (<i>Evidenca 1.6 –Marrëveshje bashkëpunimi të Departamentit të Shkencave Juridike; Minutat e vizitës së GVJ në AU</i>).</p> <p>Departamenti i Shkencave Juridike ka aktualisht 14 marrëveshje bashkëpunimi aktive me institucione vendase, ku vlen të përmendim se këto marrëveshje shërbejnë edhe për realizimin praktikave profesionale, në përmbushje të detyrimeve akademike që ka ky program studimi, për t’u përgjigjur sa më mirë kërkesave të programit të studimit, apo dhe aktiviteteve të përbashkëta që mund të organizohen me interes për studentët e këtij programi studimi (<i>Evidenca 1.6 –Marrëveshje bashkëpunimi të Departamentit të Shkencave Juridike</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Siç evidentohet nga dokumentacioni i dorëzuar nga AU dhe nga takimet e GVJ gjatë vizitës në institucion (i.e. takimi me Përgjegjësën e Departamentit), marrëveshjet e bashkëpunimit që ka nënshkruar departamenti me subjekte/institucionet përkatëse vlejné edhe për kryerjen e paraktikave profesionale, përfshirë këtu edhe studentët e programit të studimit MP në “E drejtë private” (<i>Evidenca 1.6 – Marrëveshje bashkëpunimi të Departamentit të Shkencave Juridike</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.</p>	<p>Marrëveshjet e bashkëpunimit që ka nënshkruar departamenti me subjekte/institucionet përkatëse vlejné edhe për kryerjen e praktikave profesionale (<i>Evidenca 1.6 – Marrëveshje bashkëpunimi të Departamentit të Shkencave Juridike</i>).</p> <p>Këto marrëveshje bashkëpunimi me studio ligjore/zyra avokatie, Institucione të Administratës Shtetërore (ministri), institucione të drejtësisë (gjykata), OJF, etj, ofrojnë mundësi të mira për studentët e këtij programi për t’u njohur me praktikën e institucioneve shtetërore, të drejtësisë, apo subjekteve private, për të gërshetuar aspektin teorik me atë praktik që merr rëndësi për profesionin e juristit (civilist). Realizimi i këtyre praktikave mbikqyret dhe menaxhohet nga departamenti për arritjen e rezultateve të përcaktuara në programin e studimit MP (<i>Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Nga dokumentacioni i paraqitur por dhe nga takimet e zhvilluara gjatë vizitës në AU, nuk rezulton që me përfundimin e këtij programi studimi, institucioni të ofrojë trajnim të mëtejshëm profesional për të diplomuarit. (<i>Minutat e vizitës në AU. Shih edhe RVB, Kriteri 5, Standarti I.5</i>).</p>
<p>Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur dhe mbledhur për këtë program studimi, nuk rezulton që Departamenti, në mënyrë periodike harton ndonjë raport të posaçëm analitik për përfitimet apo efektivitetin e këtyre marrëveshjeve të bashkëpunimit që ka me institucione dhe aktorë të ndryshëm.</p> <p>Megjithatë, GVJ konstaton se në Raportin vjetor të departamentit, bëhet një vlerësim, ku në këtë raport përveç listimit të marrëveshjeve</p>

	të bashkëpunimit që janë aktualisht, tek pikat e forta përmendet p.sh. zhvillimi i praktikave profesionale në gjykata të rretheve gjyqësore ku studentët kanë vendbanimin e tyre; ose tek pjesa e Rekomandimeve sugjerohet që për vitin akademik 2020-2021 të rritet bashkëpunimi me IAL të tjera vendase apo të huaja si dhe të konsolidohet bashkëpunimi me ato institucione/subjekte me të cilat AU ka lidhur marrëveshje (Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit MP në “E drejtë private” është program i ciklit të dytë, që është i organizuar në module/lëndë, me kreditet përkatëse ECTS. Ai ka 60 ECTS dhe zhvillohet në një vit akademik të ndarë në dy semestra (Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private; dhe Evidenca 2.1. – Plani mësimor i programit MP “E drejtë private”). Ky program është hartuar në përputhje me përcaktimet ligjore dhe ato nënligjore që burojnë nga legjislacioni në fushën e arsimit të lartë. Ndarja në kategoritë/disiplinat përkatëse, ngarkesa me ndarjet e orëve për çdo lëndë me kreditet përkatëse, për çdo semestër, përcaktohen hollësisht në Rregulloren e këtij programi studimi dhe planin mësimor të tij (Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private; dhe Evidenca 2.1. – Plani mësimor i programit MP “E drejtë private”).
Kriteri 2 Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	Ky program studimi i ciklit të dytë ka si objektive të formojë studentët me njohuri specifike në fushën e së drejtës private. Programi kombinon formimin akademik me përvojën praktike dhe realizohet në bashkëpunim me institucione të ndryshme pranë të cilave mund të zhvillohen edhe praktika profesionale. Studentët që ndjekin këtë program studimi do të kenë mundësi të punësohen apo të vijojnë karrierën e tyre profesionale në një sërë sektorësh apo organesh që lidhen me aplikimin e së drejtës private. Ky program i ofron mundësi studentëve të cilët duan të punojnë në administratën publike, fushën e avokatisë, si juristë pranë bizneseve, në ndërmarrje, banka, shoqëri sigurimesh dhe konsulentë ligjorë pranë

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

19

	autoriteteve të pavarura etj. (<i>Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private</i>).
Kriteri 3 Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Komponentët mësimorë të këtij programi ndahen në orë mësimi në auditor, si leksione, seminare/ushtrime, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor; studim individual, detyra apo projekte dhe përgatitje për provime apo përgatitjen e tezës së diplomës; praktika profesionale, praktika në terren apo stazh pranë subjekteve publike ose private. Ky program studimi i ofron studentëve njohuritë e nevojshme për të përvetësuar kompetenca të avancuara teorike dhe praktike në fushën e së drejtës private. (<i>Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private dhe Evidenca 2.1. – Plani mësimor i programit MP “E drejtë private”</i>).
Kriteri 4 Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Në këtë program studimi studenti merr njohuri/aftësi të thelluara dhe aftësim profesional me qëllim orientimin e tij praktik e profesional në fushën e së drejtës private, duke iu përshtatur gjithnjë e më shumë nevojave të tregut të punës si dhe zhvillimeve të vendit. Kështu p.sh. mund të përmendim lëndë të tilla si: e drejtë civile e avancuar, e drejtë pune e avancuar, procedurë civile e avancuar, apo e drejtë familjare e avancuar. (<i>Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private dhe Evidenca 2.1. – Plani mësimor i programit MP “E drejtë private”</i>).
Kriteri 5 Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Programi i studimit MP në “E drejtë private” është një program i ciklit të dytë të studimeve, i ndërtuar në përputhje me strategjinë 5 vjeçare për zhvillim të AU-së. Mbi këtë strategji institucionale, Departamenti i Shkencave Juridike ka hartuar strategjinë e tij për vitin akademik 2020-2021 (<i>Evidenca 1.3- Plani Strategjik i Departamentit të Shkencave Juridike, viti akademik 2020-2021</i>). Programi i studimit MP “E drejtë private” është hartuar në përputhje me strategjinë e AU-së, vizionin dhe misionin e saj, nevojat e tregut të punës për juristë të specializuar në drejtime të caktuara në fushën e së drejtës, misionin e arsimit të lartë në vend dhe objektivat e procesit të Bolonjës, dhe përpqet të përfshijë në mënyrën më të mirë të integruar, modelet dhe përvojën e fituar. Ai respekton kriteret e vendosura në VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar.
Kriteri 6 Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Programi i studimit MP në “E drejtë private” referuar legjislacionit për arsimin e lartë dhe akteve të brendshme rregullatore të institucionit, organizohet në module/lëndë që vlerësohen në kredite ECTS. Struktura e këtij programi ndahet në 5 disipline kryesore, ku janë grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite mbi bazën e VKM-së së sipërpërmendur (VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar). (<i>Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private dhe Evidenca 2.1. – Plani mësimor i programit MP “E drejtë private”</i>).
Kriteri 7 Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike	Ky program realizohet me 60 kredite ECTS dhe kohëzgjatje normale 1 vit akademik. Ai është strukturuar në bazë të VKM së sipërpërmendur VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

20

me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.	ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar dhe praktika profesionale zë 10% të krediteve të këtij programi studimi, pra 6 ECTS.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Fakulteti i Shkencave Shoqërore është njësi kryesore e AU-së, që organizon dhe drejton mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fusha të përafërta apo të ndërthurura me profilet shoqërore të njohura dhe licensuara nga organet shtetërore kompetente. Ky fakultet ofron disa lloje programesh, në ciklin e parë dhe të dytë të studimit, në përfundim të të cilave lëshohet diploma përkatëse për studentët që frekuentojnë këto programe.</p> <p>Bazuar në legjislacionin për arsimin e lartë në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore, ky fakultet ka strukturën e tij përbërëse, që përfshin 4 departamente si njësi bazë mësimore/kërkimore, ku një prej tyre është edhe Departamenti i Shkencave Juridike.</p> <p>Departamenti i Shkencave Juridike është njësi bazë mësimore dhe kërkimore - shkencore në Fakultet, sipas përcaktimeve të bëra në Statutin e AU-së, dhe aktet e tjera rregullatore, që ka për detyrë të organizojë dhe të administrojë veprimtaritë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor duke respektuar liritë akademike të personelit dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të tij. Mësimdhënia dhe aktiviteti kërkimor-shkencor ofrohen sipas standardeve të vendosura nga AU, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë. Departamenti i Shkencave Juridike është përgjegjës për programin e studimit MP “E drejtë private”.</p> <p><i>(Evidenca 1.2- Rregullore e Përgjithshme e AU-së; (Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private).</i></p>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	<p>Përgjegjësi i Departamentit të Shkencave Juridike mban gradën PhD ekuivalente me gradën shkencore “Doktor” në sistemin tonë.</p> <p>Stafi akademik i Departamentit të Shkencave Juridike përbëhet nga personel akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjeshme. Në përbërje të këtij stafi marrin pjesë specialistë të fushës juridike, me tituj e grada shkencore ose që kanë specializime të ndryshme, magjistratë apo edhe staf me diplomën ‘Master i Shkencave’.</p> <p>Në vitin akademik 2019-2020, në këtë departament janë aktivizuar 29 pedagogë, ku 9 janë personel akademik me kohë të plotë (PAE) dhe pjesa tjetër 20 personel akademik me kohë të pjeshme (PAK) dhe 2 staf PA.</p> <p><i>(Evidenca 3.8 - Raporti Vjetor DSHJ 19-20 dhe Minutat e vizitës së GVJ-së në AU dhe Evidenca shtesë – Tabelat me ngarkesa dhe sqarimet; Aneks RVB – Tabelat Përmbledhëse MP në E drejtë Private, Tabela 1).</i></p>

<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Nga stafi akademik i angazhuar në Departament për programin e studimit MP në “E drejtë private”, për vitin akademik 2019-2020, 4 janë PAE, dhe 6 PAK. Nga PAE, të gjithë (4) janë me gradën shkencore “Doktor”. Nga PAK, 1 prej tyre është Prof. Dr; 1 në proces doktorature, 3 Msc dhe 1 Magjistrat (Evidenca shtesë – Tabelat me ngarkesa dhe sqarimet; Evidenca 3.8 - Raporti Vjetor DSHJ 19-20; Minutat e vizitës së GVJ-së në AU).</p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Për vitin akademik 2020-2021, në këtë program studimi janë angazhuar 3 PAE dhe 6 PAK. Nga PAE, të gjithë (3) janë me gradën shkencore “Doktor”. Në grupin e PAK ka 2 Dr; 3 Msc. dhe 1 Magjistrat (Evidenca 3.8 - Raporti Vjetor DSHJ 19-20; Minutat e vizitës së GVJ-së në AU; Evidenca shtesë – Tabelat me ngarkesa dhe sqarimet; Aneks RVB – Tabelat Përmbledhëse MP në E drejtë Private).</p> <p>Kështu, departamenti për të përmbushur objektivat e këtij programi studimi, ka angazhuar burime njerëzore të kualifikuara në përputhje me profilin dhe kërkesat e programit të studimit, por që siç rezultojnë nga dokumentacioni i dorëzuar dhe nga vizita në institucion, më së shumti është personeli akademik me kohë të pjesshme ai që angazhohet në programin e studimit MP në “E drejtë private”. Raporti mes PAE/PAK në departament është: është 45 % PAE dhe 55 % PAK. Për pedagogët e këtij departamenti që angazhohen në Programin e Studimit MP “E drejtë private” raporti është 66.6 %/ 33.4 %.</p> <p>Po ashtu, edhe mbulimi me ngarkesë i planit mësimor nuk plotëson detyrimin 70% PAE/30 % pak. Konkretisht për vitin akademik 2019-2020, ky mbulim është 51.3 % e ngarkesës në planin mësimor të këtij programi studimi mbulohet nga PAE dhe 48.6% nga PAK. (Evidenca 3.8 - Raporti Vjetor DSHJ 19-20; Minutat e vizitës së GVJ-së në AU; Evidenca shtesë – Tabelat me ngarkesa dhe sqarimet; Aneks RVB – Tabelat Përmbledhëse MP në E drejtë Private).</p> <p>Në vitin akademik 2019-2020, në këtë departament janë aktivizuar 29 pedagogë, ku 9 janë personeli akademik me kohë të plotë (PAE) dhe pjesa tjetër 20 personeli akademik me kohë të pjesshme (PAK) dhe 2 PA. Nga PAE, 5 prej tyre janë me gradën shkencore “Doktor” ose PhD dhe pjesa tjetër - 4 janë në proces doktorature. Nga PAK, 11 prej tyre janë me tituj dhe grada, ndërsa të tjerët – 9 në proces doktorature apo Msc. ose Magjistratë.</p> <p>Në programin e studimit MP në “E drejtë private” pas kërkesës për sqarim/saktësim nga GVJ dhe informacionit të përditësuar nga AU, angazhimi i personelit akademik është si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Për vitin akademik 2019-2020 janë angazhuar 4 PAE dhe 6 PAK. Nga PAE, të gjithë janë me gradën shkencore “Doktor”. Në grupin e PAK ka 1 Prof. Dr; 1 në proces doktorature, 3 Msc dhe 1 Magjistrat. Për vitin akademik 2020-2021 janë angazhuar 3 PAE dhe 6 PAK. Nga PAE, të gjithë janë me gradën shkencore “Doktor”. Në grupin e PAK ka 2 Dr; 3 Msc. dhe 1 Magjistrat. <p>(Evidenca 3.8 - Raporti Vjetor DSHJ 19-20; Minutat e vizitës së GVJ-së në AU; Evidenca shtesë – Tabelat me ngarkesa dhe sqarimet; Aneks RVB – Tabelat Përmbledhëse MP në E drejtë Private).</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

22

	Kështu, departamenti për të përmbushur objektivat e këtij programi studimi, ka angazhuar burime njerëzore të kualifikuara në përputhje me profilin dhe kërkesat e programit të studimit, por që siç rezultojnë nga dokumentacioni i dorëzuar dhe nga vizita në institucion, më së shumti është personel akademik me kohë të pjesshme ai që angazhohet në programin e studimit MP në “E drejtë private” (Evidenca 3.8 - Raporti Vjetor DSHJ 19-20 dhe Minutat e vizitës së GVJ-së në AU dhe Evidenca shtesë – Tabelat me ngarkesa dhe sqarimet; Aneks RVB – Tabelat Përmbledhëse MP në E drejtë Private).			
Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.	Stafi i angazhuar në këtë departament dhe që aktivizohet edhe në programin e studimit MP “E drejtë private” mbulon edhe praktikën profesionale.			
Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Për programin e studimit MP “E drejtë private”, koordinatori është Përgjegjësi i Departamentit. Nga pikëpamja formale dhe nisur nga numri i ulët i studentëve në këtë program, Përgjegjësi i Departamentit mund të mbajë edhe rolin e koordinatorit për këtë program studimi. Meqë në këtë rast përgjegjësi i departamentit është edhe koordinatori i këtij program, raportimi mbetet tek Dekani i Fakultetit, kjo në lidhje me funksionin dhe hierarkinë institucionale			
Kriteri 7. Koordinatorit i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësies përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		
Standardi II.3				
Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga AU (përfshi këtu edhe dokumentacionin shtesë të kërkuar) dhe vizitës në institucion, vlerëson se departamenti zotëron dhe disponon informacionet e nevojshme në lidhje me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve, syllabuset e lëndëve.			
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Programi i studimit MP në “E drejtë private” respekton dhe është i organizuar sipas kriterëve të përcaktuara në LAL, VKM 41 (të sipërpërmendur) dhe aktet e tjera rregullatore në fuqi.			
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Programi i studimit MP në “E drejtë private” (60 ECTS) organizohet në lëndë/ module, të vlerësuara me kredite ECTS sipas sistemit shqiptar e evropian, i ndarë në dy semestra, 1 vit akademik. (Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private dhe Evidenca 2.1. – Plani mësimor i programit MP në “E drejtë private”).			

<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Programi i studimit MP në “E drejtë private” (60 ECTS) përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj. (<i>Evidenca 2.1. – Plani mësimor i programit MP në “E drejtë private”</i>).</p> <p>Organizimi i programit të studimit (vit, semestra, javë etj.)</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor; ➤ 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor; ➤ 1 ECTS baraz me 25 orë mësimore pune të studentit; ➤ Ora mësimore është 50 minuta. <p>Detaje të hollësishme në lidhje me planin mësimor, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë, orët në auditor/jashtë auditorit, ngarkesa e pedagogëve dhe mbulimi i lëndëve jepet në Tabelat e Aneks RVB .</p> <p>(<i>Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private dhe Evidenca 2.1. – Plani mësimor i programit MP në “E drejtë private” dhe Aneks RVB – Tabelat Përmbledhëse MP në E drejtë Private</i>).</p> <p>Sipas informacionit të marrë në institucion, gjatë javës zhvillohet mësim në 3 ditë të javës, 1 lëndë çdo ditë, në ndarjen 2 orë leksion, 1 orë seminare, 1 orë ushtrim. Dallimi midis orëve seminar dhe ushtrimit nuk është i qartë në drejtim të objektivave të tyre.</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit MP në “E drejtë private” mundëson marrjen e informacionit të nevojshëm për studentët që ndjekin këtë program studimi, që lidhet me kriteret e përgjithshme dhe ato specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit, parashikuara këto edhe në rregulloren e këtij programi si dhe në Rregullorene ekuivalentimeve. (<i>Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private dhe Evidenca 2.1. – Plani mësimor i programit MP në “E drejtë private”</i>; <i>Evidenca 2.3 – Rregullore e transferimeve dhe regjistrimeve</i>).</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikatat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi i studimit MP në “E drejtë private” përmban informacionet e nevojshme për syllabuset për secilën lëndë, për praktikatat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara nga AU. (<i>Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private; Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20; Aneks RVB – Tabelat Përmbledhëse MP në E drejtë Private</i>).</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Ky program u vihet në dispozicion studentëve, si dhe bëhet publik. Departamenti organizon edhe aktivitetin e tutoriatit/këshillimit akademik për studentët, sipas një kalendari të caktuar paraprakisht, në përputhje me rregullat e përcaktuara në aktet e brendshme të AU-së. Përditësimi i përmbajtjes së programit është një proces që ndërmerret para fillimit të vitit akademik. Po ashtu edhe syllabuset përditësohen. Në përditësimin e syllabuseve, merr rëndësi propozimi që mund të vijë nga pedagogu i lëndës si dhe mendimi studentor. Departamenti bashkëpunon me Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave për përmirësimet e programit të studimit dhe përmbajtjes së tij dhe komponentëve që e përbëjnë apo për ndryshime të mundshme dhe me grupin e vlerësimit të cilësisë në nivel departamenti për përmirësimin</p>

	e syllabuseve të lëndëve dhe materialit që vihet në dispozicion të studentit (<i>Evidenca 1.2- Rregullore e Përgjithshme e AU-së, neni 16; Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private</i>).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Programi i studimit është organizuar në leksione, seminare/ushtime dhe praktika profesionale me ngarkesën përkatëse në kredite ECTS. Ndarja në kategori (A në E) dhe ngarkesa në krediteve (në %) për veprimtaritë formuese është në pajtim me VKM 41 datë 24.1.2018 “ <i>Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë</i> ”, i ndryshuar. Në dokumentacion e vënë në dispozicion të GVJ, është paraqitur ngarkesa mësimore në orë që mbulojnë pedagogët e përfshirë në këtë program. Organizimi dhe zhvillimi i programit mësimor, shpërndarja e ngarkesës mësimore orë/ETCS ju mundëson studentëve arritjen e objektivave të programit, marrjen e rezultateve dhe fitimin e aftësive të nevojshme profesionale (<i>Vizita në AU dhe takimi me studentët e programit</i>).
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.	Ndarja në kategori e veprimtarive formuese dhe raportet e ngarkesës së tyre, bën të mundur arritjen e objektivave të programit. Njohuritë e marra në këtë program dhe kurikula e tij mundëson thellim të njohurive dhe aftësive dhe ju krijon mundësi punësimi studentëve në sektorin publik dhe privat, profesione të lira. Në këtë program studimi studenti merr njohuri të thelluara dhe aftësim profesional me qëllim orientimin e tij praktik në fushën e së drejtës private, duke iu përshtatur gjithnjë e më shumë nevojave të tregut të punës si dhe zhvillimeve të vendit (<i>Evidenca 1.5 - Rregullorja e Programit të Studimit MP në E drejtë private</i>).
Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.	Hartimi i këtij programi studimi është bërë duke marrë parasysh faktin që përmbajtja e objektivave të tij të jetë në përputhje me qëllimin e programit me kriteret dhe detyrimet për këtë program, si program i ofruar në nivelin master profesional, sipas përcaktimeve ligjore dhe akteve të brendshme rregullatore të AU-së, për arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional. (<i>Evidenca 1.5 - Rregullorja e Programit të Studimit MP në E drejtë private</i>).
Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa	Programi i studimit MP “E drejtë private” është hartuar në përputhje me strategjinë e AU-së, vizionin dhe misionin e saj, nevojat e tregut të

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

25

<p>në kredite, raporti teoripraktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>punës për juristë të specializuar në drejtime të caktuara në fushën e së drejtës, misionin e arsimit të lartë në vend dhe objektivat e procesit të Bolonjës.</p> <p>Për hartimin e tij është mbajtur parasysh gjithashtu eksperiencia e mëparshme e këtij institucioni, kuadri rregullator në fuqi, nevojat e tregut të punës, me qëllim njohjen ndërkombëtare të diplomës, për të afirmuar traditën dhe vlerat e arsimit të lartë shqiptar (<i>Evidenca 1.5 - Rregullorja e Programit të Studimit MP në E drejtë private</i>). Kjo ndarje është bere ne perputhje me VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar.</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Për hartimin e këtij programi studimi sipas kritereve/kërkesave ligjore, janë marrë për model disa programe të universiteteve të njohura europiane, me qëllim që studentët të kenë mundësi mobiliteti dhe transferimi studimesh, të konkurrojnë dhe të përshtaten denjësisht jo vetëm në kushtet e tregut vendas, por edhe atij rajonal/europian, siç përcaktohet në dokumentacionin institucional.</p> <p>(<i>Evidenca 1.5 - Rregullorja e Programit të Studimit MP në E drejtë private</i>).</p> <p>Megjithatë, sic e përmendëm edhe më lart, nuk përmendet dhe nuk evidentohet ndonjë model konkret se në cilat programe të universiteteve të njohura europiane është bazuar ky program studimi.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe nëihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Çdo lëndë e këtij programi ka syllabusin e saj. Ato përditësohen vazhdimisht mbi bazën e nevojave dhe zhvillimeve në fushën e së drejtës, mbi bazën e propozimeve të lektorit/titullarit të lëndës dhe në bashkëpunim me Grupin e Sigurimit të Cilësisë në nivel departamenti, për t’ia përcjellë më pas strukturave të tjera sipas përcaktimeve në rregulloret e brendshme. Nga të dhënat në dosje dhe vizita në institucion, rezulton se departamenti bënte përpjekje për të pasuruar literaturën që u ofronte në syllabuset e lëndëve studentëve të shkencave juridike, përfshirë edhe ata të këtij programi. Kështu rezulton se syllabuset përmbajnë literaturë që freskohet herë pas here, (<i>Evidenca 4.1 – Pasurimi i bibliotekës, prill 2019 dhe Syllabuset e lëndëve</i>).</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Në këtë program, është mbajtur parasysh që të ketë një raport të përshtatshëm mes aspektit teorik dhe atij të trajtimit të rasteve praktike, apo dhe zhvillimit të praktikave profesionale/internshipeve. Syllabuset e lëndëve përmbajnë informacionin e nevojshëm për lëndën përkatëse: emërtimi dhe kreditet e lëndës, titullari dhe/ose lektori (kur këta janë të ndryshëm) dhe asistenti nëse lënda ka të tillë, viti/semestri kur zhvillohet lënda, vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit, ngarkesa në orë në auditor si orë mësimore dhe jashtë tij, njohuritë dhe aftësitë që i jep studentit kjo lëndë, temat që do të trajtojnë lënda në formimin teorik dhe praktik, format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre, detyrimet e studentit për lëndën, format e vlerësimit të studentëve, si dhe literatura e detyruar dhe ajo e rekomanduar (<i>Shih evidencën mbi syllabuset e lëndëve të këtij programi</i>).</p>

<p>Kriteri 8. Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Në MP “E Drejtë Private” regjistrohen studentët që zotërojnë një diplomë Bachelor. Ky program studimi i ofron studentëve njohuritë e nevojshme për të përvetësuar kompetenca të avancuara/thelluara teorike dhe praktike në fushën e së drejtës private. Përmes këtij programi, ata pajisen me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale në fushën e së drejtës private, që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij, për kualifikimin e nevojshëm dhe specializimin në fushën e së drejtës private, dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Programi mundëson ndjekjen së tij nga studentë që kanë mbaruar Bachelor të çdo fushe studimi. Ndërsa është e kuptueshme nevoja për t’u qasur me tregun e punës sa më gjerë, objektivat e programit për formimin e specialistëve të fushës të së drejtë private duhet të mbahen në fokus për të përthithur të paktën studentë të fushave të afërta me drejtësinë.</p> <p>Organizimi i këtij programi është bërë mbi bazën e objektivave institucionale (<i>Evidenca 1.5 - Rregullorja e Programit të Studimit MP në E drejtë private</i>).</p>			
<p>Kriteri 9. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi i studimit MP “E drejtë private” është hartuar në përputhje me strategjinë e AU-së, vizionin dhe misionin e saj, mbi bazën e objektivave institucionale me qëllim që të mundësojë vazhdimin e studimeve apo punësimin e studentëve në përshtatje me nevojat e tregut të punës për juristë të specializuar në drejtime të caktuara në fushën e së drejtës private, ndonëse në këtë program mund të vijin edhe studentë që nuk kanë mbaruar Bachelor në drejtësi.</p> <p>GVJ sugjeron që objektivat e programit për formimin e specialistëve të fushës së të drejtë private duhet të mbahen në fokus për të përthithur të paktën studentë të fushave të afërta me drejtësinë.</p> <p>(<i>Evidenca 1.5 - Rregullorja e Programit të Studimit MP në E drejtë private</i>).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi II.5 Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi, ka kualifikimin përkatës në fushën e së drejtës private dhe vijon të jetë i angazhuar në këtë fushë në punën e tij kërkimore dhe shkencore. Kjo i shërben avancimit akademik të stafit, kualifikimit dhe trajnimit të mëtejshëm në fushë dhe transmetimit më të mirë të dijeve dhe performancë më të lartë në auditor. Disa prej anëtarëve të stafit akademik janë në proces të përfundimit të studimeve doktorale me qëllim avancimin e tyre akademik, apo në vijim të procedurës për</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>promovim për tituj akademikë. Raporti PAE/PAK ëshët i zhdrejtë, pasi ka më tepër PAK sesa PAE që mbulojnë lëndët e këtij programi studimi, një çështje kjo që duhet të adresohet sa më parë nga departamenti, e përmendur si problem edhe në standartet e mësipërme. (Shih edhe <i>Aneks RVB – Tabelat Përmbledhëse MP në E drejtë Private</i> për mbulimin e lëndëve të programit nga stafi respektiv dhe shpërndarja e ngarkesës dhe <i>takimet në AU me pedagogë më kohë të plotë dhe të pjesëshme si dhe me përgjegjësin e departamentit</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka kualifikime të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit, ku disa janë edhe me eksperiencë të gjatë në fushën e mësimdhënies, apo me tituj dhe grada shkencore, apo edhe eksperiencë në praktikë në pozicione të ndryshme dhe në sistemin e drejtësisë (<i>Evidenca 2.1. – Plani mësimor i programit MP në “E drejtë private” dhe Aneks RVB – Tabelat Përmbledhëse MP në E drejtë Private</i>).</p> <p>Stafi akademik që angazhohet në këtë program studimi ka tashmë përvojë dhe si personeli akademik me kohë të plotë ashtu edhe me kohë të pjesëshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për këtë program, për të qenë titullarë lëndësh/modulesh në përputhje me kualifikimin e tyre. Ngarkesa mësimore vjetore e pedagogut (PAE apo PAK) nuk përcaktohet/planifikohet në orë mësimore me një minimum apo maksimum, por përcaktohet në orë pune javore, në përputhje me kontratën individuale të punës. Një qasje kjo si zgjedhje e bërë nga institucioni dhe që pasqyrohet edhe në statut, rregulloret e brendshme dhe vendim të senatit akademik të AU-së. (<i>shih edhe Evidenca 4.2 – Kontrata e punës PAE dhe Evidenca 4.3.B – Kontrata e punës PAK; Evidenca 4.4 – Kontrata e Punës PA</i>).</p> <p>Ndryshe nga IAL-të publike, Udhëzimi Nr. 29, dt. 10/09/2018 të MASR “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar, për IAL-të jopublike parashikon se ngarkesa minimale përcaktohet nga vetë institucioni, ndërsa ngarkesa maksimale nuk mund të tejkalojë kohën e punës të përcaktuar në Kodin e Punës. Kështu që, nga dokumentacioni në dosje por siç u vërejt nga GVJ edhe në vizitën në institucion, rezultoi se nuk ka përcaktim për ngarkesën mësimore të shprehur në orë mësimore vjetore në auditor (norma mësimore dhe mbingarkesa). Edhe kontrata me stafin akademik përcakton kohën javore të punës, por jo ngarkesën e pedagogut si më sipër. (<i>shih edhe Evidenca 4.2 – Kontrata e punës PAE dhe Evidenca 4.3.B – Kontrata e punës PAK</i>). Kjo është reflektuar edhe në Vendimin përkatës të Senatit Akademik të AU-së, në lidhje me ngarkesën mësimore – Vendimi i Senatit Akademik të AU-së, Nr. 28/09/2018, ku përcaktohet se ngarkesa mësimore vjetore për autoritetet drejtuese, personelin akademik me kohë të plotë dhe personelin akademik me kohë të pjesëshme, të jetë në përputhje me nevojat e njësisë bazë (departamentit). Kjo ka ndikuar edhe në raportin e ngarkesës së pedagogëve në një lëndë, dhe në raportet mes komponentëve të lëndës. GVJ sugjeron që të shihet mundësia, që institucioni të ketë një përcaktim të kësaj ngarkese vjetore në orë mësimore, në mënyrë që të krijohet hapësirë për më shumë veprimtari kërkimore e shkencore nga PAE; si dhe të mund të përcaktohet një raport ndërmjet veprimtarive të ndryshme ku anagazhohet personeli akademik me kohë të plotë, (neni 59 pika 2 dhe 7, dhe neni 95 i ligjit</p>

	80/2015); si dhe orientimit të stafit në raport me veprimtarinë mësimore apo kërkimore të zhvilluar (shih edhe Udhëzimin nr.29, datë 10/09/2018 të MASR, i ndryshuar).
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që angazhohen në këtë program studimi janë në përputhje me specifikat e programit, modulet e tij. Në lidhje me personelin akademik të angazhuar në këtë program studimi, politika e departamentit dhe e AU-së në tërësi ka synuar pasjen e një stafi të qëndrueshëm dhe që i përgjigjet cilësisë së kërkuar. I gjithë stafi akademik me kohë të plotë, ka kontratë punë pa afat me institucionin, gjë që krijon edhe garanci dhe jep premisa për qëndrueshmëri të këtij stafi.</p> <p>Stafi akademik qoftë me kohë të plotë ashtu edhe ai me kohë të pjesshme i kontaktuar gjatë vizitës në institucion, u shpreh i kënaqur me trajtimin dhe motivimin nga AU si dhe me respektimin e kontratave me institucionin. Zyra e Burimeve Njerëzore në nivel institucional, mban dhe administron dosjet me të dhënat në lidhje me personelin akademik të angazhuar në mësimdhënie, kontratat, formën e punësimit (me kohë të plotë apo të pjesshme, etj).</p> <p>Ngarkesa e personelit akademik përcaktohet duke iu referuar programit të studimit MP “E drejtë private” dhe lëndëve të këtij programi, sipas fushave të ekspertizës së stafit akademik, përvojës së tyre profesionale dhe mësimdhënese si dhe titujve akademikë dhe gradave shkencore që mbajnë. <i>(Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës jepet në Aneks Rvb (tabela). Takimi me përfaqësuesn e Zyrës së Burimeve Njerëzore, AU; takimi me personelin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme).</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Sipas përcaktimeve në planin mësimor të programit të studimit MP “E drejtë private”, në bazë të krediteve që ka Praktika Profesionale (120 orë në auditor dhe 30 orë punë e pavarur e studentit) departamenti ka angazhuar pedagogë të posaçëm për pjesën e orëve të lëndës së praktikës në auditor (1 pedagogë është përgjegjës për praktikat), ndërkohë që pjesa tjetër e saj zhvillohet në institucione ku AU/departamenti ka marrëveshje bashkëpunimi. Pedagogët që aktivizohen në këtë lëndë/modul janë me gradë shkencore.</p> <p>Po ashtu edhe për udhëheqjen e diplomës. Tema e diplomës mbrohet para komisionit të ngritur për këtë qëllim. Tema e diplomës ka karakter teoriko-aplikativ dhe studenti drejtohet për këtë qëllim nga një pedagog i departamentit i cili ka dhënë miratimin e tij. Diplomimi i studentit kryhet vetëm pasi ai ka shlyer/realizuar të gjitha detyrimet e tjera të këtij program studimi <i>(Evidenca 1.5 - Rregullorja e Programit të Studimit MP në E drejtë private, Kreu V).</i></p> <p>Për të finalizuar sa më mirë punimin e diplomës, studentëve u vjen në ndihmë edhe Manuali Për Punimin e temës së Diplomës, manual ky që është hartuar nga Zyra e Karrierës, Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve, në dhjetor 2017 <i>(Evidenca 2.4 – Manuali për Punimin e temës së Diplomës).</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve</p>	<p>AU/Departamenti në këtë program studimi angazhon edhe personel ndihmës akademik dhe administrativ, që ndihmon në realizimin e veprimtarisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, dhe të zhvillimit të institucionit. Këtu përfshihet edhe personi përgjegjës për laboratorin</p>

laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	e IT-së, si infrastrukturë që përdoret edhe nga studentët e këtij programi. Veçanërisht në kushtet aktuale, kur prej një vit mësimi zhvillohet online, asistenca e specialistit të IT-së ka qenë e rëndësishme për të mundësuar/fasilituar aksesin e studentëve në platforma online (Microsoft Teams) dhe marrjen e informacionit të nevojshëm në lidhje me procesin mësimor, si: leksione/seminare, provime, pyetsor, etj. (të dhëna nga vizita e GVJ në institucion).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.6	
Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	AU i kushton rëndësi hartimit dhe rishikimit të programeve të studimit. Personeli akademik i departamentit diskuton mbi ndryshimet e mundshme në kuadër të përshtatjes së kurrikulës sipas kërkesave ligjore në fuqi apo përshtatjes sa më mirë me kërkesat e tregut e punës. Për këtë qëllim, në mbledhje departamenti diskutohet mbi ndryshimet e mundshme në programet e studimit që ofron dhe bashkëpunon për këtë qëllim me Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave, dhe angazhohet në grupet e ekspertëve në kuadër të rishikimit të kurrikulave. Me rëndësi janë në këtë drejtim edhe mendimet e profesionistëve të fushës dhe institucioneve për ta përshtatur sa më mirë këtë program me kërkesat e sotme të tregut të punës, si dhe mendimi i studentëve që merret përmes pyetsorëve apo fokus-gruoveve, etj. Megjithatë, siç është përmedur edhe më parë në këtë raport, GVJ nuk gjeti ndonjë informacion konkret mbi ndonjë analizë/raport me propozime të konsultuara me aktorë dhe partnerë konkretë të tregut të punës mbi mundësinë e përmirësimit të programit të studimit që është objekt akreditimi.
Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	Për përmirësimin e programit të studimit, AU inkurajon të përfshihen edhe studentët në këtë process. Mendimet mund të merren përmes këshillave studentorë, nga pyetsorët që plotësojnë studentët apo nga fokus-grupet. Nga takimi i GVJ-së me studentë të këtij programi, rezultoi që nuk ishin shumë të përfshirë në këto procese (sigurisht që kjo lidhet edhe me numrin e pakët të studentëve në këtë program studimi). Studentët e kontaktuar gjatë vizitës së GVJ-së në institucion, nuk kishin ndonjë koment apo sugjerim për programin e studimit, por u shprehën të kënaqur me të.
Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.	Sipas rregullores, Zyra e Karrierës dhe Alumnit është struktura përgjegjëse që mban kontakte me të diplomuarit dhe kontakton në mënyrë të herëpashershme me ta, për të gjurmuar të diplomuarit dhe përditësuar bazën e të dhënave, si dhe për të ruajtur lidhjet me universitetin (Evidenca 5.2 – Rregullore e Zyrës së Karrierës dhe Alumnit).

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

30

	Përsa i takon këtij kriteri, GVJ nuk ka evidentuar nëse alumni janë përfshirë apo kanë marrë pjesë në konsultime për dhënie të mendimeve/propozimeve për përmirësimin e këtij programi studimi.			
Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.	n/a			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Mësimdhënia në këtë program studimi bëhet sipas standardeve të vendosura nga AU, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë. Gjithashtu, AU ka hartuar dhe përdor udhëzues apo manuale të ndryshme informuese, ku përfshihen edhe informacion mbi mësimdhënien në AU. Në çdo fillim viti akademik, studentët informohen mbi institucionin dhe programin që do të ndjekin, strukturën dhe përmbajtjen e tij, të drejtat dhe detyrimet, mundësitë që ofron ky program studimi, rregullat për zhvillimin e procesit mësimor, frekuentimin dhe vlerësimin, praktikën mësimore, diplomimin, etj. Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentëve u vë në dispozicion atyre, materiale dhe broshura informuese dhe orientuese si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm për programin e studimit që do ndjekin. Po ashtu, një material i vlefshëm për studentët është edhe Manual i Studentit (<i>Evidenca 5.4 – Manuali i Studentit</i>).

<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Në objektivat e AU-së është përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe përvetësimit të dijeve përmes zhvillimit të vazhdueshëm të burimeve njerëzore dhe cilësisë. Në lidhje me mësimdhënien, objektiv mbetet adoptimi i metodologjisë moderne interaktive që inkurajon të menduarin kritik (<i>Evidenca 1.1 -Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional 2017-2022 të AU-së; Evidenca 1.3- Plani Strategjik i Departamentit të Shkencave Juridike, viti akademik 2020-2021</i>).</p> <p>NJSBC është një strukturë e ngritur në AU me qëllim vlerësimin dhe kontrollin e cilësisë si dhe ofron ekspertizë në lidhje me proceset e sigurimit të cilësisë. Po ashtu, departamenti ka ngritur edhe grupin e sigurimit të cilësisë si strukturë të tijën e përbërë nga dy pedagogje të këtij departamenti dhe një student, gjë që e bën më të lehtë bashkëpunimin dhe bashkërendimin me strukturat institucionale për garantimin e cilësisë, duke përfshirë këtu edhe monitorimin periodik të performancës së personelit akademik dhe aftësive mësimdhënëse të tij.</p> <p>Teknikat e mësimdhënies dhe përmbajtja e kurrikulës duhet të përshtatet në raport me nevojat e tregut të punës, për t'u orientuar sa më mirë profesionalisht në treg. NJSBC analizon të dhënat që dalin nga mendimet dhe feedback-u i studentëve për këtë program studimi dhe cilësinë e tij si dhe të pedagogëve që angazhohen në këtë program.</p> <p>Vlerësimi i cilësisë së veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të pedagogëve të departamentit që angazhohen në këtë program studimi, zhvillohet gjatë gjithë vitit akademik me mbështetjen e NJSBC-së, me anë të formave të ndryshme, si: pyetsorët e studentëve, fokus-grupet, vlerësimi nga përgjegjësi i departamentit si dhe vetvlerësimi nga vetë pedagogu.</p> <p><i>(Evidenca 6.4- Strategjia për Sigurimin e Cilësisë e AU-së; Evidenca 6.8 – Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-së).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Për të tërhequr mendimin e studentëve, çdo vit organizohen pyetsorët me studentët sipas një formati të adoptuar nga AU për këtë qëllim. Përveç pyetsorëve, organizohen edhe fokus-grupe me studentë për marrjen e mendimit të tyre.</p> <p>Pyetsorët organizohen në fund të çdo semestri, duke ruajtur anonimat, në mënyrë që të reflektohen rezultate sa më objektive. Format/struktura e pyetsorit të studentëve përmban tre komponentë për të cilat duhet të shprehen ata: për pedagogun, për lëndën, për stafin administrativ. Gjetjet, pasi përpunohen, analizohen me qëllim përmirësimin e cilësisë. Disa nga pikat e forta për të cilat janë shprehur studentët përmendim: korrektesa e personelit akademik, cilësia e mësimdhënies nga ana e tyre, etj. Gjithashtu, organizohen fokus-grupet me studentët nga ku merret mendimi i studentëve mbi programin e studimit në tërësi, mbi çdo lëndë të veçantë dhe çdo pedagog që angazhohet në auditor në procesin e mësimdhënies, cilësinë e mësimdhënies dhe materialit të ofruar në syllabus, literatura, etj.</p> <p>Për shkak të situatës së pandemisë në vend, AU aplikoi një pyetsor online për të marrë mendimin e studentëve mbi zhvillimin e mësimin online, rezultate këto të përfshira në broshurën mbi rezultatet e këtij pyetsori. Gjatë vizitës në AU, GVJ pati mundësi të njëjhej dhe të shihte kopje të kësaj broshure.</p>

	<p>Ankimimi është i parashikuar në aktet rregullatore të brendshme të institucionit. Studenti pasi njihet me vlerësimin në tezën e provimit si dhe me pikët në çdo rubrikë, dhe ka të drejtën e ankimit brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve</p> <p><i>(Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private, neni 23; Evidenca 5.4 - Manuali i Studentit; Evidenca 3.8 - Raporti Vjetor DSHJ 19-20; Evidenca 3.1 - Pyetsori; Evidenca 3.2 - Shkresë Fokus-grupet; Evidenca 3.4 - Formular i Drejtuesit të Departamentit; Evidenca 6.8 - Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-së).</i></p>			
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Të dhënat e përftuara nga këto vlerësime (siç u përmend te kriteret më sipër), pas përpunimit statistikor dhe cilësor, shfrytëzohen gjerësisht në mbështetje të procesit të vlerësimit të performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të vitit akademik, si dhe në lidhje me lëndët e programit që ndjekin, por edhe të personelit ndihmës akademik dhe administrativ si dhe shërbimeve që ofrohen nga institucioni dhe njësitë përbërëse të tij.</p> <p>Gjithashtu, në mënyrë periodike, NJSBC informon dekanin dhe përgjegjësin e departamentit rreth rezultateve të dala, me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësitë të tij bazë dhe stafit akademik në të ardhmen. Në përfundim të këtij procesi, NJSBC harton një raport vjetor që analizon dhe bën një vlerësim të brendshëm të institucionit ose/dhe të programit të studimit, përkundërt standardeve shtetërore të cilësisë. Ky raport i bëhet me dije Senatit Akademik, i cili pasi e merr në shqyrtim, e miraton. Pas miratimit nga Senati Akademik i AU-së, ky raport publikohet edhe në faqen web të AU-së.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Përmes këtyre mekanizmave të vlerësimit (studentë, përgjegjësi i departamentit, vetvlerësimi i pedagogut) dhe rezultateve të nxjerra dhe që përpunohen nga NJSBC-ja, shihet dhe analizohet niveli i performancës në institucion. NJSBC organizon trajnime tematike në lidhje me metodat e mësimdhënie apo në funksion të përmirësimit të cilësisë, sipas një kalendari që hartohet në fillim të vitit akademik <i>(Evidenca 3.5.a - Trajnime 2019-2020 dhe Evidenca 3.5.b - Trajnime personeli prof. të huaj).</i></p> <p>Ndonjë model promovimi nga ana e institucionit si shembuj të praktikave të mira, nuk u konstatua nga GVJ.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e</p>	<p>Mësimdhënia dhe transmetimi i dijeve përfshin mënyra/forma të ndryshme të aplikuara si: leksione, seminare, ushtrime, prezantime detyrë/projekt kursi, praktikë profesionale. Kreditet e çdo lënde mbajnë parasysht ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

33



<p>klinike, orët e hapura dhe çdo formë jetësh e miratuar nga institucioni.</p>	<p>individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Një kredit është 25 orë mësimore pune të studentit, përbërë nga orë mësimore për transmetim dijesh në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), dhe orë mësimore për përgatitje ose punë individuale të studentit) . (Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private; Evidenca 5.4 – Manuali i Studentit).</p>
	<p>Po ashtu, organizohen edhe leksione të hapura, sipas një kalendari të përcaktuar, ku ftohen studiues apo profesionistë të ndryshëm për tema të caktuara.</p> <p>Gjithashtu, si traditë e këtij institucioni është edhe organizimi i Javës së Orientimit (open days) ku me fillimin e vitit akademik, gjatë javës së parë të tij, Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët vë në dispozicion manualin orientues për studentët me të drejtat, detyrat e tyre, organizimin institucional, programin e studimit, ambientet, stafin akademik dhe ndihmës-akademik dhe administrativ përkatës, etj. (Evidenca 5.4 – Manuali i Studentit dhe Broshura informuese).</p> <p>Mësimdhënia/mësimnxënia rregullohen në mënyrë të detajuar në Statut, Rregulloren e Përgjithshme të AU-së dhe Rregulloren e Programit të Studimit MP në E drejtë Private.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Gjatë vizitës në AU, GVJ kontaktoi me disa pedagogë që angazhohen në këtë program studimi (të brendshëm dhe të jashtëm). Pedagogët vunë në dukje se në lidhje me mësimdhënien respektojnë rregullat e institucionit, mbi mënyrën e zhvillimit të orës së mësimi, vlerësimin e studentëve, literaturën dhe materialet që u ofrohen atyre, etj. Duke qenë se çdo lëndë ka specifikat e saj, dhe kështu pedagogu zgjedh forma të ndryshme të mësimdhënies, të aktivizimit të studentëve, duke kombinuar aspektin teorik me atë kazustik, etj. Në varësi të situatës dhe nisur nga fakti që në gjysmën e dytë të vitit akademik 2019- 2020 si dhe këtë vit akademik, mësimdhënia e tyre është përshtatur në kushtet e zhvillit të mësimi online.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënies, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>AU mbështet personelin akademik në aspektin didaktik dhe teknologjinë që faciliton procesin mësimor. AU në përputhje me objektivat e programit të studimit dhe speciikat e tij, mundëson përdorimin e metodave të përshtatshme të zhvillimit të mësimi në lëndë, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënies dhe objektivat formues të programit.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Stafi akademik i Departamentit të Shkencave Juridike që angazhohet në këtë program studimi, përbëhet nga personel akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, ku mes tyre ka specialistë të fushës juridike, me tituj e grada shkencore ose që kanë specializime të ndryshme, gjyqtarë/magjistratë apo edhe staf me diplomën 'Master i Shkencave'.</p> <p>Nga të dhënat e institucionit (Plani mësimor i këtij programi, tabelat si aneks RVB, CV-të e stafit akademik) por dhe nga vizita në institucion, GVJ mendon se ky staf është kompetent në lëndët/modulet që mbulon.</p>

<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendi me e sugjerimet e tyre.</p>	<p>AU e ka pjesë të strejtjes së saj përfshirjen e studentëve në procesin e përmirësimit të kurrikulës universitare dhe rritjes së cilësisë. Përmes tërheqjes së mendimit të studentëve nga përfaqësimi i tyre në organet/struktura të ndryshme të AU-së, apo nga të dhënat e mbledhura nga pyetori më studentët, fokus-grupet etj, institucioni vlerëson dhe përpiket të adresojë kërkesat dhe sugjerimet e studentëve për të riitur cilësinë e mësimdhënies.</p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimimit.</p>	<p>Zhvillimi i orës mësimore synon interaktivitetin dhe të menduarit kritik të studentit, për të bërë sa më interesante orën e mësimimit. Për specifikat e programit, rëndësi marrin ushtrimet dhe trajtimet e rasteve studimore të ndryshme, në varësi edhe të specifikave të çdo lënde në këtë program studimi. Azhurnimi me praktikën gjyqësore dhe jursiprudencën vendase apo europiane është me interes për studentët dhe nga syllabuset e shqyrtuara si dhe nga takimet me stafin akademik dhe studentët, duket se në këtë program studimi i jepet rëndësia e duhur</p> <p><i>(Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20; Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private; Minutat e vizitës në AU).</i></p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Gjatë vizitës së GVJ-së në AU, personeli akademik theksoi se në leksione/seminare përdorin metoda të ndryshme të mësimdhënies, duke kombinuar metodat tradicionale me ato bashkëkohore, në varësi edhe të natyrës dhe specifikave të lëndës, me qëllim interaktivitetin. Studentët nxiten që të japin mendimin/qëndrimin e tyre kritik për çështje të caktuara që dikutohen, raste praktike/kazuse të ndryshme, me qëllim nxitjen e arsytimit dhe të menduarit kritik. Marrëdhënia mes pedagogëve dhe studentëve respekton rregullat e komunikimit dhe etikës institucionale. Edhe nga takimet që GVJ zhvilloi me personelin akademik dhe studentët e këtij program rezultoi se këto marrëdhënie ishin të mira dhe nuk ishte vërejtur ndonjë problematikë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Për arsye të situatës, aktualisht procesi mësimor zhvillohet online dhe kështu këto salla/ambiente nuk përdoren.</p> <p>Nga vëzhgimi i ambienteve gjatë vizitës në AU, GVJ konstatoi se ato janë të përshtatshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin e procesit mësimor për studentët e këtij programi studimi dhe mirëmbahen.</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme</p>	<p>Nga vëzhgimi i ambienteve gjatë vizitës në AU, GVJ konstatoi se këto ambiente janë rikonstruktuar sipas kushteve bashkëkohore të adoptuara në klasa/salla dhe laboratore për zhvillimin e aktivitetit</p>

<p>për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.</p>	<p>mësimor dhe akademik, duke plotësuar kërkesat e secilit departament të Fakultetit të Shkencave Shoqërore, për çdo program studimi që mbulojnë.</p> <p>Sallat e leksioneve janë të pajisura me mjetet e nevojshme didaktike si: videoprojektor, ekrane projektimi etj. Kjo jep mundësi, që mënyra e realizimit të mësimdhënies të bëhet me metoda e teknologji bashkëkohore.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>AU ka pajisur zyrat e personelit akademik dhe sallat ku zhvillohet procesi mësimor me kushte të nevojshme infrastrukturore. Për zhvillimin sa më normal dhe cilësor të procesit mësimor në këtë program studimi, Departamenti i Shkencave Juridike si pjesë e Fakultetit të Shkencave Shoqërore ka në dispozicion ambiente të përshtatshme, si: salla leksioni (9) dhe seminari (11), sallë konferencash/aktivitetesh, të pajisura me mjetet e nevojshme për zhvillimin cilësor të këtij procesi (<i>Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20</i>).</p> <p>Siç u vërejt edhe nga GVJ gjatë vizitës në institucion, sallat ndaheshin në salla leksioni dhe seminari, me kushte të mira dhe kapacitet mëse të mjaftueshëm për numrin e studentëve që ndjekin aktualisht këtë program studimi. Ambientet janë komode dhe të përshtatshme për mësimdhënie.</p> <p>Të gjitha sallat mësimore janë të pajisura me mjete audio-vizive të nevojshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin normal të procesit mësimor, ku perfshihen kompjuterat personal (Pc), video projektorë, sistem fonie, sistem kondicionimi, etj. (<i>Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20 dhe Aneks RVB – Tabelat Përmbledhëse MP në E drejtë Private</i>).</p> <p>Gjithashtu, në funksion të studentëve është edhe laborator i informatikës, me kapacitet prej 30 personash. Ky laborator nëpërmjet programeve të instaluar i ndihmon studentët për esetë/detyrat në lëndët e këtij programi studimi si dhe për temat e diplomave. Ky laborator i shërben studentëve të AU-së në disa programe studimi, sipas një orari të përcaktuar dhe të ndarë për studentë të programeve të ndryshme (<i>Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20</i>).</p> <p>Në kushtet e zhvillimit të mësimin online, stafi i IT-së së universitetit ka garantuar akses të plotë të personelit akademik dhe studentëve për të zhvilluar mësimin në mënyrë online, për të aksesuar platformën Teams dhe për të fasiluar përdorimin e saj nga pedagogët dhe studentët. Kjo u vërejt edhe gjatë vizitës së GVJ në institucion, ku nga takimi me studentë dhe pedagogë të këtij programi, rezultoi se këto sisteme/platforma kanë funksionuar dhe ata u shprehën të kënaqur me mbështetjen dhe lehtësitë e dhëna nga AU.</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Syllabuset e lëndëve përmbajnë informacionin e nevojshëm në lidhje me literaturën e detyruar dhe atë të rekomanduar për lëndën (<i>Evidenca- Syllabuset e lëndësve; Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20</i>). Literatura kryesore është në gjuhën shqipe, si gjuhë e programit, por ka edhe materiale në gjuhë të huaj (anglisht).</p> <p>Pranë Fakultetit të Shkencave Shoqërore funksion biblioteka e tij, e aksesueshme edhe për studentët e këtij program studimi të ciklit të dytë. Biblioteka zotëron fondin e saj fizik me botime/tituj në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj, fond i cili pasurohet herë pas here me blerje/hyrje të reja në varësi të nevojave të evidentuara nga</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

36

	<p>departamenti (<i>Evidenca 3.7 – Lista e titujve në DSHJ; Evidenca 4.1- Pasurimi i bibliotekës në prill 2019</i>).</p> <p>Po ashtu, ofrohet mundësia edhe për akses të studentëve në biblioteka online, pa pagesë, ku kryesore për këtë program studimi është <i>Questia</i>.</p> <p>Për secilën lëndë, pedagogu i udhëzon studentët për literaturën bazë të detyrueshme dhe për literaturën e rekomanduar. Në literaturën bazë rekomandohen edhe tekste të përkthyer nga AU Press apo shtëpi të ndryshme botuese, si dhe tekste në gjuhë të huaj, që ndodhen edhe në bibliotekën e fakultetit.</p> <p>Literatura e rekomanduar është gjithashtu e parashikuar dhe e pasqyruar në syllabusin e çdo lënde, për të garantuar marrjen e dijeve të nevojshme për këtë program studimi.</p> <p>Në kushtet e mësimit online, nga vizita në AU, u informuam se pedagogët për lehtësi të studentëve, materialet e lëndës ua vënë në dispozicion përmes platformës online, gjë që lehtëson aksesin e këtyre materialeve të nevojshme për lëndën.</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Literatura e syllabuseve përgjithësisht gjendet edhe në Bibliotekën e fakultetit. Qëllimi i institucionit është që kjo literaturë të pasurohet nga viti në vit me hyrje të reja, kryesisht në gjuhën shqipe.</p> <p>Salla e bibliotekës së fakultetit, disponon një numër tavolinash dhe kënd leximi, me një hapësirë relativisht të kufizuar për të plotësuar kërkesat e studentëve (26 vende). Biblioteka e fakultetit shërben njëkohësisht edhe si sallë interneti. Ajo përmban literaturë profesionale juridike kryesisht në gjuhën shqipe dhe angleze. Interneti është në dispozicion të orëve të studimit të studentëve, por edhe të stafit akademik.</p> <p>Nga informacioni që mori GVJ nga punonjësja e bibliotekës, në bibliotekë gjenden rreth 172 tituj në fushën juridike (shih edhe <i>Evidenca 3.7 – Lista e titujve në DSHJ</i>).</p> <p>Blerjet e fundit në fushën juridike janë bërë në prill 2019, sipas nevojave të departamentit dhe kërkesave për tituj të rinj (<i>Evidenca 4.1- Pasurimi i bibliotekës në prill 2019</i>). Biblioteka ofron një numër titujsh për të mbuluar programin e studimit MP “E drejtë private”, brenda totalit të titujve në fushën juridike.</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Në funksion të mësimdhënies personeli akademik mund të aksesojnë dhe studentët aksesojnë bibliotekat on-line, ku më kryesore për fushën juridike është <i>Questia</i>. Ajo aksesohet pa pagesë nga studentët dhe stafi akademik, si në ambientet e institucionit ashtu edhe jashtë tij. (Dokumentacioni i paraqitur dhe konstatim i GVJ gjatë vizitës në institucion).</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Siç është përmendur, në funksion të studentëve është edhe laborator i informatikës, me kapacitet prej 30 personash. Ky laborator i shërben studentëve të AU-së në disa programe studimi, sipas një orari të përcaktuar dhe të ndarë për studentë të programeve të ndryshme. Kjo infrastrukturë i ndihmon studentët për përgatitjen e eseve/detyrave në lëndët e këtij programi studimi si dhe për temat e diplomave.</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning)</p>	<p>Në kushtet e zhvillimit të mësimit online, stafi i IT-së së universitetit ka garantuar aksesin për personelin akademik dhe studentët për të zhvilluar mësimin online, përmes aksesit në platformën Microsoft</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

37

dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Teams dhe për të facilituar përdorimin e saj nga pedagogët dhe studentët. Lëndët e këtij programi studimi zhvillohen tashmë vetëm online, që prej semestrit të dytë të vitit akademik 2019-2020.			
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Personeli akademik dhe studentët përdorin tashmë komunikimin elektronik dhe platformën Microsoft Teams për zhvillimin e mësimit online, që mundëson edhe komunikim më të shpejtë mes tyre. Po ashtu, studentët dhe personeli akademik dhe administrative kanë edhe adresat e tyre të e-mail me domain të universitetit (outlook), duke lehtësuar komunikimin mes tyre, duke lehtësuar komunikimin për efekt të njoftimeve të ndryshme, notave, vlerësimeve, detyrave, të kontakteve me sekretarinë mësimore (sekretaria online) etj. <i>(Aneks RVB – Tabelat Përmbledhëse MP në E drejtë Private, Tabela 17)</i> . Gjithashtu, përmes këtij sistemi dhe adresave të tyre, studentët e AU-së kanë mundësi të aksesojnë në Forumet e faqes zyrtare të internetit të AU-së. Po ashtu, përmes këtyre forumeve online, studentët mund të jepet informacion në lidhje me jetën studentore, oraret e kurseve, pedagogët, leksionet/materiale mësimore, administratën, etj. <i>(Evidenca 1.1 -Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional 2017-2022 të AU-së)</i> .			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Përzgjedhja e temave bëhet nga studentët mbi bazën e kërkesave që ata paraqesin dhe temave të propozuara nga stafi akademik i këtij programi. Tema e diplomës ka karakter teoriko-aplikativ dhe studenti drejtohet për këtë qëllim nga një pedagog i departamentit i cili ka dhënë miratimin e tij <i>(Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private)</i> . Mentorimi i studentit bëhet nga pedagogu përkatës i miratuar nga departamenti, përmes sistemit të tutorimit, duke respektuar detyrimet për një temë diplome të nivelit MP, sipas standardeve të miratuara për këtë qëllim në Manualin për përgatitjen e temës së diplomës <i>(Evidenca 2.4 – Manuali për Punimin e temës së Diplomës)</i> .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Për sigurimin e brendshëm të cilësisë është ngritur dhe vepron Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në varësi të Komisionit për Vlerësimin Institucional <i>(Evidenca 1.4 – Statuti i AU-së, neni 66 dhe Evidenca 1.2- Rregullore e Përgjithshme e AU-së neni 14)</i> , dhe në përputhje me aktet e brendshme rregullatore të AU-së. Po ashtu, AU ka adoptuar dhe zbaton edhe një Strategji për Sigurimin e Cilësisë 2018-2021. <i>(Evidenca 6.4- Strategjia për Sigurimin e</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

38

	<p><i>Cilësisë e AU-së</i>). NJSBC për çdo vlerësim që organizon, ngre Grupin e Vlerësimit të Brendshëm (GVB), ku merr pjesë edhe një student (<i>Evidenca 1.4 – Statuti i AU-së, neni 67/2; Evidenca H-Ngritja e GVB-së</i>). NJSBC gëzon autonomi të plotë në veprimtarinë e saj dhe planifikon dhe organizon vlerësimin e brendshëm të cilësisë së programeve të studimit. Për këtë qëllim ajo bashkëpunon me të gjitha autoritetet dhe strukturat përkatëse të AU-së (<i>Evidenca 6.8 – Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-së</i>). Grupet e brendshme të sigurimit të cilësisë tashmë janë shtrirë edhe në nivel departamenti (<i>Evidenca 6.3 – Sigurimi i cilësisë në nivel departamenti; Evidenca H-Ngritja e GVB-së</i>). (Për pjesën e sigurimit të cilësisë, një vlerësim më i gjerë bëhet në Standartin VI të këtij raporti).</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Juridike është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies në programin e studimit MP në “E drejtë private”. Grupi i Sigurimit të Cilësisë në nivel Departamenti harton raportin vjetor të vetëvlerësimit të programit të studimit sipas modelit të miratuar për këtë qëllim (<i>Evidenca 6.7- Model raporti vetvlerësimi i programit të studimit</i>). Ky raport, kopje e të cilit i jepet edhe departamentit, i shërben departamentit për të parë praktikën e mira dhe pikat e dobëta të cilat duhet të adresohen dhe kërkojnë ndërmarrjen e hapave konkrete me qëllim përmirësimin e cilësisë së këtij programi, të mësimdhënies dhe mësimnxënies (<i>Evidenca 6.4 - Strategjia për Sigurimin e Cilësisë e AU-së; Evidenca 6.8 – Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-së</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Strukturat drejtuese të AU-së, Fakulteti dhe Departamenti, mbështesin metodat e reja dhe inovative në mësimdhënie. Gjatë vizitës në AU, rezultoi se pedagogët e këtij programi përdornin metoda mësimdhënie sa më atraktive për studentët, ku këtu vjen në ndihmë edhe teknologjia. Ndërkohë që prej semestrit të dytë të vitit akademik 2019-2020, mësimi zhvillohet vetëm online. Kjo fillimisht ka qenë një sfidë për të gjithë, por falë mbështetjes së dhënë edhe nga specialistët e IT-së në institucion, është bërë e mundur që kjo mënyrë inovatore të jetë tashmë pjesë e mësimdhënies për të gjithë stafin akademik.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Personeli akademik bën përpjekje për të rritur nivelin e tij të kualifikimit në fushën e kërkimit shkencor. Krahas mësimdhënies, një prej dimensioneve me rëndësi është edhe kërkimi shkencor për të rritur cilësinë e mësimdhënies. Kërkimi shkencor kryesisht bazohet në këto parametra: Revista shkencore “Optime” që botohet nga universiteti; Konferencat shkencore (ku një është e përvitshme), apo dhe aktivitete ekstrakurikulare. Po ashtu, Departamenti i Shkencave Juridike bashkëpunon dhe me Zyrën e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike. Ndër të tjera, kjo zyrë duhet të bashkërendojë punën me departamentin për aplikimin dhe pjesëmarrjen në projekte kërkimore brenda dhe jashtë vendit, si dhe duhet të kontribuojë në përfshirjen e stafit akademik të departamentit në projekte institucionale apo ndër-universitare (<i>Evidenca 1.2-Rregullore e Përgjithshme e AU-së dhe Vizita në AU</i>).</p>

	<p>Nga takimi në AU me përfaqësuesen e Zyrës përgjegjëse për këtë qëllim, nuk u bë e qartë si lidhej dhe ku konsistonte mbështetja e kësaj zyre për departamentin. (<i>Minutat e Vizitës në AU</i>).</p> <p>GVJ mendon se kjo zyrë duhet të ketë një platformë më të qartë të punës së saj, në funksion të koordinimit më të mirë të kërkimit dhe projekteve shkencore me departamentin dhe mbështetjen që duhet t'i japë atij.</p>
	<p>Revista shkencore "Optime" botohet nga AU dhe synon t'i japë në rradhë të parë mundësi stafit të institucionit për të botuar, por edhe studiuesve të tjerë nga institucione të tjera. Qëllimi i kësaj reviste është nxitja e debatit shkencor si dhe publikimi/promovimi i punës shkencore të stafit akademik.</p> <p>Në lidhje me kualifikimin e stafit dhe me kërkimin shkencor institucioni mbështet stafin akademik efektiv për avancimin në kualifikimin e tyre si dhe në pjesëmarrjen në aktivitete brenda dhe jashtë vendit, por kjo nuk shoqërohet edhe me mbështetje financiare. Për më tepër, kjo ishte bërë më tepër mbi baza individuale.</p> <p>Aktualisht është bërë e mundur që përmes një marrëveshje tre vjeçare me universitetin e Salernos, të mundësohet pjesëmarrja e stafit në shkëmbim/mobilitet në kuadër të programit Erasmus+. (<i>Evidenca R.3 – Marrëveshja UNISA-AU-2019-2021; Evidenca 3.10 – Marrëveshja UNISA-AU: 2019-2021</i>).</p> <p>Nga të dhënat për stafin akademik të departamentit, përgjegjësi i departamentit është ai që ka qenë i angazhuar në këtë program mobiliteti për mbajtjen e një leksioni (mësimdhënie) në Universitetin e Salernos, në mars 2020 (<i>Evidenca R.1 – Ftesa ndaj stafit akademik dhe Evidenca R.2 – Ismail Tafani Erasmus+ Mobility</i>).</p> <p>GVJ mendon se pjesëmarrje dhe bashkëpunime të tilla duhet të vijojnë dhe të rriten, me mbështetje më të madhe edhe nga AU, në funksion të kualifikimit të vazhdueshëm të stafit të departamentit të angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Institucioni organizon trajnime të herëpashershme në bashkëpunim me departamentin dhe strukturat e tjera të AU-së, përmes trajnimeve të ndryshme tematike, tryezave të rrumbullakta, leksioneve të hapura etj. me qëllim përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja nga ana e stafit akademik të departamentit. si psh. Përdorimi i Google Classroom për mësimin online, shkëmbim experience mbi organizimin e orës së mësimin, etj. (<i>Evidenca 3.5.a – Trajnime 2019-2020 dhe Evidenca 3.5.b – Trajnime personeli prof. të huaj</i>).</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Personeli akademik në këtë program studimi është përgjegjës për zbatimin e tij dhe cilësinë e mësimdhënies. Ky është një detyrim primar i cili rrjedh nga marrëdhëniet e punës që ka stafi akademik me AU, e përcaktuara kjo edhe në kontratën e punës. Kjo vlen edhe për përgjegjësitë që ka personeli ndihmës akademik i këtij programi.</p> <p>Pedagogu është përgjegjës për përgatitjen, azhornimin e syllabuseve dhe zbatimin e të gjithë komponentëve të parashikuar në të, si pjesë e detyrimeve të tij akademike, metodologjinë e mësimdhënies dhe përditësimin e literaturës, etj. (<i>shih edhe Evidenca 4.2 – Kontrata e</i></p>

	<i>punës PAE dhe Evidenca 4.3.B – Kontrata e punës PAK; Evidenca 4.4 – Kontrata e Punës PA).</i>			
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Personeli akademik bën përpjekje të aplikojë metoda bashkëkohore në mësimdhënie, duke përdorur teknologjinë e informacionit që mundësohet edhe nga institucioni. Kjo lehtëson mësimdhënien në lëndë të caktuara dhe sipas specifikave të temave, e bën mësimin më interaktiv dhe më interesant për studentët. Këto elementë të mësimdhënies bëhen pjesë e analizës periodike të departamentit, si dhe pjesë e informacioneve që përgatit dhe raporton njësia (departamenti) apo edhe pjesë e raporteve institucionale (<i>Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20</i>).			
Kriteri 8. Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.	Siç u përmend edhe më parë, AU në kuadër të bashkëpunimeve me partnerë të ndryshëm vendas apo të huaj, angazhon në këtë program studimi edhe lektorë të ftuar, vendas apo të huaj, me qëllim rritjen e shkëmbimit, forcimin e bashkëpunimit me partnerë të ndryshëm, në funksion të përmirësimit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>Kontrolli i dijeve shërben për vlerësimin e progresit të studentit dhe mat përvetësimin e objektivave e të kompetencave profesionale të programit MP nga studenti.</p> <p>Kontrolli i dijeve dhe vlerësimi është dinamik dhe përbëhet nga disa komponentë. Kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet testeve me shkrim e me gojë, detyrave të kursit, prezantimeve, praktikave mësimore dhe gjyqeve simuluese si dhe tezës së diplomës që paraqitet për mbrojtje në përfundim të mbylljes së të gjitha detyrimeve akademike për programin e studimit MP “E drejtë private”. Rregullorja e programit të studimit MP në “E drejtë private” përcakton kriteret dhe mënyrat e kontrollit të dijeve/vlerësimit në lëndë. (<i>Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private</i>). Po ashtu në ndihmë studentëve u vjen edhe Manuali i Studentit që përmban informacion edhe për këtë çështje (<i>Evidenca 5.4 – Manuali i Studentit</i>).</p> <p>Njohuritë e përfituara nga studenti kontrollohen dhe vlerësohen me pikë përmes një kombinimi të frekuentimit dhe aktivizimit të studentit gjatë orëve të mësimit në auditor, provimeve me shkrim, eseve/detyrave të kursit, që zhvillohen sipas afateve të caktuara në kalendarin akademik, të bëra publike nga Departamenti përkatës dhe që janë të detyrueshme për zbatim si nga pedagogët ashtu dhe nga studentët (<i>Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private, neni 24</i>).</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

41

	Për përgatitjen e diplomës si detyrim përmbyllës në këtë cikël studimi, institucioni ka përgatitur edhe një Manual për punimin e temës së diplomës (<i>Evidenca 2.4 – Manuali për Punimin e temës së Diplomës</i>).			
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në fillim të semestrit, studentëve iu vihen në dispozicion syllabuset për çdo lëndë që ndjekin. Çdo pedagog në fillim të lëndës pedagogu i njeh studentët me përmbajtjen e syllabusit, me informacionin e nevojshëm që përmban syllabusi: emërtimi dhe kreditet e lëndës, pedagogun/pedagogët e lëndës, viti/semestri kur zhvillohet lënda, vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit, ngarkesa në orë në auditor si orë mësimore dhe jashtë tij, njohuritë dhe aftësitë që i jep studentit kjo lëndë, temat që do të trajtojnë lënda në formimin teorik dhe praktik, format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre, detyrimet e studentit për lëndën, format e vlerësimit të studentëve, si dhe literatura e detyruar dhe ajo e rekomanduar. Informacioni që marrin studentët nga broshurat informative, Java e orientimit, kontakti me pedagogët e departamentit gjatë zhvillimit të lëndëve, syllabuset që u jepën studentëve për çdo lëndë, si dhe Rregullorja e programit që ata ndjekin parashikon informacionin e duhur për vlerësimin në lëndë dhe format e kontrollit të dijeve (<i>Evidenca 1.5 - Rregullore MP në 'E drejtë private' dhe Syllabuset e lëndëve; Evidenca 5.4 – Manuali i Studentit; Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20</i>).			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Kontrolli i dijeve dhe vlerësimi është dinamik dhe përbëhet nga disa komponentë: testime me shkrim e me gojë, detyra kursi, prezantimeve, praktikave profesionale dhe gjyqeve imituese si dhe tezës së diplomës që paraqitet për mbrojtje në përfundim të mbylljes së të gjitha detyrimeve akademike për programin e studimit MP “E drejtë private” (<i>Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private</i>) Në AU vlen parimi i kontrollit të vazhdueshëm të njohurive, sipas të cilit studenti vlerësohet sipas këtyre komponentëve: frekuentimi i lëndës dhe pjesëmarrja aktive vlerësohet me 10% të vlerës së pikëve totale dhe 10 % detyra e kursit, testi i pjesshëm ka 20% të vlerës së pikëve totale dhe provimi përfundimtar ka vlerën 60% të vlerës së pikëve totale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Siç u përmend më sipër, testimi dhe vlerësimi në lëndë, është i vazhduar dhe përbëhet nga disa komponentë, e realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke dhënë në fund rezultatin/notën përfundimtare. Shkalla e përvetësimit të dijeve/vlerësimi bëhet me sistemin e pikëve nga 0-100 pikë (në përqindje nga 0-100%) dhe rezultati përfundimtar konvertohet në notë nga 4 (katër) në 10 (dhjetë) si dhe shprehet me shkronja nga F në A. Notat nga 5 (pesë) në 10 (dhjetë) dhe gërmat nga

	E në A janë kaluese (<i>Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private, neni 24</i>).
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Sipas të dhënave institucionale por dhe nga vizita në institucion, rezultojnë se vlerësimi i provimeve bëhet i sekretuar (bar code) për të garantuar objektivitetin në vlerësim dhe për të rritur transparencën. Në kushtet e mësimit online, AU ka implementuar testimin përmes platformës elektronike Exam.net.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Titullari i lëndës është përgjegjës për vlerësimin dhe notën përfundimtare të studentët. Kur lënda ka edhe asistent, vlerësimi bëhet nga të dy pedagogët që angazhohen në lëndë (<i>Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private dhe Takimet me stafin akademik gjatë vizitës së GVJ në institucion</i>).
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Përsa i përket kontrollit të njohurive, sipas parashikimeve në rregulloret e brendshme, provimet zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korigjuara në Sekretarinë Mësimore (<i>Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private</i>). Në kushtet aktuale, është aplikuar testimi online, që ka avantazh pasi garanton transparencë dhe lehtësi në vlerësim.
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Vlerësimi i njohurive mund të shoqërohet nga pedagogu përkatës me komente nëse shihet e nevojshme, për të sqaruar studentin si dhe për ta ndihmuar të përmirësohet në të ardhmen. Kjo doli edhe nga kontakti me pedagogët gjatë vizitës në AU. Në takimin me ta, u përmend se pedagogu bën konsultime pas provimit, për t'i njohur konkretisht me vlerësimin. Po ashtu, kur kanë pasur ndonjë rast ankese, kanë bërë rishikim të vlerësimit dhe nëse ka qenë rasti edhe ka ndryshuar ky vlerësim. Ndërsa ngritje komisioni ankimimi, deri tani nuk ka pasur, sipas pedagogëve të pranishëm gjatë vizitës në AU. Gjithashtu edhe Rregullorja bën përcaktimin në lidhje me korigjimin e tezave të provimeve, vlerësimin dhe rivlerësimin e tyre. (<i>Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private; Minutat e Vizitës dhe takimet e zhvilluara në AU</i>).
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Rregulloret institucionale dhe rregullorja e programit të studimit parashikon rregulla për zhvillimin e provimeve, ndalimin e kopjimit dhe të plagjiaturës. Gjithashtu edhe Manuali i Studentit tek pjesa mbi Standartet etike të sjelljes së studentëve parashikon ndër të tjera detyrimin e tyre për të respektuar etikën gjatë procesit mësimor, të mos bëjnë tentativë për mashtrim apo cënim të rregullave të procesit akademik, të mos paraqesin punime apo projekte si të tyre kur kanë dijeni se janë të dikujt tjetër etj. (<i>Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private; Evidenca 5.4 – Manuali i Studentit</i>).
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Vlerësimi i dijeve dhe njohurive të fituara nga studentët e këtij programi bëhet në përputhje me përcaktimet në Rregulloren e programit të studimit. Pedagogu vlerëson me pikë çdo komponent të tezës së provimit. Tezat janë të sekretuara me bar code, kështu që japin garanci për objektivitetin në vlerësim. Pedagogët kanë një afat 7 ditor në dispozicion për të vlerësuar provimet e studentëve. Më pas ato dorëzohen në sekretari, ku edhe hapen/ç'kodohen. Rezultatet e provimeve u bëhen me dije studentëve nga sekretaria mësimore e programit, ose mund të merren përmes aksesit në sekretarinë online.

	<p>Për më tepër, kalimi në platformën online si për zhvillimin e e mësimit (M. Teams) ashtu edhe të provimeve (exam.net), krijon më tepër garanci për meritë dhe transparencë në vlerësimin e njohurive dhe dijeve të studentëve të marra në lëndë. (Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private; Minutat e Vizitës dhe takimet e zhvilluara në AU).</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Pas shpalljes së rezultateve studenti ka të drejtë të kërkojë sqarim për vlerësimin e bërë, kur nuk është dakord me të. Ai ka të drejtë të njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë si dhe me pikët në çdo rubrikë. Ai ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve, në sekretarinë mësimore të programit të studimit (Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private, neni 23).</p>			
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Pas ankimit që depozitohet në sekretari si më sipër, Dekani cakton një komision të posaçëm për shqyrtimin e kësaj ankese, ku marrin pjesë edhe pedagogu/pedagogët vlerësues të tezës së provimit. Ky komision duhet të shprehet brenda 1 jave nga depozitimi i ankimit dhe i bëhet me dije studentit përmes sekretarisë mësimore. Vendimi i komisionit i bashkangjitet procesverbalit/fletës së provimit (Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private, neni 23).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.7 Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Ky program studimi synon që studentit të marrë njohuri të thelluara dhe aftësim profesional me qëllim orientimin e tij praktik në fushën e së drejtës private, që të jenë konkurrentë të denjë në tregun e punës. Ky program synon arsimimin dhe formimin e specialistëve në fushën e së drejtës private si dhe synon të krijojë tek ta aftësi interpretuese, analitike dhe zbatuese të përfuara gjatë periudhës së studimit në këtë program, me impakt në sferën profesionale. (Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private dhe Evidenca 1.1.a - Analizë për tregun e punës, MP në E drejtë private 2020-2021).</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Programi i studimit MP në "E drejtë private" është pjesë e programeve të ciklit të dytë të studimeve që ofron Departamenti i Shkencave Juridike, dhe synon të zhvillojë aftësi në fushën juridike (humanitetet). Ky program ofrohet në gjuhën shqipe. Kurrikula e programit të studimit përmban module dhe lëndë nëpërmjet të cilave studenti thellon njohuritë dhe zhvillon aftësitë profesionale e të veçanta në fushën e së drejtës private. (Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private dhe Evidenca 2.1. - Plani mësimor i programit MP në "E drejtë private").</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e</p>	<p>Në syllabuset e çdo lënde studentët kanë informacion në lidhje me kompetencat dhe aftësitë, rezultatet e të nxënit, që marrin në lëndë.</p>

<p>çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti në lëndë mund të evidentohen përmes vlerësimit të studentit, në gjithë treguesit që ka ky vlerësim. Metoda e vlerësimit është ajo e vazhdueshme, gjatë gjithë semestrit ku zhvillohet lënda, nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me gojë dhe/apo shkrim.</p> <p>Vlerësimi final i referohet disa elementëve: vlerësimit përfundimtar, provimit të ndërmjetëm dhe përfundimtar, aktivizimit gjatë seminareve dhe ushtrimeve, si dhe detyrave të kursit, me pikëzimin e mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Provimi përfundimtar 60 pikë - Provimi i ndërmjetëm 20 pikë - Pjesëmarrja aktive në seminare 10 pikë - Ese/prezantim/pune në grup 10 pikë <p>(Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private dhe Syllabuset e lëndëve).</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Në përfundim të lëndës, pedagogu mund të bëjë edhe një përmbledhje për efekt orientimi dhe përsëritje të koncepteve/çështjeve kryesore të trajtuara, si dhe të orientojë studentët për provimin përfundimtar të lëndës. Gjatë vizitës në AU, në takimet e zhvilluara me studentët dhe stafin akademik të programit rezultoi se në disa raste pedagogët e ndjekin një praktikë të tillë.</p> <p>(Minutat e Vizitës dhe takimet e zhvilluara me stafin akademik dhe studentët në AU).</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Si pjesë e veprimtarive ekstrakurikulare janë edhe orët/leksionet e hapura, me lektorë të ftuar, të cilat janë organizuar herë pas here në AU. Ndër to përmendim trajnime/aktivitete të dedikuara për stafin si p.sh. trajnimi mbi përdorimin e Google Clasroom në kushtet e mësimit online. (Evidenca 3.5.a – Trajnime 2019-2020; Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20).</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Mësimdhënia në këtë program studimi, kombinon formimin teorik me përvojën praktike dhe realizohet në bashkëpunim me institucione të ndryshme pranë të cilave mund të zhvillohen edhe praktika profesionale. Praktika zhvillohet në një nga institucionet me të cilat AU/departamenti ka marrëveshje bashkëpunimi dhe koordinohet e mbikqyret nga një pedagog i departamentit (Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private, neni 27 dhe Evidenca 1.1.a - Analizë për tregun e punës, MP në E drejtë private 2020-2021).</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Përmes metodave të mësimdhënies bëhet e mundur edhe punë në grup e studentëve. P.sh. detyrat e kursit, diskutim rasti, simulim i një situatë, etj. Këto janë forma që personeli akademik i përdor për të angazhuar studentët në një debat interaktiv dhe për të rritur frymën e bashkëpunimit mes tyre (Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20; Minutat e Vizitës në AU).</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>Nga vizita dhe takimet në AU, GVJ konstatoi se stafi akademik mbështet studentët për të promovuar idetë dhe mendimin e tyre, për të marrë pjesë në aktivitete ekstrakurikulare apo në programe mobiliteti, në konferenca apo seminare studentore. Për këtë qëllim, stafi i departamentit mbështet dhe asiston studentët në përgatitjen e tyre për Konferencën Studentore që organizohet çdo vit.</p> <p>(Minutat e Vizitës dhe takimet e zhvilluara me stafin akademik dhe studentët në AU).</p>

<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>AU organizon edhe aktivitete ekstrakurikulare për stafin dhe studentët, dhe çdo vit organizon Konferencën Studentore ku studentët marrin pjesë më punimet e tyre. Ky është një aktivitet i përbashkët që organizohet nga Departamenti i Shkencave Juridike dhe ai i Shkencave Politike, që synon të kthehet në një forum për promovimin e studentëve dhe aftësive të tyre. Për këtë qëllim, stafi i departamentit mbështet dhe asiston studentët në përgatitjen e tyre për këtë konferencë, si dhe mbështeten financiarisht për këtë aktivitet. (Vizita dhe takimet e zhvilluara në AU; Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20.)</p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>AU ka bërë përpjekje për të rritur bashkëpunimin me institucione të tjera në arsimin e lartë brenda dhe jashtë vendit si dhe me aktorë të tjerë të sektorit publik, shoqërisë civile, sektorit privat, organizata profesionale, me qëllim krijimin e hapësirave dhe mundësive të ndryshme për studentët si edhe stafin akademik. Po ashtu, AU ka lidhur së fundmi edhe një marrëveshje të re bashkëpunimi me Universitetin e Salernos në Itali, që i shtohet marrëveshjeve të mëparshme që ka pasur. Falë kësaj marrëveshje tre vjeçarë, Departamenti i Shkencave Juridike do të rrisë mundësinë për shkëmbime dhe mobilitet të stafit akademik dhe studentëve të tij. Nga dokumentacioni në dosje dhe vizita në AU, konstatohet se në semestrin e dytë të vitit akademik 2019-2020, 4 studentë të këtij departamenti kanë zhvilluar semestrin e dytë në Universitetin e Salernos, si pjesë e programit të mobilitetit studentor Erasmus +. (Aneks RVB – Tabelat Përmbledhëse MP në E drejtë Private, Tabela 5; Evidenca 1.6 – Marrëveshje bashkëpunimi të Departamentit të Shkencave Juridike; Evidenca R.3 – Marrëveshja UNISA-AU-2019-2021; Evidenca 3.10 – Marrëveshja UNISA-AU: 2019-2021; (Minutat e Vizitës dhe takimet e zhvilluara në AU).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>



<p>Standardi III.8 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfuturimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>Pjesë e detyrueshme e veprimtarisë formuese të programit dhe kusht i domosdoshëm për të përfunduar studimet, është dhe praktika mësimore. Praktika zhvillohet në bashkëpunim me institucione dhe organizata partnere me të cilat Departamenti ka marrëveshje bashkëpunimi për këtë qëllim, p.sh. gjykata, prokurori, studio ligjore/zyrë avokatie, Ministria e Drejtësisë, Gjykata Kushtetuese, Shërbimi i Provës, Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësimit, OJF të ndryshme (Evidenca 1.3 - Plani Strategjik i Departamentit të Shkencave Juridike, viti akademik 2020-2021 dhe Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20; Evidenca 1.6 – Marrëveshje bashkëpunimi të Departamentit të Shkencave Juridike; Minutat e vizitës së GVJ në AU).</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

46

	Praktika përfshin orë në auditor (2 orë/javë) dhe orët praktike në institucion, nën mbikëqyrjen e një pedagogu të caktuar nga përgjegjësi i departamentit për këtë qëllim. Në përfundim të praktikës studenti duhet të paraqesë dosjen përkatëse. Praktika ka edhe syllabusin e saj dhe pedagogun përgjegjës për këtë lëndë (<i>Evidenca - Syllabuset e programit të studimit</i>).			
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Eksperiencë e mirë është organizimi në fund të praktikës i seancave/gjyqit simulues, për të parë dhe vlerësuar në mënyrë simuluese aftësitë teorike të fituara, nivelin e analizës dhe mendimit kritik nga ana e studentëve. (<i>Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20</i>).			
Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Vlerësimi i studentit për praktikën mësimore bëhet me notë dhe kur vlerësohet me notë kaluese studenti merr kreditet përkatëse. Studenti i cili nuk shlyen praktikën mësimore nuk ka të drejtë të mbrojë diplomën (<i>Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private</i>).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.9	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Ky program studimi mbyllet me mbrojtjen e diplomës para komisionit të posaçëm që ngrihet nga departamenti për këtë qëllim. Komisioni ngrihet nga departamenti dhe miratohet nga dekani. Në përbërje të tij janë 3-5 pedagogë. Për përgatitjen e diplomës si detyrim përmbyllës në këtë cikël studimi, institucioni ka përgatitur edhe një manual për punimin e diplomës (<i>Evidenca 2.4 – Manuali për Punimin e temës së Diplomës</i>). Diplomimi i studentit kryhet vetëm pasi ai ka shlyer/realizuar të gjitha detyrimet e tjera të këtij program studimi (<i>Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private, Kreu V</i>).
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Departamenti ka vënë në dispozicion të studentëve Manuali për hartimin e punimit të diplomës (<i>Evidenca 2.4 – Manuali për Punimin e temës së Diplomës</i>) dhe zhvillon orë të hapura për t'i orientuar studentët në lidhje me rregullat, udhëzimet për realizimin e punimit të diplomës. Në funksion të udhëheqjes së temave të studentëve, pedagogët udhëheqës zhvillojnë seanca metodologjike, sipas një kalendari takimesh, të shpallur për të asistuar studentët, me udhëzimet e nevojshme për përgatitjen e temës së diplomës. (<i>Evidenca 1.5 -</i>

47

	<i>Rregullore MP në 'E drejtë private' dhe Evidenca 2.4 – Manuali për Punimin e temës së Diplomës; Evidenca 5.4 – Manuali i Studentit).</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	n/a
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.	Udhëheqësit e temave të diplomës janë personel akademik efektiv por edhe me kontratë, të profilizuar në fusha të caktuara të së drejtës private. Përzgjedhja e temave bëhet nga studentët mbi bazën e kërkesave që ata paraqesin dhe temave të propozuara nga stafi akademik i këtij programi. Tema e diplomës ka karakter teoriko aplikativ dhe studenti drejtohet për këtë qëllim nga një pedagog i departamentit i cili ka dhënë miratimin e tij (<i>Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private, kreu V dhe Evidenca 2.4 – Manuali për Punimin e temës së Diplomës</i>). Mentorimi i studentit bëhet nga pedagogu përkatës i miratuar nga departamenti, përmes sistemit të tutorimit, duke respektuar detyrimet për një temë diplome të nivelit MP, sipas standardeve të miratuara për këtë qëllim në manualin për përgatitjen e temës së diplomës (<i>Evidenca 2.4 – Manuali për Punimin e temës së Diplomës</i>).
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Për përgatitjen e temës së diplomës, ambientet e institucionit, si p.sh. laboratorit i informatikës, mund të përdoren si nga studentët ashtu edhe nga stafi i departamentit të shkencave juridike për realizimin e detyrimeve akademike ose kërkimore, apo për hedhjen e të dhënave tabelare, grafike dhe të analizës statistikore që mund t'i duhet një studentit për të përgatitur temën e tij të diplomës.
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Udhëheqësit e temave të diplomës mentorojnë studentin gjatë periudhës për përgatitjen e e saj. Udhëheqësi orienton studentin në lidhje me përgatitjen e temës, në përmbushje të standardeve të miratuara për këtë qëllim në Manualin për përgatitjen e temës së diplomës (<i>Evidenca 2.4 – Manuali për Punimin e temës së Diplomës</i>). Në përfundim të saj, udhëheqësi duhet të japë dakordësinë e tij për temën dhe firmos temën e diplomës që studentin do mbrojë para komisionit në departament. Gjithashtu ai bën vlerësimin e tij sipas formatit të miratuar për këtë qëllim që paraqitet para komisionit të diplomës (<i>Evidenca 3.11 – Format udhëheqje</i>).
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentin vlerësohet me notë.	Departamenti ka të miratuar edhe formatet që duhet plotësojë udhëheqësi dhe oponenti kur studentin mbron temën e diplomës (<i>Evidenca 3.11 – Format udhëheqje dhe Evidenca 3.12 – Format oponence</i>). Mbrojtja e diplomës bëhet para komisionit të posaçëm të ngritur nga departamenti dhe vlerësohet me notë. Nota 5-10 është kaluese. (<i>Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private</i>).
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studentin pajiset me diplomën dhe	Në përfundim të këtij program studimeve, pasi student ka shlyer të gjitha detyrimet akademike, ai pajiset me diplomën dhe suplementin e saj, të miratuara nga MASR. AU në dokumentacionin e paraqitur,

suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	ka sjellë dhe modelin e diplomës që lëshohet për këtë program studimi si dhe suplementin e saj.			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të programit të studimeve MP në “E drejtë private”, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, me kërkesën e tij. Në fund të këtij program dhe pas diplomimit, studenti pajiset me diplomën përkatëse të nivelit të dytë shoqëruar me suplementin e saj. (<i>Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private, neni 28 dhe Evidenca 3.13.a – Diplomë Master Profesional dhe Evidenca 3.13.b – Suplementi i Diplomës MP në E drejtë Private</i>).			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.	AU ruan kopjet e dorëzuara të diplomave që studentët mbrojnë para komisionit në department. Periudha e ruajtjes është e pacaktuar në rregulloren e programit të studimit. Në përmbushje të detyrimeve institucionale, informacioni mbi studentët paraqitet rast pas rasti, paraqitet për palët e interesuara apo institucionet përkatëse në përputhje me parashikimet ligjore dhe përcaktimet në aktet e brendshme rregullatore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të	Të dhënat për rekrutimin e stafit akademik (PAE dhe PAK) apo edhe të personelit ndihmës akademik dhe administrativ mbahen dhe administrohen pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore të AU-së (<i>Evidenca 1.4 – Statuti i AU-së dhe Evidenca 1.2- Rregullore e Përgjithshme e AU-së</i>). Gjithashtu edhe Departamenti mban të dhënat e tij në lidhje me stafin akademik të rekrutuar dhe angazhimin e tij në procesin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, sipas planit mësimor të këtij programi studimi MP, ndarjen e ngarkesës sipas pedagogëve që angazhohen në çdo semestër dhe vit akademik, si edhe të personelit ndihmës-akademik dhe administrativ. (<i>Aneks RVB – Tabelat Përmbledhëse MP në E drejtë Private</i>).

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al



Web site: www.ascal.al

49

<p>personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Të dhënat lidhur me anëtarët e personelit akademik ruhen dhe azhurnohen çdo vit në Zyrën e Burimeve Njerëzore (<i>Vizita e GVJ-së në AU, takimi me përfaqësuesen e Zyrës së Burimeve Njerëzore</i>). GVJ pa nga afër disa dosje të personelit akademik, kontratat e punës të stafit akademik efektiv dhe me kontratë të firmosura nga palët, bashkë me aneks kontratën ku përcaktohen lëndët dhe orët që duhet të zhvillojë një pedagog.</p>
	<p>Institucioni mban dhe administron informacionin e përvitshëm lidhur me stafin akademik që angazhohet çdo semestër në këtë program studimi, me lëndën/lëndët përkatëse që mbulon dhe ngarkesën e planifikuar dhe të realizuar. Po ashtu të dhënat mbahen edhe për personelin ndihmës akademik me karakter mësimor dhe administrativ dhe detyrat që realizon. (<i>shih edhe Evidenca 4.2 – Kontrata e punës PAE dhe Evidenca 4.3.B – Kontrata e punës PAK; Evidenca 4.4 – Kontrata e Punës PA</i>).</p> <p>Sipas nevojave të departamentit, zyra e burimeve njerëzore në bashkëpunim me rektoratin, publikon vendet vakante dhe kriteret e punësimit për çdo pozicion vakant në faqen e internetit: http://albanianuniversity.edu.al</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Procedura e rekrutimit për personel të ri akademik bëhet mbi bazën e nevojave që paraqiten nga çdo njësi bazë (departament) e fakultetit, në fillim të vitit akademik. Dekani i fakultetit ia përcjell këto kërkesa Rektoratit, për të vijuar më tej me procedurat e konkurrimit. Shpallja për vende vakante bëhet publike, ku thirrja pasqyrohet dhe në faqen web të universitetit.</p> <p>Kriteret shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurs. Për vlerësimin e kandidaturave ngrihet një komision i posaçëm, i cili pasi shqyrton dosjen e kandidatëve të paraqitur, zhvillon edhe intervistën më gojë. Kandidati fitues firmos kontratën e punës me rektorin e AU-së. (<i>Evidenca 1.2 - Rregullore e Përgjithshme e AU-së, neni 30</i>).</p>
<p>Kriteri 3 Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Në aktet e brendshme rregullatore, përcaktohet se procedura e rekrutimit për personel të ri akademik bëhet mbi bazën e nevojave që paraqiten nga çdo njësi bazë (departament) e fakultetit, në fillim të vitit akademik. Dekani i fakultetit ia përcjell këto kërkesa Rektoratit, për të vijuar më tej me procedurat e konkurrimit. Shpallja për vende vakante bëhet publike. Kriteret shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurs. Për vlerësimin e kandidaturave ngrihet një komision i posaçëm, i cili pasi shqyrton dosjen e kandidatëve të paraqitur, zhvillon edhe intervistën më gojë. Kandidati fitues firmos kontratën e punës me rektorin e AU-së. (<i>Evidenca 1.2 - Rregullore e Përgjithshme e AU-së, neni 30; Evidenca 4.2 – Kontrata e Punës PAE</i>).</p> <p>GVJ thekson se në këto nevoja që evidentohen nga departamenti, duhet patjetër të merret parasysh domosdoshmëria për plotësimin e personelit akademik me kohë të plotë me kompetenca dhe formim akademik, që t'i përgjigjet detyrimit ligjor për mbulimin e ngarkesës mësimore të këtij programi në masën të paktën 70%. Ky është një detyrim ligjor dhe përgjegjësi e departamentit, që duhet respektuar.</p>


<p>Kriteri 4 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Në aktet e brendshme rregullatore, përcaktohet se rekrutimi i personelit të ri akademik dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me nevojat e departamentit, përmes publikimit në fillim të çdo viti akademik, të vendeve vakante në departament dhe kërkesave/kritereve të përgjithshme dhe specifike për plotësimin e tyre. Kjo shpallje bëhet nga Zyra e Burimeve Njerëzore në faqen web të institucionit. Sërisht GVJ (ashtu si edhe në kriterin 3 më lart), thekson se në këto nevoja që evidentohen nga departamenti dhe për pasojë kriteret e shpallura për vende vakante, duhet patjetër të merret parasysh domosdoshmëria për plotësimin e personelit akademik me kohë të plotë me kompetenca dhe formim akademik, që t'i përgjigjet detyrimit ligjor për mbulimin e ngarkesës mësimore të këtij programi në masën të paktën 70%.</p> <p>Konkurrimi është i hapur dhe transparent, dhe bëhet sipas një procedurë (me dosje dhe me interviste me gojë) që përcaktohet qartë në statut dhe në rregulloret e brendshme të miratuara. Krahas stafit të ri, Departamenti ka bërë përpjekje për të zhvilluar dhe përmirësuar cilësinë e mësimdhënies, duke angazhuar staf akademik të kualifikuar dhe me eksperiencë në raport me programin e ofruar, për përmbushjen e misionit dhe qëllimit të programit. Gjithsesi, duhet theksuar se departamenti nuk ka përmbushur detyrimin ligjor që përmes rekrutimit të evidentojë mungesën e mbulimit të lëndëve të këtij programi studimi me personel akademik me kohë të plotë në masën min 70%.</p> <p>Në këtë program studimi, departamenti ka bërë përpjekje që në përzgjedhjen e stafit akademik me kontratë të marrë parasysh eksperiencën dhe kualifikimet që ata kanë në lidhje me programin e studimit Master Profesional në “E drejtë private”. Kështu në këtë program studimi janë përfshirë si staf akademik me kontratë: gjyqtarë, punonjës në Administratën Publike, pedagogë nga universitete të tjera të vendit, etj.</p> <p>Por sic është theksuar edhe më sipër, problem mbetet fakti që në përzgjedhje/rekrutimin dhe angazhim të stafit akademik, nuk respektohet raporti PAE/PAK në masën 70%/30% për mbulimin e ngarkesës së lëndëve të këtij programi. Kjo duhet riparë dhe patjetër të adresohet si detyrim ligjor, në përputhje me strukturën dhe përmbajtjen e programit.</p> <p>Ashtu si edhe më sipër, GVJ thekson se në politikën e tij të rekrutimit dhe nevojat për rekrutim, departamenti duhet të marrë parasysh nevojën për plotësimin e personelit akademik me kohë të plotë me kompetenca dhe formim akademik, që t'i përgjigjet detyrimit ligjor për mbulimin e ngarkesës mësimore të këtij programi në masën të paktën 70%. Ky është një detyrim ligjor dhe përgjegjësi e departamentit, që duhet adresuar sa më parë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>AU shtrihet në 4 godina në Tiranë, dhe kështu garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e aktivitetit akademik si dhe praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programit të studimit MP në “E drejtë private”, si edhe të detyrave të personelit në mënyrë të përshtatshme. Departamenti i Shkencave Juridike e zhvillon veprimtarinë e tij mësimore në mjediset e godinës qendrore të AU-së, me një sipërfaqe totale prej 3996 m² (Evidenca 3.6 – Planimetria e godinës).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Personeli akademik i kontaktuar gjatë vizitës së GVJ-së në AU, u shpreh se institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të tyre. Janë organizuar disa trajnime/aktivitete me fokus stafin (i.e.përdorimi i Google Classroom në kushtet e mësimin online) (Evidenca 3.5.a – Trajnime 2019-2020), por nga sa u informuam nuk lidhen dpd me aspektin akademik e kërkimor të stafit të Departamentit të Shkencave Juridike.</p> <p>Çdo vit organizohet një konferencë shkencore (përjashtimi për 2020 – në vijim shkak të pandemisë dhe situatës globale për këtë qëllim), me tematika aktuale që përfshijnë disa disiplina, ku përfshihen edhe shkencat juridike, ku mund të marrin pjesë të gjithë pedagogët e AU-së. Në mjaft raste, konferenca vjetore është organizuar në bashkëpunim me universitete të tjera vendase apo dhe të huaja (Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20).</p> <p>Po ashtu, edhe publikimet e stafit akademik efektiv në revistën ‘Optime’ janë pa pagesë, si pjesë e politikës së institucionit.</p> <p>Gjithashtu, në lidhje me kërkimin shkencor, parimisht institucioni mbështet promovimin e stafit akademik efektiv për avancimin në kualifikimin e tyre si dhe në pjesëmarrjen në aktivitete shkencore jashtë vendit. Por kjo nuk shoqërohet edhe me mbështetje financiare, sic konstaton GVJ dhe më tepër bëhet mbi baza individuale për efekt të avancimit/promovimit akademik.</p> <p>Pavarësisht se gjatë takimeve me stafin akademik efektiv të departamentit u përmend se ekziston mundësia që kundrejt një procedure kërkese për mbështetje financiare, kjo të mundësohej, por aktualisht nuk kishte një praktikë apo rast konkret ku stafi akademik efektiv të ishte mbështetur financiarisht nga institucioni në aktivitete shkencore jashtë vendit apo për kërkim shkencor jashtë vendit.</p> <p>Në këtë drejtim, përfshirja e pedagogëve në aktivitete shkencore/projekte të kërkimit shkencor ka qenë mbi baza individuale, fokusuar në: avancimin e tyre akademik për marrjen e gradës shkencore ‘Doktor’, botime në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit, konferenca shkencore kombëtare apo ndërkombëtare, përfshirje në projektet/partneritete që ka AU me institucione të tjera homologe të huaja, programe shkëmbimi etj (Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20; Evidenca 3.10 – Marrëveshja UNISA-AU: 2019-2021; Vizita e GVJ ne AU).</p>




<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Këtu mund të përmendim trajnimin që u organizuane që kishin në fokus teknologjinë dhe mësimdhënien apo disa trajnime për vitin akademik 2019-2020 si psh. Përdorimi i Google Classroom për mësimin online, shkëmbim experience mbi organizimin e orës së mësimin. (Evidenca 3.5.a – Trajnime 2019-2020 dhe Evidenca 3.5.b – Trajnime personeli prof.të huaj).</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>AU tregon për angazhimin e saj të burimeve njerëzore dhe trajnimin e tyre përmes tematikave të caktuara që i ka organizuar si pjesë të planifikimit që bën në fillim të vitit për trajnime apo aktivitete të tjera. Në kushtet aktuale kur mësimi dhe aktivitete të tjera janë online, situata nuk favorizon organizime apo aktivitete të caktuara. GVJ sugjeron që AU të investohet më shumë në lidhje me organizimin e më shumë aktiviteteve shkencore dhe kërkimore apo financimit dhe mbështetjes për kërkim për stafin e AU-së, përbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe rritjen e kualifikimit të stafit dhe cilësisë së tij.</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi IV.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>AU ndodhet në një zonë qendrore të kryeqytetit dhe përbëhet nga katër godina të ndara sipas fakulteteve përkatëse. Departamenti i Shkencave Juridike e zhvillon veprimtarinë e tij mësimore vetëm në mjediset e godinës qendrore të AU-së, me një sipërfaqe totale prej 3996 m² (Evidenca 3.6 – Planimetria e godinës). Institucioni garanton kapacitete dhe mjediset e mjaftueshme për realizimin e aktivitetit mësimdhënës akademik, në varësi të numrit të studentëve dhe grupeve mësimore. Për këtë program studimi MP, për shkak të numrit të pakët të studentëve, këto mjediset janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e moduleve përkatëse të këtij programi studimi MP në “E drejtë private”. (Vizita e GVJ-së në AU).</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjediset e tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Për zhvillimin sa më normal dhe cilësor të procesit mësimor në këtë program studimi, departamenti ka në dispozicion ambiente të përshtatshme, si: salla leksioni (9) dhe seminari (11), sallë konferencash/aktivitetesh, të pajisura me mjetet e nevojshme për zhvillimin cilësor të këtij procesi (Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20). Siç u vërejt edhe nga GVJ gjatë vizitës në institucion, sallat ndaheshin në salla leksioni dhe seminari, me kushte të mira dhe kapacitet mëse të mjaftueshëm për numrin e studentëve në këtë program studimi. Ambientet janë komode dhe të përshtatshme për mësimdhënie. (Vizita e GVJ-së në AU).</p>

<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Të gjitha sallat mësimore janë të pajisura me mjete audio-vizive të nevojshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin normal të procesit mësimor, ku përfshihen kompjuterat personal (Pc), video projektorë, sistem fonie, sistem kondicionimi, etj. (Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20).</p> <p>Kështu, AU siguron infrastrukturën e nevojshme, ofron kushte dhe ambiente të përshtatshme për zhvillimin e leksioneve, seminareve, apo aktiviteteve të tjera, ambiente këto të pajisura me kompjuter, videoprojektor, flipcharte, etj. që lehtësojnë realizimin e programit të studimit MP në “E drejtë private”. (Vizita e GVJ-së në AU).</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.</p>	<p>Për t’i ardhur në ndihmë studentëve të MP “E drejtë private” funksionon edhe laborator i informatikës, me kapacitet prej 30 personash. Ky laborator nëpërmjet programeve të instaluar i ndihmon studentët për esetë/detyrat në lëndët e këtij programi studimi si dhe për temat e diplomave. Ky laborator i shërben studentëve të AU-së në disa programe studimi, sipas një orari të përcaktuar dhe të ndarë për studentë të programeve të ndryshme.</p> <p>Një punonjës i IT-së është në dispozicion të mirëmbajtjes së laboratorit dhe rrjetit kompjuterik të AU-së gjatë kohës së zhvillimit të orëve mësimore, si dhe ofron asistencë teknike për studentët dhe stafin akademik, veçanërisht gjatë periudhës së mësimin online. (Vizita e GVJ-së në AU).</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike</p>	<p>Me mundësitë dhe infrastrukturën që ka, AU ka kapacitete të mjaftueshme për të organizuar veprimtari praktike apo veprimtari të posaçme vetë ose edhe në bashkëpunim me institucione të tjera. Kjo del jo vetëm nga RVB dhe dokumentacioni në dosje, por u evidentua nga GVJ edhe gjatë vizitës në institucion.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Pranë Fakultetit të Shkencave Shoqërore funksionon biblioteka e tij, e aksesueshme edhe për studentët e këtij program studimi të ciklit të dytë MP “E drejtë private”. Kjo bibliotekë ka kapacitet fizik prej 26 vendesh. Biblioteka zotëron fondin e saj fizik me botime/tituj në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj, fond i cili pasurohet herë pas here me blerje/hyrje të reja në varësi të nevojave të evidentuara nga departamenti. Siç rezultoi edhe gjatë takimeve, blerjet e fundit për pasurimin e fondit me 4 tituj të rinj në fushën juridike janë bërë në prill 2019, mbi bazën e propozimit të departamentit (Vizita e GVJ në bibliotekën e fakultetit dhe Evidenca 3.7 – Lista e titujve në DSHJ; Evidenca 4.1- Pasurimi i bibliotekës në prill 2019).</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

54

<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Në bibliotekë, literatura fizike përmban tituj të botimeve vendase dhe ta huaj, ku ndër ta shfaqen edhe tituj që i përkasin fushës juridike, e që janë të disponueshëm për pedagogët dhe studentët e këtij programi studimi, ku bën pjesë dhe literatura e detyrueshme e programit të studimit dhe e teksteve të Departamentit (<i>Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20; shih edhe evidencën mbi syllabuset e lëndëve-Aneks</i>).</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>AU ofron mundësi për akses të barabartë të studentëve në biblioteka online, pa pagesë, ku kryesore për këtë program studimi është ‘Questia’. Biblioteka elektronike “Questia”, ka rreth 83.000 libra akademike dhe mbi 10 milionë artikuj shkencorë, dhe që rezulton më e përdorshme për këtë program studimi. Ajo mund të aksesohet lirish dhe pa pagesë gjatë 24 orëve, nga pedagogë dhe studentë.</p>			
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Biblioteka e Fakultetit shërben njëkohësisht edhe si sallë interneti. Ajo përmban literaturë profesionale juridike kryesisht në gjuhën shqipe dhe angleze. Interneti është në dispozicion të orëve të studimit të studentëve, por edhe të stafit akademik.</p> <p>Nga informacioni që mori GVJ nga punonjësja e bibliotekës, në bibliotekë gjenden 172 tituj të fushës juridike. Siç u përmend më sipër pasurimi i fundit i këtij fondi me 4 tituj të rinj është bërë në 2019. Për shkak të situatës së shkaktuar nga Covid -19, studentët nuk e frekuentojnë, por një mundësi e mirë për ta dhe stafin akademik mbetet biblioteka online Questia, të cilën studentët mund ta aksesojnë pa pagesë në çdo kohë.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Nuk ka një plan të detajuar paraprak për fondin e bibliotekës, me buxhetin e parashikuar për këtë qëllim. Por duhet nënvizuar se pasurimi i fondit të bibliotekës me tekste apo materiale të tjera plotësuese në fushën juridike bëhet mbi bazën e kërkesave dhe nevojave që evidentohen nga departamenti, në mbështetje të programit të studimit (<i>Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20</i>).</p> <p>Nga informacioni që GVJ mori gjatë vizitës në institucion, rezulton se blerjet e fundit në këtë drejtim janë bërë në 2019.</p>			
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka punon gjatë orarit 08:00-16:00 nga e hëna në të premte, dhe 08:00-12:00 ditën e shtunë. Ky orar është dhe i afishuar në hyrje të bibliotekës. Për çdo student ka kartelë regjistrimi. Ky orar shërbimi vlen për të gjithë studentët, përfshirë edhe ata të programit të studimit MP në “E drejtë private”. Ky orar nuk ka ndryshuar nga sa është konstatuar nga vizita e mëparshme e GVJ në këtë institucion. Orari i bibliotekës nuk kishte ndryshuar, kjo edhe për shkak të situatës së pandemisë dhe zhvillimit të mësimin dhe aktiviteteve të tjera online. Shërbimi bibliotekar realizohet prej punonjësve të caktuar posaçërisht nga institucioni dhe ofrohet për stafin akademik dhe studentët.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	AU disponon një sistem menaxhimi nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga hyrja/regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit, informacion që mbahet në database përkatës. Ky sistem menaxhimi siguron ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të dhënave të studentit, si dhe shërben për të nxjerrë edhe statistika <i>(Vizita e GVJ në AU, takimi me Sekretarinë dhe Burimet Njerëzore)</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Sistemi i brendshëm i informacionit shërben edhe për administrimin e informacionit dhe dokumentacionit në lidhje me aktivitetin akademik të stafit dhe personelit administrative (Ky informacion menaxhohet nga struktura të ndryshme si: Administratori, Zyra e Burimeve Njerëzore, Sekretaria dhe struktura/shërbime të tjera specifike) <i>(Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20).</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Ky program studimi nuk rezultoi që ka akses të dedikuar në informacione e dokumente për personelin, studentët e këtij programi. Zyra e Burimeve Njerëzore në nivel institucional, mban dhe administrohet dosjet me të dhënat në lidhje me personelin akademik të angazhuar në mësimdhënie, kontratat, formën e punësimit (me kohë të plotë apo të pjesshme, etj. Të dhënat lidhur me anëtarët e personelit akademik ruhen dhe azhurnohen (të paktën një herë në vit) në Zyrën e Burimeve Njerëzore si dhe në departament. Institucioni mban dhe administrohet informacionin e përvitshëm lidhur me stafin akademik që angazhohet çdo semestër në këtë program studimi, me lëndën/lëndët përkatëse që mbulon dhe ngarkesën e planifikuar dhe të realizuar. Ky informacion bëhet edhe pjesë e analizave dhe raporteve në nivel njësie apo institucioni <i>(Vizita e GVJ në AU, takimi me Sekretarinë dhe Burimet Njerëzore; Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20).</i> Për studentët, sekretaria mësimore dhe departamenti kanë një rol të rëndësishëm në informimin e studentëve, mbajtjen e të dhënave për secilin prej tyre dhe koordinimin e procesit mësimor dhe aktiviteteve të tjera në funksion të tij.
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Për shkak të situatës së shkaktuar nga Covid-19, Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve dhe stafit të angazhuar në program, sistemin e menaxhimit të mësimdhënies online në platformën M. Teams, ku studentët dhe pedagogët në këtë sistem kanë akses të dedikuar në lëndët, në zhvillimin e mësimin, apo të provimeve në platformën Exam.net, etj. <i>(Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20).</i> Sipas studentëve, ky sistem i zhvillimit online të mësimin, për shumicën prej tyre funksionoi dhe kjo bëri që viti akademik 2019-2020 të mbyllej me sukses, me gjithë vështirësitë për shkak të situatës <i>(Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20).</i>

<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Nisur nga takimet e zhvilluara gjatë vizitës së GVJ-së në AU (ZBNJ, Sekretaria mësimore, përgjegjësi i departamentit) nuk mund të tkonkluojmë nëse sistemi i brendshëm i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrative apo jo. Ajo që rezultoi ishte se të dhënat që mbajnë zyra/struktura të ndryshme, përpunohen dhe reflektohen edhe në raporte të ndryshme që hartohen si për autoritetet dhe organet më të larta drejtuese të universitetit, ashtu edhe raportime për institucione të tjera që monitorojnë IAL-të. (Minutat e Vizitës së GVJ në AU)</p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe</p>	<p>Në faqen e internetit të AU-së, publikohen informacione të ndryshme në lidhje me programin e studimit, aktivitetin mësimor dhe ekstrakurikular, aktivitetet e ndryshme që organizon institucione, personelin akademik, broshura dhe manual, aktet e brendshme rregullatore, etj. Këto materiale janë në gjuhën shqipe, si gjuhë kryesore. Gjithashtu, informacione të caktuara janë të vlefshme edhe në dy gjuhë të tjera; anglisht dhe italisht. Faqja zyrtare e AU: www.albaniauniversity.edu.al</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.6 Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>AU harton çdo vit një raport në lidhje me transparencën financiare, ku pasqyrohen të dhënat dhe gjendja financiare. Në raport pasqyrohen të dhëna financiare në lidhje me koston për secilin program studimi, duke bërë kështu edhe një vlerësim të ecurisë dhe vazhdimësisë së programeve, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e vendosura. Në to përfshihet kosto për çdo program studimi, kostot operacionale dhe të mirëmbajtjes, etj. Financimi dhe të ardhurat për Departamentin e Shkencave Juridike janë pjesë e informacionit dhe të dhënave financiare të AU-së. (Aneks RVB – Tabelat Përmbledhëse MP në E drejtë Private: Tabela 18; Vizita në AU dhe takimi me administratoren;).</p> <p>Nga sa vërehet, rezulton se AU aktualisht ka qëndrueshmëri financiare dhe kapacitete financiare për të përballuar këtë program studimi, por mbetet të analizohet ecuria e këtij programi studimi dhe kostoja për mbajtjen e tij në të ardhmen.</p> <p>Kështu që GVJ rekomandon që ky vlerësim financiar të bëhet sa më parë, për një planifikim sa më të mirë të kostove të programit të studimit dhe nëse do të vijojë mbështetjen financiare dhe për sa kohë do mbështetet financiarisht nga AU.</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për</p>	<p>AU harton çdo vit një raport në lidhje me transparencën financiare, ku pasqyrohen të dhënat dhe gjendja financiare dhe bëhet një vlerësim i ecurisë dhe vazhdimësisë së programeve, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e vendosura. Në to përfshihet kosto për çdo</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

57

<p>mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologji mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line detyrimet financiare, grantet vendëse apo huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zë të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>program studimi, pasi kostoja ndryshon nga një program studimi në tjetrën. AU nuk përfiton nga ndonjë grant i huaj. (<i>Aneks RVB – Tabelat Përmbledhëse MP në E drejtë Private: Tabela 18</i>).</p> <p>Gjatë vizitës së GVJ-së në AU, nuk morëm një përgjigje për të ardhmen e këtij programi, projeksionin e këtij programi, a kishte ndonjë plan apo parashikim për këtë program studimi dhe ku/si do të orientohej ai në kushtet e reja, duke marrë parasysh tregun dhe nevojat e tij, numrin e pakët të studentëve të regjistruar, koston dhe nëse do vazhdohej të mbahej, kalimi në programin e integruar, 5 vjeçar në drejtësi, etj., Pra, ende nuk ishte bërë një analizë dhe planifikim i tillë për këtë program MP. (<i>Vizita në AU dhe takimi me administratoren</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>AU kryen një auditim të përvitshëm të brendshëm dhe të jashtëm mbi situatën e tij financiare. Në nivel të brendshëm, ky auditim kryhet nga Zyra e Auditimit në varësi të Bordit të Administrimit, ndërsa auditimi i jashtëm kryhet nga një ekspert kontabël i miratuar dhe regjistruar, sipas kuadrit ligjor në fuqi.</p> <p>Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve. Financimi dhe të ardhurat për Departamentin e Shkencave Juridike janë pjesë e informacionit dhe të dhënave financiare të AU-së.</p> <p>Ajo që duhet theksuar lidhet me faktin se duhen bërë më shumë përpjekje për të përfituar grante të huaja dhe për t'u përfshirë më shumë në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, apo për të pasur një buxhet të dedikuar për departamentin (ndarja e burimeve financiare) (<i>Vizita në AU dhe takimi me administratoren</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij. AU ka të dokumentuar raportet financiare për tri vitet akademike të fundit, proces ky që fillon në çdo vit, në periudhën mars-maj. Në fund raporti miratohet nga Bordi i Administrimit, dhe aty parashikohen edhe ndërhyrjet e mundshme dhe eventuale të financimit të programit të caktuara të studimit. (RVB, standarti IV.6, kriteri 4, shih edhe https://albanianuniversity.edu.al/sq/bordi-i-administrimit-2/).</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>Nga informacioni dhe vizita institucionale, rezultojnë se Institucioni ka stabilitet financiar për të garantuar në vijim aktivitetin akademik dhe kërkimor-shkencor të tij (<i>Aneks RVB – Tabelat Përmbledhëse MP në E drejtë Private: Tabela 18; Vizita në AU dhe takimi me administratoren;</i>).</p> <p>Të ardhurat kryesore vijnë kryesisht nga tarifat e studentëve, por edhe nga aktivitete apo shërbime tregtare të ofruara.</p> <p>Në buxhetin afat-mesëm dhe atë të vitit fiskal të AU, parashikohet edhe mënyra e përdorimit të fondeve. Ndahen në tre kategori të mëdha si: Shpenzime për mësimdhënie dhe shkencë; shpenzime të administrimit institucional; Shpenzime të përgjithshme operative. Ndarja dhe mënyra e përdorimit të fondeve bëhet për çdo njësi bazë, lidhur me kërkesat e shprehura prej tyre, duke marrë në konsideratë fondin e pagave, kontributet shoqërore dhe shëndetësore, për veprimtari shkencore dhe fondin e ekselencës. Shpërndarja bëhet në</p>

	mënyrë të drejtë, në varësi të numrit të studentëve, stafit akademik dhe administrativ të punësuar për çdo njësi. (www.https://albanianuniversity.edu.al/sq/menyra-e-perdorimit-te-fondeve-ne-au/).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Kohëzgjatja normale e programit të studimit MP “E drejtë private” është 60 ECTS, me kohëzgjatje 1 vit akademik dhe maksimalja 2 vite akademike për mbylljen e studimeve në këtë program (<i>Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private</i>). Ky program ofrohet në përputhje me LAL dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi si dhe aktet rregullatore të nxjerra nga AU që lidhen edhe me politikën studentore nga hyrja në dalje. Nëpërmjet politikave, kriterëve dhe procedurave, synohet të përzgjidhen për të vazhduar studimet kandidatët me rezultate sa më të larta.
Kriteri 2. Politikën dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejtën e njëjta për të gjithë kandidatët për studentët dhe studentët e programit të studimit.	Ky program studimi është hartuar dhe zbatohet duke marrë parasysh lirinë akademike, të drejtat dhe detyrimet e stafit dhe të studentëve bazuar në legjislacionin në fuqi në RSH. Si i tillë, ai garanton të drejtën e njëjta për të gjithë kandidatët që aplikojnë në AU si dhe studentët e këtij program studimi (<i>Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private</i>).
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Objektivat e këtij programi janë të qartë, të ndërthurur mbi bazën e objektivave institucionale. Ky program studimi ndiqet nga studentët që kanë një diplomë të nivelit Bachelor në Drejtësi. Përmes këtij programi, ata pajisen me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale në fushën e së drejtës private, që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij, për kualifikimin e nevojshëm dhe specializimin në fushën e së drejtës private, dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Kriteret, procedurat e pranimit, transferimit, vlerësimit dhe diplomimit, përcaktohen në Rregulloren e këtij programi (<i>Evidenca 1.5</i>).

	<p>- Rregullore MP në E drejtë private) dhe janë të kuptueshme për publikun.</p> <p>Plani mësimor për këtë program studimi u bëhet me dije të interesuarve përmes mjeteve dhe burimeve të ndryshme të informimit. Ai mund të gjendet në informacionin që u jepet të interesuarve në fillim të vitit akademik përmes materialeve, posterave, broshurave informuese, etj (Dokumente shtesë: Evidenca 9 –Informacion mbi rregulloret dhe broshurat për studentët) si dhe mund të aksesohet edhe në rrugë elektronike në faqen Web të institucionit</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>Përzgjedhja e kandidatëve për këtë program studimi bëhet përmes aplikimit nga ana e kandidatëve të interesuar, sipas kriteve të vendosura dhe brenda afatit të përcaktuar. Aplikimi për programin bëhet përmes web të RASH, në përputhje me aktet e nxjera nga MASR për këtë qëllim. Departamenti shpall listën e kandidatëve fitues për programet master me renditjen përkatëse përpara fillimit të procesit mësimor. Numri i pranimeve bazohet në mundësitë reale të njësisë për një mësim normal dhe brenda standardeve të kërkuara nga legjislacioni për arsimin e lartë në RSH dhe aktet e brendshme rregullatore të AU-së (Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private) dhe janë të kuptueshme për publikun.</p> <p>Për të ndjekur programin e studimit Master Profesional në “E drejtë private”, studenti duhet të ketë një diplomë të ciklit të parë Bachelor, ose diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit ekuivalente me të. Çdo kandidat është i detyruar të plotësojë kriteret hyrëse të vendosura nga AU.</p> <p>(Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private)</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit</p>	<p>Përpara fillimit të vitit akademik, Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve vë në dispozicion të tyre materiale dhe broshura informuese për t'i informuar dhe njohur ata me programin e studimit, organizimin e institucionit, të drejtat dhe detyrat e studentit, jetën studentore, etj. përmes Manualit të Studentit (Evidenca 5.4 –Manuali i Studentit; Evidenca 5.1. – Rregullore e Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentëve).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Standardi V.2</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>AU vë në dispozicion të studentëve informacionin e nevojshëm në lidhje me kriteret e procedurat e avancimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin, detyrimeve akademike, etj. përmes sesioneve informuese, nga departamenti në bashkëpunim me strukturat e tjera mbështetëse të AU-së. AU ka strukturat e tij për pritjen e studentëve dhe pranimin e tyre në çdo fillim viti akademik, për informimin mbi institucionin dhe programet e studimit që ofrohen, akreditimin e tyre dhe të institucionit,</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

60



	<p>vlefshmërinë e diplomës së lëshuar, mundësitë për transferime kreditesh, etj..</p> <p>Kështu, në çdo fillim viti akademik, në javën e parë të tij organizohen “Java e orientimit” ku studentët njihen më gjerësisht me programin që do të ndjekin, strukturën dhe përmbajtjen e tij, të drejtat dhe detyrimet, mundësitë që ofron ky program studimi, rregullat për frekuentimin dhe vlerësimin, praktikën mësimore, diplomimin, etj. Për këtë qëllim, Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët u vë në dispozicion atyre, materiale dhe broshura informuese dhe orientuese si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm për programin e studimit që do ndjekin. Në ndihmë të këtij procesi, studentëve u vjen edhe informacioni që përmban Manual i Studentit. (Evidenca 5.1. – Rregullore e Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentëve; Evidenca 5.4 – Manuali i Studentit; Dokumente shtesë: Evidenca 11- Agjenda Java e orientimit, viti akademik 2019-2020).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Juridike në bashkëpunim me njësi/struktura të tjera informon studentët mbi programin e studimit MP “E drejtë private”, përmbajtjen dhe organizimin e tij, kohëzgjatjen e studimeve në këtë program dhe afatin e përfundimit, kalendarin akademik, fillimin dhe mbarimin e vitit akademik, njohjen e kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesshme që ata mund të kenë kryer, sezonet e provimeve etj. (Evidenca 5.4 – Manuali i Studentit; Dokumente shtesë: Evidenca 9 –Informacion mbi rregulloret dhe broshurat për studentët).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Njohuritë e përfituara nga studenti kontrollohen dhe vlerësohen me pikë përmes një kombinimi të frekuentimit dhe aktivizimit të studentit gjatë orëve të mësimin në auditor, provimeve me shkrim, eseve/detyrave të kursit, që zhvillohen sipas afateve të caktuara në kalendarin akademik, të bëra publike nga Departamenti përkatës dhe që janë të detyrueshme për zbatim si nga pedagogët ashtu dhe nga studentët (Evidenca 1.5 -Rregullore MP në E drejtë private, neni 24).</p> <p>Studentët marrin informacione të vazhdueshme nga pedagogu/ët i lëndës dhe sekretaria mësimore mbi vlerësimet e zhvilluara gjatë semestrit, si: vlerësimi i provimit të ndërmjetëm, vlerësimi i aktivizimit në seminare, detyra kursi dhe vlerësimi përfundimtar.</p> <p>Studenti ka të drejtë të njihet me tezën e provimit pas korigjimit, pasi të bëhet edhe ç’sekretimi i tyre. Ai ka të drejtë të njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë si dhe me pikët në çdo rubrikë, si dhe ka të drejtën e ankimimit brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve (Evidenca 1.5 -Rregullore MP në E drejtë private, neni 23; Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>AU përmes informacioneve të ndryshme nga departamenti dhe Manualit të Studentit, i informon ata në lidhje me kriteret e punimit të diplomës në këtë program studimi. Departamenti i Shkencave Juridike ka zgjedhur si formë të përfundimit të studimeve mbrojtjen me temë diplome para komisionit të ngritur për këtë qëllim. Tema e diplomës ka karakter teoriko-aplikativ dhe studentit drejtohet për këtë qëllim nga një pedagog i departamentit i cili e ka miratuar. Në përfundim të programit të studimit MP “E drejtë private”, studentit pajiset me diplomën përkatëse dhe suplementin e saj, që i jepet studentit në përfundim të programit të studimit, pasi ka plotësuar të gjitha detyrimet akademike të lidhura me të.</p> <p>(Evidenca 1.5 -Rregullore MP në E drejtë private; Evidenca 3.13.a – Diplomë Master Profesional dhe Evidenca 3.13.b – Suplementi i Diplomës MP në E drejtë Private).</p>

<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni u vë në dispozicion studentëve udhëzues të posaçëm siç është Manuali i Studentit dhe i njeh me planin mësimor për këtë program studimi, përmes mjeteve dhe burimeve të ndryshme të informimit. Ai mund të gjendet në informacionin që u jepet të interesuarve në fillim të vitit akademik përmes materialeve, posterave, broshurave informuese, etj si dhe mund të aksesohet edhe në rrugë elektronike në faqen web të institucionit:</p> <p>Departamenti në bashkëpunim me Zyrën e Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentëve, në çdo fillim viti akademik, në javën e parë të tij organizohen Java e orientimit apo “orët e hapura” ku studentët njihen më gjerësisht me programin që do të ndjekin, strukturën dhe përmbajtjen e tij, mundësitë që ofron ky program studimi, rregullat për frekuentimin dhe vlerësimin, praktikën mësimore, diplomimin, etj. Po ashtu Departamenti në çdo fillim viti/semestri me anë të pedagogëve të departamentit, jep informacion në lidhje me lëndët/modulet, kreditet, syllabusin përkatës, ngarkesën mësimore, frekuentimin dhe orët në auditor, vlerësimin, etj. Syllabuset janë të vlefshme për studentët në hard copy por edhe elektronikisht.</p> <p>Një rol me rëndësi ka edhe Zyra e Karrierës dhe Alumnit, që siguron shërbimin e këshillimit të karrierës për studentët. Nëpërmjet kontakteve dhe takimeve të vazhdueshme, studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës. Ky këshillim konsiston në asistencën që u jepet studentëve për çështje të tilla si p.sh. si të shkruhet një CV, prezantimi në një intervistë, etika në komunikim, etj. AU ka hartuar për këtë qëllim për studentët edhe “Udhëzuesin për Zhvillimin e Karrierës”.</p> <p>Gjithashtu, kjo zyrë mban lidhjet me alumni, si dhe shërben si urë lidhëse për studentët, me universitetin dhe tregun e punës.</p> <p><i>(Evidenca 1.5 -Rregullore MP në E drejtë private, neni 23; Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20; Evidenca 5.1. – Rregullore e Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentëve; Evidenca 5.2 – Rregullore e Zyrës së Karrierës dhe Alumnit; Evidenca 5.3 – Udhëzues për Zhvillimin e Karrierës; Evidenca 5.4 – Manuali i Studentit; Dokumente shtesë: Evidenca 11- Agenda Java e orientimit, viti akademik 2019-2020).</i></p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>


Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën,</p>	<p>Studenti ka të drejtë të informohet me programin mësimor, strukturën dhe përmbajtjen e tij, kohëzgjatjen e këtij programi MP, lëndët/modulet që zhvillohen, syllabuset e tyre, njihet me detyrimet</p>

<p>organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>semestrale dhe vjetore përmes plan programit mësimor apo vendimeve të nxjerra nga departamenti apo senati (<i>Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private dhe</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Institucioni i mundëson studentëve të këtij program informacion të nevojshëm ku studentët njihen më gjerësisht me programin që do të ndjekin, strukturën dhe përmbajtjen e tij, lëndët që do të zhvillojnë, mundësitë që ofron ky program studimi, rregullat për frekuentimin dhe vlerësimin, praktikën mësimore, diplomimin, etj. Po ashtu Departamenti në çdo fillim viti/semestri me anë të pedagogëve të departamentit, jep informacion në lidhje me lëndët/modulet, kreditet, syllabusin përkatës, ngarkesën mësimore, frekuentimin dhe orët në auditor, vlerësimin, etj. Syllabuset janë të vlefshme për studentët në hard copy por edhe elektronikisht dhe përmbajnë literaturën e detyrueshme dhe atë të rekomanduar. Për shkak të situatës së shkaktuar nga Covid-19, aksesit i këtyre informacioneve (ashtu si edhe mësimdhënia) fasilitohet përmes platformës online Teams. (<i>Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private; Evidenca 5.1. – Rregullore e Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentëve; Evidenca 5.4 – Manuali i Studentit; Syllabuset e lëndëve</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Strukturat e tjera që funksionojnë në mbështetje të veprimtarisë akademike dhe aktiviteteve si psh. Zyra e Karrierës dhe Alumni, Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentëve, kanë një rol të rëndësishëm në informimin e studentëve, mbajtjen e të dhënave për secilin prej tyre dhe koordinimin e procesit mësimor dhe aktiviteteve të tjera në funksion të tij, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin në tregun e punës. Gjithashtu, edhe gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim, përmes sesioneve informuese, nga departamenti në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës dhe Alumni, apo përmes organizimit të Panairit të Karrierës, etj (<i>Minutat e vizitës së GVJ në AU me përfaqësueset e Zyrës së Karrierës dhe Alumnit dhe Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentëve</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentëve u vihet në dispozicion informacion i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij, veçanërisht kjo në situatën kur mësimi dhe aktivitetet e tjera akademike zhvillohen online. Kjo gjë u evidentua nga GVJ edhe gjatë takimeve dhe vizitës në AU. AU ka strukturat e tij për pritjen e studentëve dhe pranimin e tyre në çdo fillim viti akademik, për informimin mbi institucionin dhe programet e studimit që ofrohen, akreditimin e tyre dhe të institucionit, vlefshmërinë e diplomës së lëshuar, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij (<i>Evidenca 1.5 -Rregullore MP në E drejtë private; dhe takimet në AU gjatë vizitës së GVJ</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet</p>	<p>Informacioni në lidhje me këtë program studimi mundësohet përmes mënyrave të ndryshme dhe është edhe i aksesueshëm online, në web site e AU-së, përmes platformës Teams dhe e-maileve të studentëve. (<i>Minutat e vizitës së GVJ</i>).</p>




të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	AU disponon statistika mbi numrin e të diplomuarve në programin e studimit MP në “E drejtë Private”. Sipas të dhënave institucionale, për vitin akademik 2018-2019 janë diplomuar 16 studentë në këtë program, ndërsa për vitin akademik 2019-2020 janë diplomuar 6 studentë (<i>Aneks RVB – Tabelat Përmbledhëse MP në E drejtë Private: Tabela 22</i>).
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	AU disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit MP në “E drejtë private”, tërheqjet nga programi, transferimet apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. Kështu, sipas të dhënave institucionale, për vitin akademik 2018-2019 janë regjistruar për herë të parë 15 studentë në këtë program dhe 5 me transferim (pra totali 20), ndërsa për vitin akademik 2019-2020 janë regjistruar për herë të parë 9 studentë dhe në vitin akademik 2020-2021 janë regjistruar për herë të parë 6 studentë (<i>Aneks RVB – Tabelat Përmbledhëse MP në E drejtë Private: Tabela 21 dhe Minutat e Vizitës në AU</i>).
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	AU disponon statistika mbi ecurinë e studentëve të këtij programi, që nga pranimi deri në diplomim. Këto të dhëna bëhen pjesë e raporteve të ndryshme që hartohen si në nivel njësie (<i>Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20</i>) ashtu edhe në raportin vjetor institucional, si dhe janë pjesë e raportimeve institucionale (<i>RVB</i>).
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Sekretaria mësimore menaxhon të dhënat e studentëve për programin e studimit dhe informacioni menaxhohet dhe ruhet në në database e sekretarisë. Po ashtu, sekretaria përpilon regjistrat, të cilët janë specifik për çdo lëndë, si dokument zyrtar që evidenton dhe vërteton zhvillimin e orës së mësimi nga pedagogu dhe frekuentimin e orës së mësimi nga studenti dhe evidenton kreditet që ai ka siguruar në atë lëndë si dhe zhvillimin e orëve dhe tematikave të parashikuara sipas syllabusit të lëndës. Vlerësimi i studentëve pasqyrohet në proces-verbale të cilat sekretaria mësimore i vë në dispozicion pedagogut të lëndës në sezonin e provimeve, të cilat në përfundim depozitohen dhe ruhen sërish në sekretari. Detyrimi i studentëve për frekuentim është jo më pak se 75% e orëve mësimore. Në rast se studenti ka kryer më tepër se 25 % të mungesave të orëve mësimore në lëndë ai nuk mund

	<p>të hyjë në provimin e parë të lëndës (<i>Evidenca 1.5 -Rregullore MP në E drejtë private, neni 15</i>).</p> <p>Të dhënat e studentëve janë të pasqyruara në Regjistrin themeltar, në Regjistrin e rezultateve akademike të studentit si dhe në Regjistrin e Diplomave. Këto të dhëna janë edhe në database përkatës. Studentët lehtësisht mund të njihen me vlerësimet që lëndë përmes aksesit në sekretarinë online. Me këto të dhëna GVJ u njoh edhe gjatë takimeve institucionale në AU (konkretisht takimi me sekretarinë mësimore dhe njohja me këto regjistra).</p> <p>GVJ gjatë takimit, tërhoqi vëmendjen që të dhënat në regjistrin themeltar duhet të menaxhoheshin dhe të mbahen me kujdes, si dhe pasqyrimi i të gjithë informacionit të nevojshëm për studentin në to, duhet të jetë i saktë dhe i plotë.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve</p>	<p>Zyra e Karrierës dhe Alumnit është struktura përgjegjëse që mban kontakte me të diplomuarit dhe kontakton në mënyrë të herëpashershme me ta, për të gjurmuar të diplomuarit dhe përditësuar bazën e të dhënave, si dhe për të ruajtur lidhjet me universitetin (<i>Evidenca 5.2 – Rregullore e Zyrës së Karrierës dhe Alumnit</i>). Si politikë të saj, AU ka edhe punësimin e atyre studentëve (alumni) që kanë përfunduar studimet në programet që ofron universiteti, si pjesë tashmë e strukturave të AU-së.</p> <p>Kështu, sipas të dhënave të paraqitura nga AU, janë të punësuar në AU, studentë që të paktën 1 cikël studimi e kanë kryer në programet që ofron Departamenti i Shkencave Juridike, në pozicione si akademike ashtu edhe administrative. Kështu sipas të dhënave institucionale, 5 alumni që kanë përfunduar studimet në drejtësi, janë punësuar si personel akademik në Departamentin e Shkencave Juridike (3 prej tyre PAE dhe 2 PAK) dhe 8 alumni si staf administrativ në AU në pozicione të ndryshme (<i>Dokumenta shitesë: Evidenca 13 – Alumni dhe punësimi në AU</i>).</p> <p>Gjithsesi, GVJ vëren se nga këto të dhëna nuk arrihet të nxirret nëse ndonjë prej këtyre alumni ka përfunduar programin e studimit MP në “E drejtë private”. Po ashtu, nuk kemi të dhëna se sa studentët që janë diplomuar në këtë program studimi kanë arritur të punësohen në përputhje me diplomën e marrë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e</p>	<p>Sipas akteve rregullatore të AU-së (<i>Statut, Rregullore e Përgjithshme</i>), përfshirja dhe angazhimi i studentëve bëhet në përputhje me LAL dhe aktet e tjera në fuqi. Në AU, studentët marrin pjesë në: Senat, Këshill</p>




<p>këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Studentor, Komisionet e përhershme në nivel universiteti sipas përcaktimeve statutore.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>AU garanton pjesëmarrje reale të studentëve kryesisht në procesin e vlerësimit të mësimdhënies dhe proceseve të tjera akademike, përmes pyetsorëve, fokus-grupeve, përfaqësimit studentor në organet kolegjiale të universitetit për të përcjellë zërin e studentëve. Këto rezultate janë konkrete dhe evidentojnë edhe problematike të caktuara studentorë që duhen adresuar. Pyetësorë të studentëve zhvillohen 2 herë në vit, 1 në çdo semestër. Po ashtu fokus-grupe (1 në vit, që zhvillohet në muajin dhjetor), e që jep informacion mbi vlerësimin e mësimdhënies, procesit mësimor, infrastrukturës etj. Po ashtu, kjo u evidentua edhe nga takimi me studentët e këtij programi gjatë vizitës së GVJ-së në AU.</p> <p><i>(Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20; Evidenca 3.2 – Shkresë Fokus-grupet; Evidenca 3.1 – Pyetsori; Evidenca 6.8 – Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-së; Minutat e vizitës së GVJ-së në AU).</i></p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesëshme të mëparshme.</p>	<p>AU mban parasysh në hartimin apo ndryshimet e mundshme të programit, ngarkesën e studentëve brenda dhe jashtë auditorit, duke bërë një shpërndarje të kësaj ngarkese mes punës në auditor dhe jashtë tij për secilën lëndë, sipas përcaktimeve të VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar.</p> <p>Njohja e studimeve të mëparshme përmes transferimit të krediteve të përfuara në një IAL tjetër është e parashikuar në aktet e brendshme rregullatore <i>(Evidenca 2.3 – Rregullore e transferimeve dhe regjistrimeve)</i>.</p> <p>Mbi këtë bazë, në gusht 2020, në departament është ngritur dhe funksionon Komisioni i Njohjes së Krediteve dhe Transferimit të Studimeve, kryesuar nga përgjegjësi i departamentit <i>(Evidenca 5.5 – Komisioni i Transferimeve në Departament)</i>.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Si pjesë e komisioneve të përhershme institucionale <i>(Evidenca 1.4 – Statuti i AU-së)</i>, studentët kanë të drejtë të japin mendime dhe të përfshihen në procesin e hartimit apo ndryshimit të kurrikulës, të përmirësimit të programeve të studimit, duke dhënë kështu kontributin e tyre me vlerë. Sugjerimet dhe kontributi i studentëve merret edhe në nivel departamenti, në mënyrë të dpd për programin konkret të studimit që ata ndjekin (i.e. pyetsorët, fokus-grupe, etj).</p>
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Studentët marrin informacione të vazhdueshme nga pedagogu/ët i lëndës dhe sekretaria mësimore mbi vlerësimet e zhvilluara gjatë semestrit, si: vlerësimi i provimit të ndërmjetëm, vlerësimi i aktivizimit në seminare, detyra kursi dhe vlerësimi përfundimtar.</p> <p>Studenti ka të drejtë të njihet me tezën e provimit pas korrigjimit, pasi të bëhet edhe ç’sekretimi i tyre. Ai ka të drejtë të njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë si dhe me pikët në çdo rubrikë, si dhe ka të drejtën e ankimimit brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve <i>(Evidenca 1.5 – Rregullore MP në E drejtë private, neni 23)</i>.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Juridike në bashkëpunim me njësi/struktura të tjera informon studentët mbi programin e studimit MP “E drejtë private”, përmbajtjen dhe organizimin e tij, kohëzgjatjen e studimeve në këtë program dhe afatin e përfundimit, akreditimin dhe mundësitë për punësim pas diplomimit, kalendarin akademik, fillimin dhe mbarimin e vitit akademik, pushimet/festat zyrtare, sezonet e provimeve etj.</p> <p>Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët dhe Zyra e Karrierës dhe Alumnit angazhohen në mbështetje të studentëve përgjatë gjithë ciklit të studimeve master. Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët u vë në dispozicion atyre, materiale dhe broshura informuese dhe orientuese si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm për programin e studimit që do ndjekin. Në ndihmë të këtij procesi, studentëve u vjen edhe informacioni që përmban Manuali i Studentit. (Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private; Evidenca 5.1. – Rregullore e Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentëve; Evidenca 5.2 – Rregullore e Zyrës së Karrierës dhe Alumnit; Evidenca 5.4 – Manuali i Studentit).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. .</p>	<p>Përmes departamentit, studentëve të këtij programi studimi u ofrohet këshillim dhe kujdestari (tutoriat) gjatë gjithë periudhës së studimeve (Evidenca 1.5 - Rregullore MP në E drejtë private).</p> <p>Departamenti ndihmon studentët që hasin vështirësi për përvetësimin e lëndëve apo plotësimin e detyrimeve të ndryshme akademike të programit të studimit, nëpërmjet orëve të konsultimit të zhvilluara me pedagogët, si dhe mbështetje dhe konsultim që ofrohet nga pedagogët e departamentit në lidhje me temën e diplomës që mbron studentin në përfundim të këtij cikli dhe parametrat që ajo duhet të plotësojë.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në</p>	<p>AU ka strukturat e tij për pritjen e studentëve dhe pranimin e tyre në çdo fillim viti akademik, për informimin mbi institucionin dhe programet e studimit që ofrohen, akreditimin e tyre dhe të institucionit, vlefshmërinë e diplomës së lëshuar, mundësitë për transferime kreditesh, praktikën profesionale, diplomimin, punësimin etj. Studentët asistohen për këtë qëllim dhe marrin informacionin e nevojshëm nëpërmjet takimeve të organizuara nga departamenti në bashkëpunim me Zyrën e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët Zyra e Karrierës dhe Alumnit (Evidenca 5.1 - Rregullore e Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentëve; Evidenca 5.2 – Rregullore e Zyrës së Karrierës dhe Alumnit).</p>

institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.				
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse	Zyra e Karrierës dhe Alumnit mban kontakte me të diplomuarit dhe kontakton në mënyrë të herëpashershme me ta, për të përditësuar bazën e të dhënave, për të mbajtur lidhjet me universitetin si dhe për të ndjekur cilësinë e punësimit të tyre. (Evidenca 5.2 – Rregullore e Zyrës së Karrierës dhe Alumnit).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Sigurimi i brendshëm i cilësisë në AU bazohet në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë si dhe në Standardet Shtetërore për Sigurimin e Cilësisë. Sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë funksionon që prej vitit akademik 2009-2010, ngritur me vendim të Senatit Akademik të AU-së. AU ka një organizim strukturor të brendshëm në lidhje me sigurimin e cilësisë, si dhe ka përcaktuar modalitetet dhe procedurën përmes të cilave realizohet sigurimi i cilësisë dhe ndjekja periodike e vlerësimit të veprimtarive të kryera akademike dhe shkencore, në përmbushje të standardeve të kërkuara. AU ka përdorur rregullisht një sërë mekanizmash formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e këtij programi studimi MP. Aktualisht ky sistem i sigurimit të brendshëm të cilësisë përbëhet nga Komisioni i Vlerësimit Institucional dhe NJSBC (Evidenca 1.4 – Statuti i AU-së dhe Evidenca 1.2- Rregullore e Përgjithshme e AU-së).

	<p>Ky sistem, përbëhet nga Komisioni për Vlerësim Institucional dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Komisioni për Vlerësimin Institucional është organ kolegjal prej 5 anëtarësh i ngritur me vendim të Senatit Akademik të AU-së, në përbërje të të cilit është edhe një student i zgjedhur nga këshilli studentor. Në varësi të këtij Komisioni funksionon NJSBC e cila realizon vlerësimin dhe kontrollin e cilësisë si dhe ofron ekspertizë në lidhje me proceset e sigurimit të cilësisë.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Për sigurimin e brendshëm të cilësisë është ngritur e vepron Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në varësi të Komisionit për Vlerësimin Institucional (<i>Evidenca 1.4 – Statuti i AU-së, neni 66 dhe Evidenca 1.2- Rregullore e Përgjithshme e AU-së neni 14</i>), konform kërkesave të Ligjit nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me aktet e brendshme rregullore të AU-së.</p> <p>Po ashtu, AU ka adoptuar dhe zbaton edhe një Strategji për Sigurimin e Cilësisë 2018-2021 (<i>Evidenca 6.4- Strategjia per Sigurimin e Cilësisëe AU-së</i>), strategji kjo e bazuar në Planin Strategjik të Zhvillimit Institucional 2017-2022 dhe Statndartet Shtetërore të Cilësisë.</p> <p>NJSBC për çdo vlerësim që organizon, ngre Grupin e Vlerësimit të Brendshëm (GVB), ku merr pjesë edhe një student (<i>Evidenca 1.4 – Statuti i AU-së, neni 67/2; Evidenca H- Ngritja e GVB-së</i>). Në vitin 2016, me Vendim të Senatit Akademik të AU-së, u vendos ngritja e grupeve të brendshme të sigurimit të cilësisë në nivel departamenti (<i>Evidenca 6.3 – Sigurimi i cilësisë në nivel departamenti</i>).</p> <p>Sipas dokumentacionit të paraqitur, rezulton se GVB është ngritur në tetor 2020 dhe për programin e studimit MP në “E drejtë private” përbëhet nga 2 pedagogë me gradën shkencore “Doktor” të këtij departamenti dhe 1 student (alumni) (<i>Evidenca H- Ngritja e GVB-së</i>).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ nuk kontaktoi dot me drejtuesen e NJSBC-së për faktin se ajo ishte larguar dhe nuk ishte më e punësuar në AU. Në kohën e vizitës në AU, ende nuk ishte bërë zëvendësimi i saj dhe GVJ rekomandon që nga ana e institucionit, për mbarëvajtjen sa më normale të kësaj strukture të rëndësishme, të plotësohet vakanca e shkaktuar nga ikja e drejtueses së mëparshme të NJSBC-së.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Institucioni vlerëson në mënyrë periodike cilësinë. NJSBC e ngritur në AU gëzon autonomi të plotë në veprimtarinë e saj dhe ka akses për të marrë dhe kontrolluar të gjitha të dhënat e nevojshme të veprimtarisë së institucionit. NJSBC planifikon dhe organizon vlerësimin e brendshëm të cilësisë së programeve të studimit si dhe të vlerësimit të brendshëm institucional si dhe bashkëpunon me ASCAL për trajnimin e anëtarëve të saj si dhe vlerësimin e jashtëm periodik (<i>Evidenca 1.4 – Statuti i AU-së</i>).</p> <p>NJSBC e zhvillon punën e saj sipas një kalendari të përcaktuar, e që më pas nxjerr raportet me gjetjet përkatëse (<i>Dokumnete shtesë: Evidenca 14.3 – Kalendar aktivitetet NJSBC</i>).</p> <p>Për vlerësimin e jashtëm të cilësisë, programet e studimit i nënshtrohen procesit të akreditimit, në mënyrë periodike. Për këtë qëllim, institucioni bashkëpunon ngushtë me ASCAL.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

69

<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Sigurimi i cilësisë është pjesë e strategjisë së përgjithshme të zhvillimit të AU-së. AU ka në fuqi një Strategji 3 vjeçare për Sigurimin e Cilësisë, miratuar nga Senati Akademik i AU-së me Vendimin nr. 75, datë 05/12/2018 (<i>Evidenca 6.4 - Strategjia për Sigurimin e Cilësisë e AU-së</i>). Objektivat strategjikë të sigurimit të cilësisë përfshijnë rritjen e vazhdueshme të cilësisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor si dhe implementimi i metodologjive bashkëkohore; si dhe zhvillimi i vazhdueshëm i programeve të studimit në përputhje me tregun e punës, nevojat social – ekonomike të vendit, si dhe strategjinë për zhvillim të institucionit; me qëllim krijimin e kulturës së cilësisë në institucion (<i>Evidenca 6.4 - Strategjia për Sigurimin e Cilësisë e AU-së</i>).</p> <p>Institucioni, në përfundim të çdo viti akademik, publikon raportin vjetor të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore, pas miratimit nga Senati Akdemik i AU-së.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Për programet e studimit që ofron Departamenti i Shkencave Juridike, ku përfshihet edhe programi MP në “E drejtë private” në mënyrë të herëpashershme rishikohen për t’i përshtatur ato me nevojat specifike të këtij program studimi dhe me nevojat e tregut të punës (<i>Evidenca 6.4 - Strategjia per Sigurimin e Cilësisë e AU-së</i>).</p> <p>Grupi i Sigurimit të Cilësisë në nivel Departamenti harton raportin vjetor të vetëvlerësimit të programit të studimit dhe e dërgon pranë Departamentit përkatës dhe NjSBC (<i>Evidenca 6.7- Model raporti vetvlerësimi i programit të studimit</i>).</p> <p>Të dhënat kryesore mbi praktikën e mira dhe pikat e dobëta të cilat kërkojnë më tepër zhvillim dhe plan veprimin e propozuar, NjSBC i përfshin në raportin vjetor. Raporti Vjetor dërgohet pranë Rektoratit dhe Komisionit për Vlerësim Institucional. Rektorati e përcjell në Senatin Akademik, në të cilin bëhet objekt diskutimi dhe merren vendime për miratimin e plan veprimeve në kuadër të përmirësimit dhe zhvillimit të programeve të studimit (<i>Evidenca 6.4 - Strategjia për Sigurimin e Cilësisë e AU-së; Evidenca 6.8 – Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-së</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Institucioni ka gjithmonë në vëmendjen e tij përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore që ofron. Sigurimi i cilësisë është pjesë e strategjisë së përgjithshme të zhvillimit të AU-së.</p> <p>Syllabuset rishikohen në fillim të vitit akademik, me pjesëmarrjen e Grupit të Sigurimit të Cilësisë në nivel departamenti dhe pedagogët/lektorët përkatës. Bashkë me syllabuset, nëse shihet e</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

70

	<p>nevojshme mund të rishihet edhe kurrikula për programin e studimit brenda masës 20 % të tij. Ky informacion i dërgohet zyrtarisht në formë shkresore NJSBC-së. Në rast se propozimi përmban edhe ndryshime në këtë kurikulë, atëherë informacioni duhet të përcillet edhe në Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave. Kjo e fundit pas shqyrtimit, ia përcjell Senatit Akademik për vendimarrje. Theksi vihet në përditësimin me literaturë bashkëkohore, ndryshimet dhe rishikimin e kurrikulës kur është e nevojshme, në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Ky proces realizohet nga departamenti në bashkëpunim me Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave. Përgjegjësi i departamentit ndjek rregullisht dhe sistematikisht zbatimin e programeve të studimeve nga pedagogët, ngre grupin ad-hoc që vlerëson programet në bashkëpunim me Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave. (<i>Evidenca 6.6 – Rregullore për mbarëvajtjen e kurrikulave; Evidenca 6.8 – Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-së</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Instrumentat e matjes së cilësisë të parashikuar janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetësorë të studentëve - Fokus grupe me studentët - Raporte vetëvlerësimi nga pedagogët - Formular i veprimtarisë Kërkimore – Shkencore për secilin pedagog - Formular i Drejtuesit të Departamentit për secilin pedagog - Raport vjetor vetëvlerësimi për zhvillimin e programit - Pyetësor drejtuar stafit akademik - Raportet semestrale & vjetore të njëjësive bazë dhe kryesore <p>(<i>Evidenca 6.4 - Strategjia për Sigurimin e Cilësisë e AU-së</i>). <i>Evidenca 6.8 – Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-së</i>).</p> <p>NJSBC harton një raport vjetor ku përfshihen informacione dhe vlerësime për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në institucion, cilësinë e shërbimeve të ofruara për studentët si dhe rekomandon masa për përmirësimin e cilësisë. Ky raport i paraqitet Komisionit për Vlerësimin Institucional dhe më pas i kalon Senatit Akademik të AU-së (<i>Evidenca 1.2- Rregullore e Përgjithshme e AU-së, neni 14</i>). Vlerësimi i brendshëm i programeve të studimit apo institucional organizohet nga NJSBC si rregull një herë në 3 vjet. (<i>Evidenca 1.4 – Statuti i AU-së, neni 67/7</i>), por nëse është e nevojshme, NJSBC mund të organizojë vlerësime të pjesshme edhe më shpesh.</p> <p>Në përfundim të çdo viti akademik, AU harton raportin e veprimtarisë mësimore e kërkimore-shkencore mbi analizën e programeve të studimit, ku përfshihet edhe programi i studimit MP në “E drejtë private”, veprimtarisë së kërkimit shkencor dhe elementeve të tjerë, pjesë e jetës universitare.</p> <p>Ky raport miratohet nga senati akademik i AU, dhe gjithashtu i dërgohet MASR.</p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Të dhënat e përftuara nga këto vlerësime, pas përpunimit, përdoren në mbështetje të procesit të vlerësimit të performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të vitit akademik, si dhe në lidhje me lëndët e programit që ndjekin, por edhe të personelit ndihmës</p>

	<p>akademik dhe administrativ si dhe shërbimeve që ofrohen nga institucioni dhe njësitë përbërëse të tij. (Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20; Evidenca 3.2 – Shkresë Fokus-grupet; Evidenca 3.1 – Pyetsori).</p> <p>Ky vlerësim përfshin edhe stafin akademik. Pedagogu vlerësohet nga strukturat drejtuese të fakultetit (dekani, përgjegjësi i departamentit), në analizën e planit individual mësimor dhe shkencor si dhe performancën e tij. Po ashtu kontrolli i cilësisë monitorohet edhe nga përgjegjësi i departamentit të shkencave juridike, i cili plotëson për këtë qëllim formatin e vlerësimit për pedagogun që angazhohet në këtë departament (Evidenca 3.4 – Formular i Drejtuesit të Departamentit). Kjo praktikë shërben për të bërë një vlerësim të cilësisë nga disa aktorë, me qëllim evidentimin e situatës dhe nxjerrjen e të dhënave të nevojshme për nivelin e cilësisë që ofrohet, përmes analizës SËOT. (Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20; Dokumenta shitesë: Evidenca 14.4 dhe 14.5 – Model Raportimi NJSBC).</p> <p>Përgjegjësi i Departamentit vlerëson sipas një formati të miratuar për këtë qëllim, stafin akademik të angazhuar në këtë departament gjatë vitit akademik, në disa komponentë: veprimtaria mësimore dhe veprimtaria shkencore/botuese e realizuar, marrëdhënia me studentët, korrektësia në çështjet administrative brenda departamentit (Evidenca 3.4 – Formular i Drejtuesit të Departamentit).</p> <p>Pas plotësimit të tij, përgjegjësi i departamentit këtë formular vlerësimi ia bën me dije pedagogut përkatës duke i dhënë një kopje të tij, dhe një kopje tjetër depozitohet në departament. Ky vlerësim bën pjesë në vlerësimin e përgjithshëm të performancës së çdonjërit prej personelit akademik të departamentit.</p>
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>Në mënyrë periodike, NJSBC informon dekanin dhe përgjegjësin e departamentit rreth rezultateve të dala, me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësitë të tij bazë dhe stafit akademik në të ardhmen.</p> <p>Në përfundim të këtij procesi, NJSBC harton një raport vjetor që analizon dhe bën një vlerësim të brendshëm të institucionit dhe të programit të studimit, përkundrejt standardeve shtetërore të cilësisë. (Evidenca 6.8 – Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-së).</p> <p>Raporti synon në mënyrë specifike:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të rishikojë përshtatshmërinë dhe efektivitetin e rezultateve të të nxëniet, metodat emësimdhënies dhe strategjitë e vlerësimit të një programi dhe të marrë në considerate planifikimin e ndryshimeve të nevojshme në programet lëndore; - Të sigurohet që të raportohen problemet që shfaqen në një program të veçantë, së bashkë hapat e ndërmarrë për zgjidhjen e tyre; - Të monitorojë dhe të vlerësojë se si feedback-u i marrë nga studentët përmes pyetësorëve dhe fokus grupeve është konsideruar (nëse është i përshtatshëm) dhe nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura siç kërkohet; - Të marrë në konsideratë sugjerimet e lëna nga Bordi i Akreditimit apo nga Vlerësuesit e Jashtëm, si dhe komente të tjera për zhvillimin e programit, kur janë të përshtatshme,

	<p>nga Urdhrat e Profesioneve të Rregulluara, si dhe nga punëdhënësit;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të identifikojë çfarë tendencash ka në përparimin dhe arritjen e studentëve, veçanërisht për të mbështetur grupe të caktuara të studentëve në përmbushjen e rezultateve të të nxënës; - Të raportojë për çdo zhvillim të ri në mësimdhënie, i cili mund të zbatohet edhe në programe apo departamente të tjera. <p>(Evidenca 6.4 - Strategjia për Sigurimin e Cilësisë e AU-së). Evidenca 6.8 – Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-së).</p> <p>Ky raport i bëhet me dije Senatit Akademik, i cili pasi e merr në shqyrtim, e miraton. Pas miratimit nga Senati Akademik i AU-së, ky raport publikohet edhe në faqen Web të AU-së.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfaqëson këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>AU ka përdorur në vazhdimësi instrumenta metodologjikë për të vlerësuar ecurinë e programit të studimit MP “E drejtë private”. Informacioni vlerësues është përfshirë në vetëvlerësimin institucional për sigurimin e cilësisë (R/VB, Standarti VI).</p> <p>NJSBC harton një raport vjetor ku përfshihen informacione dhe vlerësime për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në institucion, cilësinë e shërbimeve të ofruara për studentët si dhe rekomandon masa për përmirësimin e cilësisë. Ky raport i paraqitet Komisionit për Vlerësimin Institucional dhe më pas i kalon Senatit Akademik të AU-së (Evidenca 1.2- Rregullore e Përgjithshme e AU-së, neni 14; Evidenca 6.4- Strategjia për Sigurimin e Cilësisë e AU-së).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ nuk pati mundësi të takojë me një përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për shkak të ndryshimeve të personelit të Njesisë. Si rrjedhim, për këtë pjesë të raportit, informacioni bazohet kryesisht në konsultim dokumentash e aktesh dhe informacionin e vënë në dispozicion nga dokumentacioni në dosje.</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Impakt të drejtëpërdrejtë në sigurimin e cilësisë japin mendimet e studentëve të shprehura në pyetësorët që organizohen për këtë qëllim në fund të çdo semestri, si dhe tërheqja e mendimit nga “fokus-grupet” me studentët nga ku merret mendimi i studentëve mbi programin e studimit në tërësi, mbi çdo lëndë të veçantë dhe çdo pedagog që angazhohet në auditor në procesin e mësimdhënies, cilësinë e mësimdhënies dhe materialit të ofruar në syllabus,</p>

	<p>literatura, etj. (<i>Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20; Evidenca 3.2 – Shkresë Fokus-grupet; Evidenca 3.1 - Pyetsori</i>).</p> <p>Në fund të çdo semestri zhvillohen anketimet e studentëve përmes pyetsorëve në formë elektronike, duke ruajtur anonimat, dhe para sezonit të provimeve, në mënyrë që të reflektohen rezultate sa më objektive. Të dhënat e përftuara nga këta pyetsorë, pas përpunimit statistikor dhe cilësor, shfrytëzohen në mbështetje të procesit të vlerësimit të performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të vitit akademik, si dhe në lidhje me lëndët e programit që ndjekin, por edhe të personelit ndihmës akademik dhe administrativ si dhe shërbimeve që ofrohen nga institucioni dhe njësitë përbërëse të tij.</p> <p>(<i>Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20; Evidenca 3.2 – Shkresë Fokus-grupet; Evidenca 3.1 - Pyetsori</i>).</p> <p>Për shkak të situatës së shkaktuar nga COVID-19, për vitin akademik 2019-2020, u zhvillua një pyetsor i veçantë me studentët dhe pedagogët në lidhje me zhvillimin e mësimin online (<i>Dokumente shtesë: Evidenca 4.1 – Rezultatet e pyetsorëve për studentë 19-20 dhe Evidenca 4.2 – Rezultatet pyetsorë personel akademik 19-20</i>).</p> <p>Në lidhje me përfshirjen e ekspertizës së jashtme, GVJ nuk konstaton se përfshihen ekspertë ose bashkëpunëtorë të jashtëm në vlerësimin e cilësisë së programit të studimit MP.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>AU përfshin të dhënat e raporteve semestrale siç janë % e kalueshmërisë, notat mesatare apo realizimin e objektivave në raportin e vlerësimit të brendshëm për programin e studimit. (<i>Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20; Evidenca 3.1 - Pyetsori</i>).</p> <p>Institucioni nëpërmjet NJSBC-së përdor metoda të drejtpërdrejta vlerësimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bëhet vlerësimi me nota dhe pikë • Hartohen teste paraprake dhe përfundimtare; • Bëhen vëzhgime gjatë kryerjes së praktikave dhe ushtrimeve. <p>AU për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit merr informacion nga raportet semestrale që hartohen, raporti vjetor i Departamentit dhe ndryshimet e propozuara të kurrikulës, të dhëna statistikore mbi kalueshmërinë dhe mesataren e studentëve, pyetsorët me studentët, nga praktika mësimore, vetvlerësimi i pedagogëve dhe përgjegjësi i departamentit.</p> <p>(<i>Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për</p>	<p>Institucioni nëpërmjet NJSBC-së përdor edhe metoda të tërthorta vlerësimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pyetësorë të studentëve (2 herë në vit, 1 në çdo semestër) • Fokus grupe (1 në vit, që zhvillohet në muajin dhjetor), mbi vlerësimin e mësimdhënies, procesit mësimor, infrastrukturës etj; • Raport vetvlerësimi nga stafi akademik • Intervista <p>(<i>Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20; Evidenca 3.2 – Shkresë Fokus-grupet; Evidenca 3.1 – Pyetsori; Evidenca 6.4- Strategjia per Sigurimin e Cilësisë e AU-së</i>).</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

74

vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	Nga dokumentacioni dhe vizitat në AU, GVA nuk konstatoi se ishin përdorur metoda vlerësimi si sondazhe, apo intervista me të diplomuar (alumni).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Është e rëndësishme që raporti të përmbledhë të dhëna dhe pikëpamje nga aktorë të ndryshëm, si dhe të përqendrohet në përvojën e studentit dhe se si janë adresuar çështjet specifike të ngritura gjatë një viti akademik, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Po ashtu, raporti për vlerësimin e cilësisë duhet të konsiderojë dhe të dhëna nga raporti i vitit paraardhës dhe rezultat që rrjedhin prej tij (<i>Evidenca 6.4- Strategjia për Sigurimin e Cilësisë e AU-së</i>). Megjithatë, GVJ konstaton se në procedurat e brendshme të cilësisë përfshihen vetëm aktorë të brendshëm dhe nuk kemi ndonjë të dhënë konkrete se cilët ekspertë të jashtëm kanë kontribuar në këtë drejtim (ndryshe nga sa thuhet për këtë kriter në RVB).
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Për strukturat, njësitë dhe autoritetet konkrete të përfshira në sigurimin e brendshëm të cilësisë për këtë program studimi, detyrat dhe përgjegjësitë janë përcaktuar në aktet e brendshme rregullatore të institucionit (<i>Evidenca 6.8 – Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-së</i>).
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.	Për sigurimin e cilësisë, AU ka ngritur strukturat përkatëse që shkojnë deri në nivel departamenti, që merren me monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, nëpërmjet përdorimit të instrumentave të duhur, gjithmonë në përputhje me Manualin për “Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit”. Vlerësimi zhvillohet në bashkëpunim me struktura ta caktuara institucionale dhe në këtë proces përfshihen edhe anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit (<i>Evidenca 6.8 – Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-së</i>).
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë	Vlerësimi është transparent, siguron të dhëna të vlefshme dhe të besueshme, gjë që do të thotë se synon të shmangë pabarazi apo diskriminim dhe duke respekton integritetin akademik të personelit

çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	apo studentëve (<i>Evidenca 6.8 – Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-së</i>).			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	Siç u përmend më sipër edhe tek kriteri 1, GVJ konstaton se në procedurat e brendshme të cilësisë përfshihen vetëm aktorë të brendshëm dhe nuk kemi ndonjë të dhënë konkrete se cilët ekspertë të jashtëm kanë kontribuar në këtë drejtim (ndryshe nga sa thuhet për këtë kriter në RVB) për këtë program studimi.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Informacioni vlerësues është përfshirë në vetëvlerësimin institucional për sigurimin e cilësisë. Të dhënat e vlerësimit, NJSBC i publikon në faqen zyrtare të AU-së (<i>Evidenca 1.4- Statuti i AU-së, neni 67/6</i>). Institucioni, në përfundim të çdo viti akademik, publikon në faqen zyrtare të tij, raportin vjetor të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore, pas miratimit nga Senati Akdemik i AU-së, duke përfshirë edhe analizën SWOT. Një shembull raporti i publikuar mund të aksesohet në adresën: http://albanianuniversity.edu.al .
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	AU publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë akademike, transparencën dhe etikën akademike, LAL dhe akteve të tjera rregullatore në fuqi. (<i>Evidenca 1.4- Statuti i AU-së, neni 67/6; Evidenca 1.5 -Rregullore MP në E drejtë private; Evidenca 6.8 – Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-së</i>).
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Në përfundim të semestrit të dytë, departamenti harton raportin vjetor, në të cilin pasqyrohen rezultatet vjetore dhe bëhet një analizë krahasimore për ndryshimet dhe ecurinë e të dhënave të shqyrtuara, me qëllim përmirësimin e mangësive dhe problemeve të vërejtura. Institucioni përfshin të dhënat e raporteve semestrale siç janë % e kalueshmërisë, notat mesatare apo realizimin e objektivave në raportin e vlerësimit të brendshëm për programin e studimit dhe po ashtu pasqyrohen në raportin vjetor institucional që i paraqitet autoriteteve të tjera drejtuese (<i>Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20; Evidenca 1.4- Statuti i AU-së, dhe Evidenca 1.2 - Rregullore e Përgjithshme e AU-së</i>).
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit	GVJ vlerëson faktin që departamentin çdo vit harton një raport vjetor, ku synon të analizojë situatën dhe impaktin e veprimtarive në funksion

e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	të cilësisë. Por, GVJ mendon që në disa raste, për çështje të caktuara, ai është më tepër përshkrues sesa analitik. Kështu që GVJ mendon se në funksion të rritjes së cilësisë, departamenti duhet të zhvillojë më tepër aspektin analitik në lidhje me performancën dhe përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve të cilësisë. Siç e përmendëm më sipër, NJSBC ka një plan punë të aktiviteteve të saj, por GVJ nuk evidentoi ndonjë aktivitet konkret me personelin dhe studentët më qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së këtij program studimi.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	Nga dokumentacioni në dispozicion dhe vizita ne institucion, nuk rezulton të organizohen veprimtari për informimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së këtij programi.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	


Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional “E drejtë private” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Albanian University”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Në përshtatje me dinamikën e ndryshimeve dhe zhvillimeve në arsimin e lartë, kurikula e programit të studimit, syllabuset janë të ndërtuara sipas parametrave të kërkuar ligjorë dhe të përshtatshme për këtë program studimi e lëndët që përmban ai.
2. Përditësimi i herëpahershëm i syllabuseve dhe pasurimi i tyre, për të reflektuar ndryshimet dhe zhvillimet pozitive në fushën juridike.
3. Infrastruktura në dispozicion të procesit mësimor është e përshtatshme dhe mundëson kushte të mira të zhvillimit të procesit mësimor, interaktivitet dhe metodologji/mjete didaktike dhe audiovizuale.
4. Mjedis pune i kënaqshëm për stafin akademik dhe administrativ.
5. Aksesimi në biblioteka online (ie.e Questia), për të gjithë stafin akademik dhe studentët e universitetit, pa pagesë.
6. Bashkëpunim institucional i konsoliduar për zhvillimin e praktikave profesionale
7. Kompetenca e stafit të angazhuar në këtë program studimi, si një staf që ka kualifikimin dhe formimin profesional/ekspertizën e nevojshme për të mbuluar lëndët që ofron ky program studimi.

Pika të dobta


1. Mbulimi i ngarkesës së lëndëve për këtë program studimi me pedagogë të jashtëm, duke mospërbushur kriterin e kërkuar në lidhje me raportin e mbulimit të ngarkesës mësimore min. 70%PAE/30%PAK. Konkretisht për vitin akademik 2019-2020, ky mbulim është 51.3 % e ngarkesës në planin mësimor të këtij programi studimi mbulohet nga PAE dhe 48.6% nga PAK.
2. Në lidhje me sa më sipër, procedurat e rekrutimit për personel akademik me kohë të plotë nuk kanë qenë efektive në lidhje me rritjen dhe rekrutimin e stafit akademik me kohë të plotë, me kompetencat përkatëse, që të mund të mbulonte ngarkesën mësimore sipas detyrimit ligjor të mësipërm (min. 70%) për këtë program studimi.
3. Numri i vogël i studentëve në këtë program të regjistruar në këtë vit akademik dhe tendenca në rënie e tyre.




4. Kriteri i ndjekjes së programit nga studentë me diplomë Bachelor nga degë të ndryshme studimi ndikon në cilësinë e përgatitjes sepse studimet në nivelin Master në të drejtë private kërkojnë njohuri të paktën bazike në fushën e së drejtës.
5. Evidentimi i disa problemeve mbi të dhënat që mbahen në regjistrin themeltar të studentëve, në lidhje me saktësinë e informacionit.
6. Institucioni ofron pak mundësi apo programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm të personelit akademik e kërkimor, si dhe për të rritur mobilitetin e stafit dhe studentëve të interesuar.
7. Mungon financimi dhe mbështetja e iniciativave, projekteve kërkimore apo zhvillimore të stafit akademik, me përfitim për institucionin dhe personelin akademik, dhe stafi akademik i përfshirë në projekte kërkimore është i vogël.
8. Përfshirja e kufizuar e studentëve të MP “E drejtë private” në aktivitetin akademik dhe veprimtarinë shkencore të departamentit apo edhe në aktivitete ekstrakurikulare.
9. Mungesa e një analize tregu me propozime të konsultuara me aktorë dhe partnerë konkretë të tregut të punës mbi mundësinë e përmirësimit të programit të studimit MP.
10. Në lidhje me përfshirjen e ekspertizës së jashtme, GVJ nuk konstaton se përfshihen ekspertë ose bashkëpunëtorë të jashtëm në vlerësimin e cilësisë së programit të studimit MP.

Rekomandime

1. GVJ rekomandon të marren masa që të respektohet kërkesa ligjore në lidhje me mbulimin e ngarkesës së programit në raportin min. 70 % PAE dhe 30 % PAK.
2. GVJ rekomandon Departamentin t'i përgjigjet detyrimit ligjor për mbulimin e ngarkesës mësimore të këtij programi në masën të paktën 70% me personel akademik efektiv dhe kjo duhet të reflektohet edhe në evidentimin e qartë të nevojave për rekrutimin e PAE, në procedurat e konkurrimit që shpallen publikisht.
3. GVJ rekomandon Institucionin të rrisë rolin e tij për mundësi, mbështetje financiare për kualifikime të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit, për personelin akademik, si dhe për të rritur mobilitetin e stafit dhe studentëve të interesuar.



4. GVJ rekomandon Institucionin të rrisë financimin dhe mbështetjen e iniciativave, projekteve kërkimore apo zhvillimore të stafit akademik, me përfitim për institucionin dhe personelin akademik. Duhet bërë më shumë përpjekje për të përfituar grante të huaja dhe për t'u përfshirë më shumë në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, apo për të pasur një buxhet të dedikuar për departamentin (ndarja e burimeve financiare).
5. Numri i vogël i studentëve në këtë program të regjistruar në këtë vit akademik dhe tendenca në rënie e tyre kërkon dmd një analizë për ecurinë e mëtejshme të këtij programi, ku/si do të orientohet ai në kushtet e reja, duke marrë parasysh tregun dhe nevojat e tij, numrin e pakët të studentëve të regjistruar, koston dhe nëse do vazhdohet të mbahej, referuar kjo edhe përshtatjes me ndryshimet ligjore për kalimin në programin e integruar 5 vjeçar në drejtësi, etj., Pra GVJ rekomandon të bëhet një vlerësim/analizë dhe planifikim për këtë program MP në vijim.
6. GVJ rekomandon që objektivat e programit për formimin e specialistëve të MP në fushën e së drejtës private duhet të mbahen në fokus dhe rishikohen për të përthithur studentë të drejtësisë ose të paktën studentë të fushave të afërta me drejtësinë.
7. GVJ rekomandon që të dhënat në regjistrin themeltar të studentëve duhet të menaxhohen dhe të mbahen me kujdes, si dhe pasqyrimi i të gjithë informacionit të nevojshëm për studentin në to, duhet të jetë i saktë dhe i plotë.
8. GVJ rekomandon që Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike të ketë një platformë më të qartë të punës së saj, në funksion të koordinimit më të mirë të kërkimit dhe projekteve shkencore me departamentin dhe mbështetjen që duhet t'i japë atij, për aplikimin dhe pjesëmarrjen në projekte kërkimore brenda dhe jashtë vendit, dhe në përfshirjen e stafit akademik të departamentit në projekte institucionale apo ndër-universitare.
9. GVJ rekomandon mbajtjen e kontakteve me të diplomuarit (alumni) dhe përditësimi i bazës së të dhënave, si dhe për të ruajtur lidhjet me universitetin, që edhe alumni të përfshihen apo të marrin pjesë në konsultime për dhënien e mendimeve/propozimeve për përmirësimin e këtij programi studimi.
10. GVJ rekomandon që duhet plotësuar sa më parë struktura e NJSBC-së, si dhe të parashikohet mundësia e përfshirjes së ekspertizës së jashtme (ekspertë ose bashkëpunëtorë të jashtëm) në vlerësimin e cilësisë së programit të studimit MP.
11. Rekomandohet që të rritet bashkëpunimi me IAL të tjera vendase apo të huaja si dhe të konsolidohet bashkëpunimi me ato institucione/subjekte me të cilat AU ka lidhur marrëveshje.
12. Rekomandohet përfshirje dhe angazhim më i madh i studentëve të MP "E drejtë private" në aktivitetin akademik të departamentit apo edhe në aktivitete ekstrakurikulare.
13. Rekomandohet, aty ku është e nevojshme, në lidhje me rekomandimet e mësipërme, të përditësohen/ndryshohen aktet e brendshme rregullatore.




Conclusions of the Evaluation of the second cycle study program Professional Master "Private Law" of the Institution of Higher Education "Albanian University"

Strengths and affirmations

1. In accordance with the dynamics of changes and developments in higher education, the curriculum of the study program, the syllabi are constructed according to the legally required parameters and suitable for this study program and the subjects it contains.
2. Frequent updating of syllabi and their enrichment, to reflect the positive changes and developments in the legal field.
3. The available infrastructure of the teaching process is adequate and enables good conditions for the development of the teaching process, interactivity and methodology / didactic and audiovisual tools.
4. Satisfactory working environment for academic and administrative staff.
5. Access to online libraries (ie Questia), for all academic staff and university students, free of charge.
6. Consolidated institutional cooperation for the development of professional practices.
7. Competence of the staff engaged in this study program, as a staff that has the necessary qualification and training / expertise to cover the courses offered by this study program.

Weak points



1. Coverage of the course load for this study program with external lecturers, not fulfilling the required criteria regarding the ratio of the teaching load coverage min. 70% EAS / 30% CAS. Specifically for the academic year 2019-2020, this coverage is 51.3% of the load in the curriculum of this study program is covered by EAS and 48.6% by CAS.
2. In relation to the above, the recruitment procedures for full-time academic staff have not been effective in relation to the growth and recruitment of full-time academic staff, with the relevant competencies, to be able to cover the teaching load as required. Above legal requirement (min. 70%EAS) for this study program.
3. The small number of students in this program enrolled in this academic year and their declining trend.
4. The criterion of attending the program by students with Bachelor degree from different branches of study affects the quality of preparation because studies at the Master level in private law require at least basic knowledge in the field of law.
5. Problems regarding the data kept in the basic student register, regarding the accuracy of the information.
6. The institution offers few opportunities or specific programs for further qualification of academic and research staff, as well as to increase the mobility of interested staff and students.
7. There is a lack of funding and support for initiatives, research or development projects of academic staff, with benefit for the institution and academic staff, and the academic staff involved in research projects is small.




8. Limited involvement of MP students "Private Law" in the academic activity and scientific activity of the department or even in extracurricular activities.
9. Lack of a market analysis with proposals consulted with concrete actors and labor market partners on the possibility of improving the MP study program.
10. Regarding the involvement of external expertise, EEG does not find that external experts or collaborators are involved in assessing the quality of the MP study program.

Recomandations

1. EEG recommends that measures be taken to comply with the legal requirements regarding the coverage of the program load in the report min. 70% EAS and 30% CAS.
2. EEG recommends the Department to respond to the legal obligation to cover the teaching load of this program to the extent of at least 70% with effective academic staff and this should be reflected in the clear identification of the needs for recruitment of EAS, in competition procedures that are publicly announced.
3. EEG recommends the Institution to increase its role for financial support for further qualifications inside and outside the country, for the academic staff, as well as to increase the mobility of the interested staff and students.
4. EEG recommends the Institution to increase the financing and support of initiatives, research or development projects of the academic staff, with benefits for the institution and the academic staff. More efforts should be made to obtain foreign grants and to be more involved in national and international projects, or to have a dedicated budget for the department (allocation of financial resources).
5. The small number of students in this program enrolled in this academic year and their downward trend requires an analysis for the further progress of this program, where / how it would be oriented in the new conditions, taking into account the market and its needs, the small number of enrolled students, the cost and whether it will continue to be maintained, referring to the adaptation to the legal changes for the transition to the integrated 5-year program in law, etc., so EEG recommends to make an assessment / analysis and planning for the following MP program.
6. EEG recommends that the objectives of the program for the training of MP specialists in the field of private law should be kept in focus and revised to absorb law students or at least students of fields close to justice.
7. EEG recommends that the data in the basic student register should be carefully managed and maintained, as well as the reflection of all necessary information for the student in them, should be accurate and complete.
8. EEG recommends that the Office for the Coordination of Scientific Research and Academic Publications have a clearer platform of its work, in order to better coordinate research and scientific projects with the department and the support it should provide, for application and participation in research projects inside and outside the country, and in the involvement of the academic staff of the department in institutional or inter-university projects.
9. EEG recommends maintaining contacts with graduates (Alumni) and updating the database, as well as to maintain links with the university, so that alumni are also involved or participate in consultations to give opinions / suggestions for improving this study program.



10. EEG recommends that the structure of the IQAU should be completed as soon as possible, as well as to provide for the possibility of including external expertise (external experts or collaborators) in the evaluation of the quality of the MP study program.
11. It is recommended to increase the cooperation with other local or foreign HEIs as well as to consolidate the cooperation with those institutions / entities with which the AU has concluded agreements.
12. It is recommended greater involvement and engagement of students of MP "Private Law" in the academic activity of the department or even in extracurricular activities.
13. It is recommended, where necessary, in relation to the above recommendations, to update / amend the internal regulatory acts.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Niveli i përmbushjes	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANACIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
VLERËSIMI TËRËSOR			X	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

